

LEA YPI: LIBRI IM I KA NJË DETYRIM SHPIRTËROR SHQIPËRISË MË SHUMË SE ÇDO VENDI TJETËR

Bisedoi Andreas Dushi



KADARE: RAPSODI I MADH I BALLKANIT

Miljenko Jergović, *Jutarnji List*

(fq. 5)

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, përmendej shpesh si kandidat, Kadareja nuk e mori çmimin "Nobel". Ndoshta edhe nuk ka për ta marrë. Keq, sepse atëherë librat e tij do t'i lexonin të gjithë, ndoshta edhe ajo profesoresha e letërsisë mashkulloro-femërore. Njëlloj sikurse, si pasojë e sindromit të Stokholmit, te ne filluan të lexojnë Orhan Pamukun. Megjithëse është pakrahasimisht më i lexueshëm dhe, për europianët, kulturalisht më i afërt sesa Turku i Madh, Ismail Kadareja është edhe shkrimtar më i mirë.

LETËRSIA SHQIPE NË BOTË

**Botohet në Francë romani
"Metamorfoza e një kryeqyteti"
i shkrimtarit Ylljet Aliçka**

(fq. 9)

**Pasthënie e librit "Mountains
Entering" të Rudolf Markut,
botuar në SHBA**

Nga J. M. Hunter

(fq. 4)

**Insa Wilke, kritikja e njohur
gjermane për romanin e Lindita
Arapit "Vajzat me çelës në qafë",
përkthyer nga Joachim Röhm**

(fq. 11)

SHËNIME PËR LIBRAT

**"Funerali i pafundmë" i Visar Zhitit-
roman modern i mirëfilltë**

SHQIPTIM POETIK I LARTËSUAR I
TRAGJIKES INDIVIDUALE
DHE KOLEKTIVE

(fq. 12)

Nga Anton Nikë Berisha

'Apokalipsi sipas Shën Tiranës' i Zija Çelës

**TËRMET ESTETIK NË NJË
KRYEVEPËR**

Nga Ali Aliu


(fq. 7)

Libri me poezi i Maklena Nikës

**YJE TË LËNDUAR
NË VETMI QIELLORE...**

Nga Ymer Çiraku

(fq. 6)



Portret nga Ina Lajthia

SI E FRYMËZUAN ARTIN DHE IDENTITETIN E VINCENT VAN GOGH VEPRAT E PREFERUARA TË LETËRSISË FRANCEZE

Steven Naifeh mbi marrëdhënien
e piktorit me librat

(fq. 23)



BIBLIOTEKË

- Linda Pastan (fq. 14)
Pas një mungese
- Ramiz Gjini (fq. 16)
Trokitjet
- Ajkuna Dakli (fq. 17)
Mure të verdha
- Mihail Soare (fq. 18)
Dashuria si një tel me gjemba
- Selma Lagerlöf (fq. 20)
Dora fantazmë
- Xheni Shehaj (fq. 21)
Arratia e një shpirti endacak

MBI ARTISTËT DHE SHKRIMTARËT E KËOJ Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)

IN MEMORIAM
HUEJDA EL SAIED
– dëlira e shpirtit pa hiç hile...

(16.03.1975-23.11.2021)

nga Besim Fusha

(fq. 10)

LEA YPI

LIBRI IM I KA NJË DETYRIM SHPIRTËROR SHQIPËRISË MË SHUMË SE ÇDO VENDI TJETËR

Bisedoi Andreas Dushi

E dashur Lea, ju vini në gjuhën shqipe me librin tuaj të fundit "Free" shqipëruar "Të lirë". Është botuar me shumë pak kohë ndërmjet në Angli nga "Penguin Books" e mandej në Shqipëri nga "Dudaj". Ju, aq sa autore e tekstit në anglisht jeni edhe përkthyes e tij në shqip. Në kontekstin e bashkëjetesës ndërmjet dy kulturave e dy gjuhëve, si e keni krijuar raportin tuaj me tekstin? Ai i përket më tepër Anglisë apo Shqipërisë, jo si subjekt, por si tërësi objektive e asaj çka ofron?

Si tërësi objektive mendoj se librat nuk kanë përkatësi kombëtare. Kur janë të arrirë, i përkasin njerëzimit në përgjithësi dhe besoj se pikërisht këtë komunikim universal me lexuesin synon çdo autor. Në rastin e librit "Të lirë" çështja kryesore që trajtohet është ajo e lirisë. Në thelb të tij është mënyra se si ajo konceptohet nga individë të ndryshëm, si premtohet në rrethana të veçanta historike e si individët zhgënjehen për arsye të ndryshme, në sisteme të ndryshme politike. Në përgjithësi libri trajton tema me të cilat shpresoj të njehsohet çdo lexues, jo vetëm shqiptar apo britanik por edhe ata që nuk janë as britanikë e as shqiptarë. Natyrisht që konteksti i rrëfimit është Shqipëria, hapësira e krijuar për reflektim është ajo e tranzicionit nga socializmi në liberalizëm, përvojat janë të dikujt që është rritur në Shqipëri dhe disa nga materialet kërkimore mbi të cilat jam mbështetur për të rrëfyer ngjarjet apo për të përshkruar personazhet kanë të bëjnë me historinë dhe politikën shqiptare. Në këtë pikëpamje – le të themi më teknike sesa filozofike – mendoj se libri i ka një detyrim shpirtëror Shqipërisë më shumë se çdo vendi tjetër.

Për komunizmin jemi mësuar kryesisht të lexojmë nga pika prej ku shihnin disidentët, me bindjen se ajo çka po jetonin nuk ishte ashtu sikurse propagandohej. Qasja që sjell "Të lirë" është e re, më natyrale, më njerëzore. Pse keni zgjedhur pikërisht këtë mënyrë trajtimi?

Në libër ka një përpjekje për të mos e treguar historinë e Shqipërisë në tridhjetë vitet e fundit në këndvështrimin e një autori të pjekur. Duke qenë se bëhej fjalë për një libër mbi temën e lirisë doja që lexuesit të ishin sa më të lirë nga ndërhyrja e autorit në interpretimin e ngjarjeve dhe kontekstit. Për këtë arsye zgjedhja stilistike e librit është e ngjashme me atë të shumë librave të tjerë letrarë ku nëpërmjet rrëfimit të

një personazhi naiv autori vë më mirë në pah botëkuptimin e personazheve të tjerë dhe është në gjendje t'i japë më shumë nuanca një konteksti historik dhe politik veçanërisht problematik. Pikërisht për këtë arsye, historia është ajo e një vajze që bën kapërcimin nga fëmijëria në moshën madhore në rrethana ku evolucionin e saj personal përkon me evolucionin, ose më saktë revolucionin, e një populli nga një



sistem politik në tjetrin. Pra është një histori formimi, si në nivel individual ashtu edhe në atë kolektiv dhe në të dyja rastet zbulimi i vetvetes ndodh në mënyrë traumatike. Në rastin personal kapërcimi është traumatik pasi dy burimet kryesore të formimit të identitetit, shteti dhe familja, bien në kundërshti me njëra tjetrën ndërsa në rastin e popullit është traumatike pasi liria e vërtetë në fakt shpaloset gjithnjë si zhgënjim. Por libri nuk i jep zgjidhje këtyre konflikteve, thjesht i vë ato në pah duke iu shmangur një një interpretimi të vetëm.

Personazhet janë njerëz realë e, jam i prirur të besoj se edhe ngjarjet po ashtu: vishen nga një shtresë e hollë trillimi por në vetvete janë jetuar apo dëgjuar ashtu sikurse ruhet në thelbin e të treguarit. Sipas jush, në ç'kategori duhet përfshirë ky libër? Letërsi, kujtime, esse, filozofi...?

Besoj se mund të përfshihet në disa kategori. Ka pjesë filozofike, pjesë letrare, pjesë historike dhe pjesë nga ditaret e mia të shumë viteve më parë që kanë hyrë në libër në formën në të cilën janë shkruar në atë kohë. Në përkufizimin e katalogut të agjencisë që merret me të drejtat e librit zhanri quhet "auto-theory" – pra një vepër letrare që merr shkas nga jeta e autorit për të sjellë tek lexuesi reflektime mbi tema të ndryshme filozofike dhe politike që shpalosen në kapitujt e ndryshëm të librit përmes përvojave jetësore të autorit. Në secilin nga kapitujt trajtohet një teme e veçantë, si censura politike, marrëdhëniet me botën e jashtme, çështjet e emigracionit, të barazisë gjinore etj. Por edhe kjo ndarje nuk është e përpiktë dhe unë personalisht nuk besoj se etiketimet kanë edhe aq tepër rëndësi. Për mua mjafton që libri të lexohet e të nxisë mendimet e atyre që e marri në dorë, pavarësisht nga përkufizimi i formës letrare.

Forca e mendimit përmbledhur në personazhin e Ninit dhe naiviteti femëror përmbledhur në personazhin e Leas... Përveç dashurisë gjyshe-mbesë, këto dy personazhe çfarë i përafrojnë e përbashkon?



Personazhi i Ninit është boshti moral i librit – ajo e koncepton lirinë si ndërgjegjësime të domosdoshmërisë dhe njëkohësisht edhe si përgjegjësi për t'u qëndruar vështirësive të jetës duke mbrojtur vlera morale që nuk reduktohen dot në parulla ideologjike. Nëse mund të flitet për një ide kryesore në libër, ajo është që asnjë sistem sado shtypës që të jetë nuk mund ta nëpërkëmbë dinjitetin e njeriut deri në pikën kur ai humbet aftësinë morale për të bërë dallimin midis të mirës dhe të keqes. Kur humbet këtë aftësi morale, njeriu humbet vullnetin për të luftuar, besimin tek vetja dhe shpresën se gjërat mund të ndryshojnë. Nini mishëron pikërisht këtë ide: ajo është udhëzuesja morale e Leas së vogël, që duke patur përvojën e ndryshimit të sistemeve mund të udhëzojë mbesën e ta ndihmojë të përshtatet me risitë e jetës së saj. Ajo gjithashtu e ndihmon personazhin fëmijë të dallojë të vërtetën nga mashtrimi dhe të gjejë besimin tek vetja edhe në rrethana kërcënuese. Mbi të gjitha ajo i ushqen shpirtin kritik dhe kërkesën për t'u udhëhequr gjithnjë nga arsyeja, përtej konformizmit dhe nihilizmit.

Vetëdijësimi për lirinë, çfarë ajo në të vërtetë është, duket të ketë qenë një proces gati traumatik. Si mendoni, gjithmonë kështu jetohen thyerjet e besimeve të ngulitura thellë e zëvendësimet e tyre me besime të tjera?

Kjo është një pyetje e vështirë, përgjigjja ndaj të cilës me siguri ndryshon nga individi në individ. Mendoj se pasojat e çarjeve të tilla në jetën e dikujt ndjehen gjatë gjithë jetës dhe vendimet tona i pasqyrojnë ato në mënyra të ndryshme në periudha të ndryshme kohore. Për mua vetë shkrimi i librit ka qenë një mënyrë për të kuptuar pasojat e kësaj vetëdijeje por me siguri ky proces nuk ka marrë fund aty. Them se pasojat e vërteta të identiteteve që formohen mënyrë traumatike njihen thellë vetëm në fund të jetës. Deri tani, besoj se ajo që ka mbetur e ngulitur tek unë është një lloj dyshimi rreth shumë të vërtetave që të tjerët mund t'i marrin si të mirëqena si edhe dëshira për t'i zhveshur ato nga guacka ideologjike brenda të cilës shpesh paraqiten. Mbase pikërisht ky interes ndaj ndryshimit midis thelbit dhe dukjes ka ushqyer edhe pasionin tim të mëvonshëm për disa rryma specifike filozofike.

Në një kontekst më të gjerë, atë britanik e evropian, a shihet me paragjykim letërsia ku ndihet ndikimi i filozofisë majtiste?

Nuk e besoj. Por ajo që duhet kuptuar është se në kushte prodhimi dhe shpërndarjeje të burimeve materiale që karakterizohet nga monopoli ekonomik i firmave më të mëdha dhe ai politik e kulturor i shteteve më të forta, letërsia e vendeve të vogla dhe e pakicave të shtypura nga ana etnike, gjinore apo klasore gjen pak hapësira për t'u lexuar dhe është në një betejë të vazhdueshme për përfaqësim.



Si vazhdim i pyetjes pararendëse, a mund të shihet "Të lirë" si një manifest i ndryshimit të konceptit të së majtës?

Do të ishte manifest për ndryshimin e konceptit të së majtës sikur të kishim vetëm një përkufizim dogmatik të së majtës të cilit ky libër i kundërvihet. Por unë besoj se ne kemi shumë teori dhe qasje të ndryshme ndaj përkufizimit të

së majtës, të cilat duhen diskutuar dhe krahasuar me njëra tjetrën në një dialog që nuk mund të udhëhiqet nga një libër i vetëm por në të cilin ai natyrisht ai libër merr pjesë. Mbi të gjitha, ky dialog duhet zhvilluar nëpërmjet institucioneve demokratike që përfshijnë të gjithë qytetarët apo subjektet politike dhe jo vetëm intelektualët ose artistët.

Dy tema që kaluan jo pa debat ishte prania e politikanëve në promovimin e librit dhe vendi i përzgjedhur për promovimin, ish vila e diktatorit Enver Hoxha. Kishte nga ata që e kundërshtuan me forcë këtë. Mendoni se kjo ndërthurje e këtyre dy fakteve është një mënyrë për ta grishur më mirë lexuesin drejt librit dhe për ta orientuar atë, pak a shumë, në mënyrën e duhur për ta gjetur rrugën e dekriptimit të tekstit?

Mendoj që dhuna më e madhe që mund t'i bëjë autori tekstit që ka prodhuar është ta deshifrojë atë për lexuesin. Çdo libër ka tensionet, paqartësitë dhe pikëpyetjet e tij por unë besoj se lexuesi çlirohet jo kur ai orientohet nga autori por kur çorientohet nga vepra dhe angazhohet në vetë të parë me çështjet që ajo ngre. Në këtë aspekt, i vetmi element për të cilin më vjen disi keq është që ndonjëherë duke u përpjekur për të dhënë sqarime për mediat në mënyrë që t'u përgjigjesha kritikave rreth librit kam dhënë me tepër çelësa leximi apo interpretimi për simbolikën e përrimit se sa duhej të kisha dhënë.

Për "Të lirë" kanë shkruar disa nga mediat kryesore të Britanisë së Madhe. Ndoshta është një pyetje pak e vështirë, por a mendoni se ky libër është i duhuri për të paraqitur panoramën e diktaturës që Shqipëria ka kaluar?

Kërkesa për të përfaqësuar një epokë të tërë më duket një barrë e tepërt dhe tepër e vështirë për t'u mbartur nga një autor i vetëm dhe nga një libër i vetëm sado i arrirë apo i vlerësuar të jetë ai. Librat janë pjesë e një debati që shtrihet në kohë dhe në hapësirë ku autorët flasin me zëra të ndryshëm dhe përfaqësohen nga pikëpamje të ndryshme. Secili autor reflekton mbi përvojat, kujtimet dhe mbështetur në një orientim filozofik të patjetërsueshëm por sidoqoftë të pjesshëm. E vërteta besoj se është një tërësi organike që mund të shfaqet vetëm nëpërmjet përpjekjeve intelektuale të përbashkëta.

Përtej librit, ju jeni profesororeshë e teorisë politike në London School of Economics. Në një botë, gjithnjë e më të orientuar drejt globalizmit, besoni se të pavarura njëra prej tjetrës, disiplinat e humbasin peshën e tyre? Pra, vetëm kur krijohet një sintezë mes politikës, ekonomisë, letërsisë, filozofisë e të tjera fushave, secilës prej tyre i vihet re identiteti e për rrjedhojë, ai që kërkon t'i njohë i kupton më thjeshtë?

Besoj se disiplinat duhen zhvilluar si të ndara nga njëra tjetra, në shërbim të thellimit të mëtejshëm në secilën prej tyre, ashtu edhe në dialog me njëra tjetrën në mënyrë që të përftohet nga sinteza mes tyre. Nuk besoj se gjërat e kuptuara thjesht janë kuptuar më mirë por ajo për të cilën jam shumë e sigurt është që nuk ka temë, sado e vështirë, që të mos shpjegohet dot edhe thjesht.



Me librin 'Hyjnë malet, shkrimtari i shquar shqiptar dhe komentuesi publik, Rudolf Marku, u ka dhënë lexuesve amerikan një libër poetik magjeps. Përmbledhja mbart dëshminë e mendjes depertuese filozofike të autorit, zotërimin e përsosur të gjuhës, shpirtin e lindur prej udhëtari dhe marrëdhënjet komplekse me vendin e lindjes dhe atë të adaptuar.

Duke e çuar lexuesin në udhëtimin e bisedave intime, peisazheve tjetërsoje, dhe subjekteve të ndryshme, poeti në mënyrë eksperte bën Një botën e lashtë me atë modernen, përmes karakterizimeve të gjalla dhe pikurimit të figurave të së kaluarës e të sotmes, simboleve dhe imazheve. Si të donte të provonte bujarisht shkaku e zgjedhjes si Poeti i Parë Laureat i Shqipërisë, Marku ka krijuar këtë kryvepër provokuese. Ashtu si matematikanët që mund të brendashkruajnë forma gjeometrike të cilat, cekin njëra tjetren por pa u kryqëzuar, poezitë e Markut kanë secila një vlerë më vete, por duke u bërë më te kuptueshme të marra së bashku. Libri gjithashtu na ndihmon që të kuptojmë dhe vetë poetin. Sfondi i Markut dhe përvoja e tij jetësore vijëzohen ndarazi, por prapë duke bashkuar shtresat e ndryshme të qënies. Edhe pse një krah shtrihet sipër brigjeve familjare të Adriatikut, pranë vendlindjes së tij, Lezhës, krahu tjetër përfshin "pallajat e shkreta të qyteteve moderne" ku poeti udhëton larg prej vendlindjes së vet.

Që në gjuajten e parë të përshendetjes, Rudolf Marku identifikon praktikuesit e zanatit të vet si banorë të Ferrit. Duke shërbyer në rolin e guides përmes iluzionit Dantesk, Marku i përshkruan poetët si të kuptueshëm për veten, por të keqkuptuar, të dashakequr dhe të padeshifruar prej "mëkatarëve të braktisur nga gjuha,, -të cilët poeti gjithsesi përpigjet t'i arrijë. Duke pasë provuar, në fillimet e karrierës, censuren prej autoriteteve dhe kritikëve të atdheut, shkrimtari shqiptar artikulon ndjesitë e izolimit, persekutimit, dëshpërimit dhe frustracioneve ndaj mënyrës së poetëve të vet bashkëkohor "kundër gravitacionit të dashnisë,, Marku përsërit, tokëzon, dhe i lokalizon këto sentimente në librin e vet, si një tribut të anktshëm patriotik me rezonanca të barabarta për të gjithë poetët që u duhet të gjuajnë sfidat kur ballafaqohen me audiencën potencialisht apatike dhe jo të favorshme.

Tek shtjellon farefisninë e vet poetike, muza e autorit shqiptar e çon atë na ca skenare imagjinative të shkrimtarëve dhe mendimtarëve më të mëdhenj të njerëzimit. Duke pëlqyer zërat e legjendarëve grek dhe romak, ai zgjedh të pëlqejë Homerin, Safon, Ovidin, Horacin dhe Ciceronin, "si bashkohësit e mi,, siç e konsideron ai jetën e tanishme. Shqyrtues ndjenjash dhe i mendueshëm, shkrimtari shqiptar e sheh veten të shtyrë jashtë vendit, ashtu si Ovidi " i përzënë në një vend të huaj/, atje ku barbarët kërcënojnë në një gjuhë të pakuptueshme,, duke nënvizuar dhëmbjen se është "larg prej lexuesve të vet,,.

Për fat të mirë, ky libër hyjnor i përkthyer, mund të përftojë mënyra të reja të ndërmjetësimit e të diplomacisë.

Poeti hedh vështrimin tek marrëdhënjet familjare, duke përkujtuar

Pasthënie e librit "Mountains Entering" të Rudolf Markut, botuar nga Shtëpia Botuese Mundus Artium Press në SHBA, Shtator 2021

Rudolf Marku: RRËFIME NGA NJË SHPIRT QË NUK PREHET

Nga J. M. Hunter

secilin nga prindt e vet. Tek veçon preferencën e nënës që të mos bëhet barrë për të tjerët me vdekjen e saj, Marku na tërheq vëmendjen se "...ajo iku, si të thuash, në majë të gishtërinjve,, Vdekja e saj e ka bërë të jetë më i vëmendshëm ndaj të moshuarve, dhe se në dimër "kam frikë mos ftohen, mos kolliten" e se " u iku vjedhurazi nekrologjive,, Ndersa tani që ka arritur moshën e babait të vdekur, Marku imagjinon biseda „pa asnjë ndrojtje, pa asnjë kompleks edipian,,.

Poeti i pasuron vargjet e veta me një atmosferë detare, me aromën e athët të detit dhe me ritmet e dallgëve që rrokullisen. Qëndron përballë dallgëve -" kuaj të bardhë,, - dhe mbledh guackat

"që vijnë nga thellësitë/si ëndrrat që nuk ke vënd ku t'i vësh...".

Në poezinë e vet, Marku shpreh sensibilitetin që merr trajtë nga brigjet e Shqipërisë së Veriut. Ndonëse ka kryqëzuar shumë dete të tjera, është Adriatiku ai që kap zemrën e poetit duke e joshur drejt shtëpisë. Por edhe malet, siç na sugjeron vetë titulli, zënë një vend të veçantë .

Poeti krijon një skenë sureale të maleve tek bëjnë një vizitë në shtëpinë e tij, teksa shkundin dëborën në pragun e shtëpisë, dhe më vonë, duke vënë një ortek si një nënkrejtëse. Admiron madhësinë e maleve, por mbetet i përgjegjshëm për rrezikshmërinë që ata paraqesin njëherësh për gjithë

ata që kanë përvojë dhe për ata që nuk kanë. Shkrimtari sodit mundin e afrimit të mali Jungfrau, por duke e celebruar malin si mbretërinë e vetmisë sublime dhe duke njohur rrezikun e stërmundimit për t'u ngjitur "më pranë qiellit,,.


Natyrë luan një rol të rëndësishëm përgjatë gjithë Librit. Bëhet e qartë në portretin e një livadhi të bukur e të gjelbërt, një vend " me lule të shpërndara pa forma gjeometrike,, por njëkohësisht dhe si një "fushëbeteje e mëparshme,, Herë tjera shfaqen pemët, lulet, era dhe shpirtërat e lumejnëve, të përngjashëm me njerëzit. Ujqërit, gjithashtu, shfaqen disa herë në këtë libër, duke i ulëritur hënës a duke mbajtur një pikëpamje jo aq të favorshme për qëniet njerëzore. Marku gjithashtu na përshkruan drerët dhe mëzat në dis-harmoni me mjedisin urban.

Poeti është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar në fillimin e vitit 1997, dhe ky libër ka shumë poezi me atmosferën e Londres. Kudo, nëse ndodhet në një aeroport a në një varkë lumi, a në tragetin e La Manshit, ose duke manovruar në Metronë e sistemit hekurudhor, poeti shqiptar është i vetëdijshëm për statusin e Ballkanasit " që i ngjan një përroi të rrëmbyeshëm,/ që derdhet në lumin e qetë të Tamizit,, i cili me tregimet e veta e bën të zverdhët dhe vetë Alfred Hitchcock-un, ndersa Sherlock Holmes-in e bën të dal në pension të parakohshëm.

Nuk trembet të bëj shaka me dramaturgun më të njohur anglez. Rudolf Marku detajon me humor një atmosferë pas shfaqjes, ku aktori që loz Hamletin ndan një cigare me vrasësin e të jatit, ndersa Makbethi qëron një mollë me thikën vrastare, duke ia dhënë gjysmën e mollës mbretit Duncan. Sidoqoftë, aktorët shekspirian mbesin më pak të fajshëm nga figurantët, të cilët qëndrojnë të heshtur gjatë gjithë tragjeditë, por që në fund "kurr nuk harrojnë të marrin çeqet për heshtjen e tyre,,...Duket se Marku ka ndërmend "kotësinë e Teatrit Globus,, -me të gjitha skenat e veta, të cilat kontrastojnë me tragjeditë pa spektatorë që luhen në malet e Ballkanit.

Poezi të tilla të mprehta duken të përshndritura nga ironia e hidhur që shkakton mospërputhja mes Poetit Laureat dhe Atdheut të tij. Pozicioni i Markut si një qytetar i Botës ka bërë që poeti t'i paguajë taksë psikes së vet, aq sa ndonjëherë ndjehet se ai ka mall për gjerat më të thjeshta të së shkuarës dhe për vendet e tokës së vet të feminisë. Kanë kaluar afro 30 vite në Londër që nuk e kanë shuar etjen e trazimit, ankthit dhe vetmisë së tij. Një sens shvendosjeje e perhershme e shoqëron poetin në të gjitha udhëtimet e veta. Në një metropol të paemër, por gjithsesi të njohur, ai pyet: "E përse u dashka të jem në këtë qytet/ Poshtë yjeve pa dhëmbje, pa gëzim?". Poeti përgjigjet në një poezi tjetër: "Sepse trishtimi nuk është Vend, sepse trishtimi nuk është gjeografi". Diku tjetër poeti na ka kujtuar se "Njeriu udhëton, në Botë, që ta zbut trishtimin ,, dhe se Njeriu gjithmonë do ta ketë shtëpinë e vet.

I përcaktuar nga vizioni i Rudolf Markut si një i huaj në një botë të huaj, kjo përmbledhje e pakohë poetike sigurisht ka për të udhëtuar gjatë dhe ka për ta gjetur shtëpinë e përherëshme të lexuesit e vet në botë.



Një nga shkrimtarët më të mëdhenj europianë që jeton akoma, që prej njëzet vitesh banor i Parisit, lindi dhe u zhvillua në vendin më shtypës socialist.

Do të nisem, sëbashku me miqtë e mi për të bërë një udhëtim në det. Rast i rrallë, por mjaft i dobishëm, madje ilaç, që njeriu të gjendet jashtë kontekstit të dhënë shoqëror dhe material dhe ta shqyrtojë jetën e tij, sëpaku për disa ditë, nga perspektiva objektive e pasqyrës së madhe të detit. Për këtë edhe nuk është fort e lehtë të përzgjedhësh librat që synon për t'i lexuar gjatë kësaj kohe. Ka shumë rëndësi, të marrësh me vete libra që i ke pas lexuar dikur, i bindur se ata janë të duhurit dhe nuk do të të lënë vetëm në mes detit, sepse janë librat më të mirë që ke pas lexuar para njëzet e kusur vjetësh, në një kohë kur ke qënë tjetër njeri.

Marr librin e Ismail Kadaresë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" botim i Shtëpisë botuese të Beogradit "Rad", edicioni "Fjala dhe mendimi", libri numur 325, i përkthyer nga poeti Esad Mekuli dhe "Pallati i ëndërrave", botim i Shtëpisë botuese "Svjetlost" (Drita) nga Sarajeva në vitin 1991, biblioteka Feniks, i përkthyer nga Shkëlzen Maliqi. Gjeneralin për herë të fundit e kam pas lexuar në klasën e dytë apo të tretë të gjimnazit, në atë kohë të bekuar kur, në kërkim të orientimeve estetike dhe etike, "gëlltisa" pothuaj një libër në ditë. Më kujtohet se më pati pëlqyer ajo historia me gjeneralin italian dhe priftin katolik, të cilët shkojnë në Shqipëri pas luftës për të zhvarrosur ështrat e ushtarëve të vrarë, për të varrosur pastaj me dinjitet. Ky roman i shkurtër në imagjinatën e bibliotekës time të brendshme gjendet mes "Lelejska Gorës" ("Mali Lelej", *toponim në Mal të Zi. Shënimi i përkth.*) të Mihajllo Laliçit dhe "Kolonelit nuk ka kush ti ashkruajë" të Gabriel Garcia Markesit, ku do të qëndrojë gjatë gjithë këtyre viteve dhe ku do të vazhdonte të ishte ende sikur të mos ishte ky udhëtimi i paplanifikuar në det të hapur. Me eksperiencën e luftës së kaluar, të cilën e kam përjetuar me mjaft vëmendje, spastrimeve etnike, për shkak të të cilëve edhe unë vetë jam shndëruar në i huaj në qytetin tim të lindjes (*Miljenko Jergoviç ka lindur në Sarajevë dhe jeton e punon në Zagreb. Shën. i përkth.*), për shkak edhe të faktit të thjeshtë se atëbotë isha më i ri se ushtarët e vdekur të Kadaresë, ndërsa sot jam pothuajse moshatar me gjeneralët e tij të gjallë, te unë ndryshuan mendimet për këtë rrëfim, e me këtë edhe ai vendi në bibliotekën më të rëndësishme të çdo njeriu. Ndërkohë mu bë më i afërt në kuptimin njerzor dhe letrar, në atë mënyrë që për mua është i afërt, ndoshta, vetëm Ivo Andriçi, në veprën e të cilit është shënuar kodi im, me fjalë dhe me etiketë të papërcaktuar, i identitetit kolektiv. Vërtetë, asnjë shkrimtar nuk është më i afërt me Andriçin, as më ballkanik, sesa është Kadareja me romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur".

Kur e shkroi këtë roman të parë të tij, Kadareja ishte njëzet e shtatë vjeç. Dhe ndoshta kishte vetëm një shans që në Shqipëri, në vendin e braktisur nga Lindja komuniste dhe nga Perëndimi kjo kapitalist, në të cilin udhëhiqte diktatori paranojak me pamje dhe buzëqeshje prej fëmije, të tregonte se narracioni i tij është më i fuqishëm se ai që përshkruhet zyrtarisht. Sikur të mos ia kishte dalë mbanë, nuk do të ishte më. Do ta kishte gëlltatur errësira ose do të vdiste nga frika. Por, Ismail Kadareja ishte i çmendurisht bindur në gjenialitetin e tij dhe, sikurse shkruan Shkëlzen Maliqi, kishte marrë shumë seriozisht vendimin për tu bërë Homeri shqiptar. Kur u bë i famshëm nëpërmjet përkthimit të veprave të tij në gjuhën frënge, ai, ndër të tjera, shpëtoi edhe i gjallë. Ndërkohë librat e tij në atdhe disa herë u ndaluan, u kritikuan nga postet më të larta të shtetit se gjoja, ajo që shkruhej

KADARE: RAPSODI I MADH I BALLKANIT

Miljenko Jergoviç, *Jutarnji List*

në to, nuk është gjë e mirë për popullin, gjë që është shumë interesante se, qysh te "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", madje edhe lexuesit të sotëm, i bie qartësisht në sy një subversion i hapur ideologjik, gjë për të cilën do të mburrej rëndshëm edhe ndonjë shkrimtar në ndonjë prej vendeve më pak të ashpra të demokracive popullore. Askush si Kadareja i ri nuk e demonstroi atë dukuri disi të çuditshme të lindjes së letërsisë së madhe në kushtet e represionit politiko-shoqëror: shkrimtarët e vërtetë kur ndërthejnë historinë e tyre, janë vetërasëstarisht të guximshëm dhe të bindur se askush nuk ka ç'tu bëjë, megjithëse ndoshta si individë privatë mund të jenë burracakë të mëdhenj. Në ndryshim nga ata, shkrimtarët e gënjeshtërt kanë frikë madje edhe kur shkruajnë. Prandaj nuk ka asgjë të jashtëzakonshme fakti se Ismail Kadareja lindi bash në Shqipërinë e Enverit.

"Pallati i ëndërrave" është roman rrëfimtar i çuditshëm mbi institucionin otoman që merret me kontrollin e ëndërrave të banorëve të tij, roman që është përkthyer në fundin e vitit 1991 në Sarajevë dhe ku ende mund të gjendet nëpër librari.

"Pallati i ëndërrave" për herë të parë e kam pas lexuar në atë kohë të tmerrshme, në marsin e vitit 1992, pak para fillimit të rrethimit të Sarajevës. Ndoshta ky ka qënë libri i fundit që kam lexuar para fillimit të luftës, e për këtë nuk është e jashtëzakonshme që nuk e kujtoja dhe as më pati ngjitur sa duhet në atë kohë. Sikur të ishte ndryshe do të më kishte ngrënë frika. Por, për fat të mirë, njeriu vetëm më vonë ndërgjegjësohet për gjithçka të pashpresë të momenteve më dramatike të jetës së tij. Ky roman i publikuar në Shqipëri në vitin 1981, menjëherë i kritikuar ashpërsisht, i vendos ngjarjet në kohën e Turqisë Otomane, në Tabir Saraj, institucion që merret me mbledhjen, klasifikimin dhe interpretimin e të gjithë ëndërrave të perandorisë së atëhershme. Ndoshta është edhe vizioni i fundit origjinal dhe i përkryer deri në fund i ferrit, i cili, le ta themi kështu, ndryshon nga ai i Dantes sepse për të nuk ka nevojë për vdekjen; mjafton një ëndërr e përnatëshme. Lexuesi, shumë lehtë Tabir Sarajin mund ta faturojë si alegori për Shqipërinë komuniste, ose- nëse mendon disi më gjatë- te ky roman

gjen elementë të fantastikës shkencore, por asnjë prej këtyre, sepse Kadareja nuk ia ka nevojën alegorisë për të rrëfyer historinë, as nuk i nevojitet gjinia letrare për të justifikuar letrarisht diçka që realisht nuk ka ndodhur kurrë. Sepse, menjëherë pas faqeve të para, harrojmë faktin se Tabir Saraji nuk ka ekzistuar si pjesë e strukturës së pushtetit të Turqisë Otomane, harrojmë fare dhe për ne nuk ka aspak rëndësi sesi realiteti sillet ndaj narracionit apo narracioni ndaj realitetit. Kryesisht sepse Ismail Kadareja, si edhe në prozat e tjera të tij (natyrisht e kam fjalën vetëm për atë që është përkthyer në gjuhët jugosllave), këmbëngul në kontekstin lokal, madje edhe shpesh te hiperdokumentimi. Kësisoj, heroi kryesor i "Pallati i ëndërrave", Mark Alem Qyprilliu, i përkët framiljes së lashtë shqiptare, e cila ka dhënë shumë vezirë turq, dhe për të cilën ka edhe këngë popullore boshnjake. Shkrimtari luan me këtë fakt duke ndryshuar, në mënyrë çuditërisht sugjестive, nivelet e rrëfimit, kështuqë herë flet për individin, ose nga perspektiva e individit, herë për popuj të tërë dhe perspektivat e tyre. Për rilindjen popullore flet si për një ngjarje të tmerrshme, kur populli, si puna e zombit, ngrihet nga të vdekurit. Përshkruhet ferri, por jo me njerëz, por me shtete të vdekura. "Kufomat e këtyre shteteve qëndrojnë të palëvizshëm njëri pranë tjetrit: perandori, emirate, republika, monarki kushtetuese, konfederata". Dhe e gjitha kjo në ëndërr, e cila megjithatë i referohet realitetit në mënyrë të këtitillë që, në një masë të madhe edhe e prodhon atë. Një prej mënyrave sipas të cilave klasifikohen ëndërrat në Tabir Saraj është edhe arkivimi sipas popujve, e kësisoj në njërin anë, le të themi kështu, qëndrojnë ëndërrat e popujve indiferentë, e në anë tjetër ëndërrat e popujve të pagjumë dhe ëndërrat e popujve me dimra me shumë erë.

"Pallati i ëndërrave" është rrëfim i tmerrshëm dhe i përhumbur, përsëri tërësisht andriçian, megjithëse i shkruar në një kod të cilin Andrii nuk e ka përdorur kurrë. Njëllor si edhe çifti i tij boshnjak edhe Kadareja ka atë sigurinë hyjnore në të rrëfyer, atë fuqi të krijimit të botëve të reja, të cilat i vendos jashtë çfarëdo formacioni stilistik dhe historiko-letrar, dhe pothuajse jashtë çdo mode letrare. Ndonjë profesoreshë dhe

antare jurie e këtushme, e cila kryesisht merret me renditjen e veprave letrare në femërore dhe mashkullore, pra në vepra ciklesh menstruale dhe k..ri, për Kadarenë- sikur ta kishte lexuar- do të thoshte se ai është shkrimtar i realizimit, e bindur se në këtë mënyrë po thotë sharjen më të rëndë të mendueshme. Po kështu do të thoshte edhe për Andriçin, sikur ta dinte se Andriçin nuk guxon ta shash. Në fakt, nga realizimi magjik, i cili akoma mbartet në shëtitje letrare ditore dhe pas darke, re realizmi i Kadaresë ndryshon vetëm për faktin se Shqipëria, veçanërisht nga perspektiva e Vrbikut dhe e Treshnjevkës (*lagje periferike në Zagreb. Shën. i përkth.*), në ndryshim nga Argjentina, Kolumbia apo Kuba, nuk është ende në destinacion i preferuar turistik. Por edhe kjo ka për të ndryshuar së shpejti.

Në Kroaci Kadareja është përkthyer pak. Para tridhjetë vitesh në Rijeka është botuar një përkthim tjetër i "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur", të cilin nuk e kam patur kurrë në dorë, sepse besoja dhe vazhdoj t'i besoj, Esad Mekulit, ndërsa para dhjetë vitesh është botuar, më shumë për shkak të interesave të politikës ditore sesa ato letrare edhe "Tri elegji për Kosovën". Kjo vepër është përkthyer dhe publikuar në Beograd dhe kryesisht në Sarajevë, ku atëbotë, në radhët e botuesve dhe shkrimtarëve, ekzistonte interes serioz për romanet e tij, kështu që si përkthyes dhe hartues parathëniesh u rreshtuan poetët, shkrimtarët dhe intelektualët më të rëndësishëm kosovarë, në mënyrë që Shkëlzen Maliqi, në verën e vitit 1991, me parathënie e tij për "Pallatin e ëndërrave" u vuri pikat mbi "i" për Kadarejnë dhe për tërë një epokë, në të cilën shqiptarët më së shpeshti ishin të mënjanuar, por te ne dihej për letërsinë e tyre.

Ismail Kadaresë iu ktheva rastësisht, vetëm e vetëm që në këtë udhëtimin e gjatë në det të mos gjendem në shoqërinë e ndonjëfarë shkrimtari të keq dhe të pakuptueshëm. Megjithëse atëbotë, në fillim të viteve nëntëdhjetë, përmendej shpesh si kandidat, Kadareja nuk e mori çmimin "Nobel". Ndoshta edhe nuk ka për ta marrë. Keq, sepse atëherë librat e tij do t'i lexonin të gjithë, ndoshta edhe ajo profesoresha e letërsisë mashkullore-femërore. Njëllor sikurse, si pasojë e sindromit të Stokholmit, te ne filluan të lexojnë Orhan Pamukun. Megjithëse është pakrahasimisht më i lexueshëm dhe, për europianët, kulturalisht më i afërt sesa Turku i Madh, Ismail Kadareja është edhe shkrimtar më i mirë.

18. 07. 2010.

Përktheu Xhelal Fejza

<https://www.jergovic.com/subotnja-matineja/kadare-veliki-rapsod-balkana/>



Foto nga ALDO BONATA

Në fjalorët e termave të letërsisë, oksimoronin e ndeshim si një figurë stilistike të ndërtuar mbi fjalë me kuptimet e tyre të përkundërta, të cilat, në vështrim të parë, duket sikur e kundërshtojnë njëra tjetrën, por që krijojnë e përcjellin në poezi, një efekt tejet trandës nga aspekti i përjetimit emocional. Është në fakt ai *gazavaj* i shprehur përmbledhtazi brenda një kompozite të vetme, pra, një *gëzim i hidhur*, që endet si harmonia e e përjetshme e kundërshtive të gjërave. Është pra, ai kufi e ai cak, fare i brishtë, prej nga ku mund të endesh e të soditësh në zotërimin më të plotë e më të pafundëm të gjithëshkaje para teje, në të gjitha kahjet e dimensionet. Autori i fjalorit të njohur të termave letrare (2013) Ferdinand Leka, ka përzgjedhur një perlë nga folklori shqiptar - për ta ilustruar esencialisht oksimoronin:

"Moj e hequra si bari/e kulluara si ari/Gëzimzeza që s'gëzove/jetën s'e trashëgove..."

Një bukuri rrëzëllitëse kjo e femrës së cilës i këndohet, por e dënuar që të mbetet e të tretet paradoksalisht bri humnerash jetësore, ashtu si metafora e frutit të mollës më të diellzuar në majën më të lartë të pemës (në poezinë e njohur lirike të Safos), që vajti dëm, sepse u kalb prej indiferencës së kalimtarëve të rrugës, të cilët, i kishte zvenitur rëndshëm përtesa për të kërkuar e për të guxuar ngjitjen në *lartësi* (!)

Poetja Maklena Nika, e ka prirje të saj përcjelljen në krijimtari të kësaj gjendjeje, si të thuash pezull e kontrastuese poetike, prandaj edhe ka vendosur që ta titullojë librin fare shkurt: *Oksimoron*. Sigurisht, në këtë rast, jo me qëllimin për të spjeguar në mënyrë shkollareske kuptimin e kësaj figure stilistike, por për të dëshmuar këtë lloj fryme intriguese të përcjellë në poezinë e saj. Sepse këtu ndiqet kodi i një komunikimi mund të thuhet me shenja e domethënie të përkundërta, që e vendosin lexuesin në pozita aktive përsiatjesh e interpretimi rreth atyre sinjalesh poetike, sikurse para një alfabeti/aparati mors - mes tekstesh fluide, të vegimta e gati halucinante.



Libri me poezi: "Oksimoron" nga Maklena Nika

YJE TË LËNDUAR NË VETMI QIELLORE...

Nga Ymer Çiraku

Në poezitë e librit, lexuesi ka rastin që të endet si një udhëtar i vetmuar e i përhumbur në një *vjeshtë të verdhë me vetmi të verdha*, një vetmi gjithsesi e acartë, e përbaltur nga malli, ku derdhet shiu ledhatues dhe njëherazi i trishtë...

Ky është libri i dytë i autores, pas atij të parit, me titullin në formën e renditjes së trajtave vetore: "*Unë, ti, ne*", - botim dygjuhësh shqip/ frengjisht, 2001. Qysh në atë libër të parë, u ndie një zë i përveçëm poetik, ku shquanin eksplorime delikate prej jetës së njeriut. Dhe kjo realizohej pa u identifikuar autorja në atë zërin e njohur autorial të *gjithëdijshëm*, që transmeton ide dhe pikëvështrime të caktuara prirëse për lexuesin. Përkundrazi, ndjek prirjen e saj, duke i përcjellë motivet si në një thjerrëz shumëtrajdash, e prandaj edhe të derdhura ato motive në një spektër të gjerë e të përkundërta përjetimesh. Duket se edhe poezia frënge e greke, sidomos ajo e prirjes moderne, të cilën autorja e njeh mirë dhe e ka pjesë të kulturës e formimit të saj letrar, kanë

lënë ndikimet e veta në këtë model poezie përsiatëse, ku detajet dhe gjendjet poetike, mbivendosen e nuk qendrojnë/ndërtohen në një ekuilibër e logjikë thjesht formale.

Motivi i vetmisë, duke e ofruar zellshëm brenda vetes dhe duke u dashuruar me vuajtjet cflitëse që ajo mbart e përcjell, dëshmon atë gjendjen e absurdit egzistencial të njeriut, një lloj *vetviktimizimi* e asketizmi të vetpranuar. Sigurisht, që në poezi, këto shpallen si modele ballafaqimi e verifikimi purifikues për lexuesin - në raportet e tij aktive me këto tekste. Në poezinë "*Muret e mia*", autorja e konfirmon se:

Me vullnetin tim jam gozhdur këtu!...

janë mure të forta, të kështjellta e të ftohta

*çdo natë fle mbi to me qetësi vrastare
muret e mia
ju dashuroj
në naivitët*



Në poezi, përjetimet e ndjesive të përkundërta, i përjashtojnë imazhet njëkolorëshe. Përkundrazi, ato imazhe kryqëzohen, shkrihen në trajta të caktuara e po ashtu pastaj rifitojnë e marrin forma të reja. Është pra, ajo gjendje e vretur/shfaqur *transi*, ku njeriu, mund ta gjejë veten në fashën e kohës feminare, pastaj njëherësh në çastin dhe vendin mjaft të largët, brenda kornizave të qiellit të kufizuar, por edhe në pistat/trajektoret e pafundme të gjithëçkaje. Vetmia dhe rendja/soditja/tërheqja pas botës së pafundme, dhimbja/pikëllimi dhe një det blu përpara që të fton të endesh të valët e tij të përrallërta, guacka e skrupujve cflitës dhe jermi thërritës i zërave të pasioneve të mishit e gjakut, përbëjnë strukturën mozaikale të kësaj poezie, e cila, endet në një rrjetë ligjërimi, që i përgjigjet pikërisht kësaj strukture konceptuale poetike. Dhe duhet shënuar se autorja, këto përjetime nuk i mvesh me një dekor të mbingarkuar figurash stilistike. Ajo preferon ta përcjellë frymën dhe emocionin e poezisë, para së gjithash në ligjërimin në dukje neutral/objektiv të situatave dhe gjendjeve të përkundërta e ballafaquese, por që në shpalosjen e narrativës së tij, krijon situata tensioni dhe intriguese për lexuesin.

Njeriu i kësaj poezie nuk është i një vendi të caktuar, as i një kohe të caktuar. Kjo adresë kronotopike me tendencë mjegullohet e lbyret në shumësi trajdash. Atëhere, është ky njeri, siç perifrason poetja - *diku...*, në perla ndjenjash dhe kuaj-deti, në zjarre të ftohta e akullnaja të nxehta, në pafundësi eteresh.

Por një endje e tillë, mes ekstremesh, nuk ia shuan dot njeriut yllin e identitetit të botës dhe të fisnikërisë së vet:

*u linda e pranvertë
nga vet dashuria
u rrita mes pranverave të viteve të mia*

*kërkoj
pranverën në çdo vështrim dhe prekje
dashurie
ritmin e pranvertë që i dhuron
përrallës sime aromë jaseminësh*

Krijimtaria poetike e këtij libri, besoj se lexuesit do t'i ngjallë kërshtëri, jo për diç tjetër, por edhe sepse këtu, ai gjen veten e tij si të thuash *parake*, pa ato dekoret e artificeve, që në jo pak raste mund t'i ndeshim të derdhen prej shtresave të lloj-llojshme moralistike e atij angazhimit të rëndomtë deklarativ, bërtitës.



Pas leximit të "Apokalipsi sipas Shën Tiranës" (2011), duke e njohur krijimtarinë e autorit, përshtypja e parë ishte: po ai rrëfim i një shkalle estetike majsh në prozën tonë, po ajo poetikë narrative që vjen dhe degëzohet në ecje e sipër duke u bërë gjithpërfshirëse, po ajo mjeshtëri identifikimi dhe fokusimi i detajit ku autori shkëlqen, po ai korpus personazhesh që vijjnë secili me natyrë e personalitet të veçantë.

Ndryshe nga praktikat shkrimore letrare nga lashtësia e kënde, ku bëhet i mundshëm kalimi i të gjallëve në botën e të vdekurve (kujtojmë Danten me "Komedinë hyjnore"), në romanin e ri të Zija Çelës gjejmë të pangjashmen: shkrimtari ndërmer rrugën e kundërt të Hadit, ai i sjell të vdekurit në mesin e të gjallëve. Dhe jo për të shuar mallin e ndërsjelltë, por për t'i ballafaquar të dyja palët, çka do të nxjerrë sheshit egoizmin, hipokrizinë, anët e errëta të shpirtit e plot tjetërsime të mbrapshta të njeriut, të shfaqura a të fshehura, përkatësisht për të provokuar të gjitha format shkatërruese e vetëshkatërruese të tij, kësaj here me pasoja para apokaliptike në kryeqendrën e shqiptarëve.

Në horizontin e një përplasjeje dramatike, tmerrësisht të gjallë si në një shirit filmik, shpërthen lumë, me prirje për t'u bërë njësh, engjëllorja dhe djallëzorja te njeriu, i zhveshur kësaj here lakuriq, pa mundësi strehimi nga sytë e vet e të botës. Dhe po ashtu, siç jemi ndier të gjithë ffaras në romanin e tij "Goja e Botës", përgjatë rrëfimit që përfshin mbarë shtresat shoqërore, tani ndihemi të gjithë edhe të këtejshëm edhe të andejshëm, pra edhe gjallëvdekur edhe vdekagjallë.

"Apokalipsi" i Zija Çelës, me spikamën që ka ky tundim i radhës së autorit, vjen në prozën romanore të shqipes jo vetëm plot jehona trazuere, por edhe si tërmet estetik. Është roman që, përveç kompleksitetit përmbajtësor dhe poetikës narrative, shtrirjes në hapësirë dhe thellësisë së imagjinatës, të rrëmben me gjuhë, me stil dhe literaritet artistik tekstor. Vjen si një kryevepër e letërsisë shqipe.

*

Romani fillon me një familje tiranase, e cila bën përgatitjet e fundit për dasmën e djalit. Babë e bir kujdesen të sigurojnë nevojat e domosdoshme, sidomos që nga veshja e dhëndrit, deri te salla, ftesat e mysafirëve, banketi, muzika, etj. Në kulmin e dasmës, babai pëson një goditje në zemër dhe, nga kjo pikë, rrjedhat e vargut të ngjarjeve të papritura, dramatike e tragjike njëkohësisht, do të rrokullisen ortek goditës. Nata përfundon me një bilanc viktimitash në përmasa të hatashme prej zjarrit që bie në një nga pabet më të mëdha, si dhe me ngjarje të tjera, aksidente, vrasje, vetëvrasje, etj.

Tirana gdhiet në zi e pikëllim të thellë. Edhe kthesat vijuese përmasa të tilla do të kenë. Had e Tokë bëhen bashkë, sepse pas grevës së urisë dhe "ultimatimit" që qytetarët i drejtojnë Zotit për ta çbërë çfarë kishte bërë, nëpër lagjet e Tiranës, në dyert e shtëpive dhe ekranet e televizioneve fillojnë të shfaqen të vdekurit, tashmë të ringjallur. Në fillim me një buzëqeshje të ngrirë përgjysmë, të nemitur para një mrekullie të përcuduar që thyen ligjet e Gjithësisë, çfarë të bëjnë qytetarët, ish-manifestuesit e grevistët, ish-autorët e kërkesës ultimative për këtë kthim, të gëzohen a tmerrohen përballë të vdekurve të tyre, për të cilët dikur i patën derdhur lotët lumë?! Gjithçka që ndodh gjatë zhvillimit të ngjarjeve, do të mbruhet, plekset e shplekset si valë vullkanike bashkërisht nga të dyja palët, të këtejshmit dhe të andejshmit.

Fenomeni apokaliptik do të çjerrë syprinën e rreme të hapësirës, do të lakuriqësojë deri në palcë botën e vërtetë, degradimin dhe marrosjen shqiptare me shtrirje gjithëkohore e gjithëhapësimore. Të matanshmit dhe të këtejshmit, duke u mbrojtur, përkatësisht ballafaquar njëri-jetrin, duke u ndërsfiduar përmes pretendimeve dhe synimeve nga kjo perspektivë apokaliptike, nuk do të mund të fshehin absolutisht asgjë, sidomos degradimin moral dhe dehumanizimin tronditës.

Brenda kësaj hapësire artistikisht krejt të përjetueshme, të përshtatshme tani për çdo mrekulli, do të shfaqen hamendësime universale të llojit: Pse njeriu, që nga fillimi, qëndron i nemitur përpara mistereve të pazbërthya; pse njeriu nuk disponon urti për të parë dhe deshifruar kode e shenja të përcjella nga përvoja e universit? Në këtë parapërmbetje biblike, në diskursin narrativ të Zija Çelës përvizohet diskretshëm dhe me elegancë estetike kjo jehonë

Romani 'Apokalipsi sipas Shën Tiranës' i Zija Çelës

TËRMET ESTETIK NË NJË KRYEVEPËR

Nga Ali Aliu

e pazëshme, si një tundim metafizik: Pse njeriu i pranon me bindje e nënshtrim si të paprekshme misteret që, sipas tij, s'duhet provokuar? Vallë, ekziston një frymë. që vë dhe mban rregull përballë kësaj pafundësie të pakapshme për perceptimin e mendjes njerëzore? Jo pa qëllim, Çela vë në ngasje përsiatje të tilla, sidomos në nja njëqind faqet e fundit, ku është më i pranishëm narracioni eseistik e kontemplativ.

Asgjë nuk merr ngjyrim festiv në këtë roman: që në prag të dasmës, në ditët dhe orët e përgatitjes së saj, ngazëllimi për aktin martesor vjen si nismë gëzimi në tragjeditë antike, ku orakujt paralajmërojnë funde tragjike të përmasave kozmike. Zija Çela e paralajmëron lexuesin se njëri nga dy familjarët, babai ose djali, pikërisht në natën e dasmës do të mbyllë sytë. Kështu, lexuesi di atë që ende nuk e dinë personazhet. Autori, me këtë gjest brilant të poetikës narrative, arrin një ngjyrim emocional dhe estetik që zotëron tërë rrëfimin.

*

Për t'ia dalë mbanë, për t'i prirë dhe për ta përballuar ngasjen e brendshme, për të mos heshtur, për të folur, për të ulëritur në ballafaqim me marrosjen e botës përreth, shkrimtari Zija Çela i është dashur ta vërshojë hapësirën tiranase me një kaos edhe më të përcuduar, duke i vënë të bashkëtojnë të gjallë e të vdekur. Dhe ajo që paralajmëron apokalipsin, vetë përmbytjen e përmbysjen, dëshmohej nga realiteti ku të gjithë janë kundër të gjithëve.

Autori e potencon konfliktin shkallë-shkallë me shpërthime të njëpasnjëshme. Një detonator i tillë, ndër të tjera, është fakti se të vdekurit janë kthyer bashkë me të vërtetat që kanë marrë me vete, ato që konsideroheshin të propozura, bëmat e fshehta dhe sekretet që nisin të dalin në shesh, duke e ndezur edhe më tepër atmosferën, kur realiteti edhe pa këto shpërfaqje është i kontaminuar deri në absurd. Bie fjala, një vdekje që dikur është mbyllur si vetëvrasje, tani rezulton si vrasje, sepse është gruaja e ringjallur që denoncon të shoqin.

Të vërtetat e vdekagjallëve jehojnë si klithje fatthënash. Realiteti i egër i përditshmërisë do të bëhet skajshmërisht më i egër nëpërmjet ballafaqimit për nevojat ekzistenciale: të ardhurit duan të kthehen në vendet e punës që kanë patur, por që tashmë u janë zënë; ata duan pasurinë e tundshme dhe të patundshme që kanë lënë, por që të afërmit e tyre ua kanë tjetërsuar ose e kanë bërë rrush e kumbulla; ndërsa pleqtë kërkojnë t'u jepjen pensione, në mos për kohën sa kanë qenë matanë, domosdo për bukën e gojës në këtë anë. Pushteti fillon ta ndiejë veten ngushtë e më ngushtë dhe, kur vdekagjallët formojnë edhe partinë e tyre, pra kur mëtojnë të marrin pjesë në zgjedhjet politike e mundësisht të marrin në dorë frenat e qeverisjes, arrihet kulmi i konfliktit.

Nën pretekstin se mund të sjellin prej matanë gjithëfarë mikrobesh, sëmundje të panjohura që mund të shfarosin njerëzimin, fillon gjuetia e barbarëve (siç cilësohen të kthyerit) dhe izolimi i tyre nëpër kampe. Pak nga pak, për shumicën e të gjallëve kthimi i të vdekurve, edhe i atyre më të dashurve, bëhet krejtësisht i papranueshëm. Madje edhe i panevojshëm, shprehen të këtejshmit me hipokrizi në manifestimet dhe mitingjet që organizojnë. Derisa peticioni ndaj Hyjit bëhet përsëri gati, por tashmë me kahje të kundërt. Kësaj here kërkesa e parë ultimative është: Zot, nuk ka nevojë as për ringjallje të pjesshme dhe as për ringjalljen e përgjithshme biblike, ne që jemi gjallë na bëj të përjetshëm dhe puna mbyllet me kaq... Kërkesat e tjera sikur relativizohen vetiu, përpara kësaj zhveshjeje përfundimtare të maskës.

*

Ajo që në përballjen e parë të befason dhe kapitull pas kapitulli sikur të lë pa frymë, është ai depërtim në terrinat e brendshme të njeriut, i cili nga dyfytësia e sheqerosur, nën intensifikimin e ngjarjeve kalon në egoizëm dhe mizori të hapët. Janë zgavrat e fshehta të nënvetëdijes njerëzore, që në çaste të ballafaqimeve të mëdha dalin në sipërfaqe, bëhen ndërgegje e njeriut, duke përcaktuar gjithashtu artikulumet dhe sjelljet e tij.

Në roman rrëshqet me shpejtësi tërheqëse rrjedha e bëmave, duke krijuar një realitet të dytë plotësisht të besueshëm për lexuesin, i cili bën analogji me brutalitetin që ka përditshmëria dhe përgjithësisht tjetërsimi i vazhdueshëm i qenies humane.

Por jo vetëm si fenomene shqiptare, edhe universale. Ajo çfarë po ngjet në Tiranë, nga të huajt pranohet se mund të ngjasë edhe në kryeqytete të tjera. Jo më kot Europa hyn menjëherë në lojë, ajo e kërcënon Tiranën zyrtare me rrethim sanitar dhe izolim nga jashtë. Nga ana tjetër, vendasit ftojnë forca globale për të marrë pjesë në "betejën përfundimtare" kundër barbarëve, domethënë kundër njerëzve të vet.

Njësoj si romanet më të fundit të Zija Çelës, përkatësisht si tërë krijimtaria e tij, ngasjen e parë, atë vendimtare, frymëzimi e merr nga akumulimi i çrregullimit të botës njerëzore, në këtë rast asaj kryeqytetase. Pritat që ngre autori për të penguar derdhen drejt gjendjeve apokaliptike të çrregullimeve, vijnë alternativë krijuese imagjinative jo vetëm nga më të çuditshmet, por edhe plotësisht të bindëse si mundësi.

Realitetet alternative që krijon e ofron shkrimtari, përballen edhe ato me pengesat e veta. Por autori nuk i shmang. Edhe kur janë mistere të pazbërthyeshme, i sfidon nga perspektiva pyetjesh e përgjigjesh të shumta. Në këtë ballafaqim tronditës, përpara të cilit nuk fshihet e nuk mbrohet gjithashtu asgjë personale, autori duket si një Promete që hap gjoksin për shigjetat zeusiane.

Të njëzetetë kapitujt e parë, sipas një ecurie kompozicionale të sigurt, e përgatisin kapitullin kurorë të "Apokalipsit", të njëzetekatërtin (biblik). Në afro gjysmën e hapësirës së rrëfimit, koha rrjedh me prurje të reja të vdekagjallëve, prania dhe kërkesat e të cilëve shtohen vazhdimisht, çka rrit armiqësimin e tyre me

të këtejshmit. Në gjysmën e dytë, rrjedha e rrëmbyeshme e bëmave dhe diskursi narrativ shndërrohen gradualisht në gjuhë narrative përsiatëse, reflektive, fraza që tësohet për përqendrim thellësish. Derisa në kreun e fundit lëvizjet e turmës, në mitingun dhe antimitingun e palëve, kthehen në një lëmsh të pleksur, duke u shkrirë në një.

Brenda këtij lëmshi shfaqen pamje të larmishme dhe dinamike, fragmente të gjalla, klithje të sinkopuara apo të plota, ndërhyrje e dialogje që dëshmojnë çfarë ndodh, dhe të gjitha së bashku jehojnë biblike si klithmat në pragun e përmbytjes së madhe, kur mbetet për shpëtim vetëm barka e Noes.

Fragmente të tilla plot kumte kanë forcë tronditëse, ato të zënë pezull, hyjnë në rezonancë me dijet historike dhe jehojnë ngjashëm me katastrofat e çdo kohe, çdo hapësire. (Zemrat e tyre janë mbyllur, u ankua dikush për palën tjetër, ata që na përkrahin më parë, tani po shkatërrojnë dashurinë që predikonin. Nga e njëjta gojë del bekimi dhe mallkimi, e plotësoi Alma Kuculi. Kush e përmendi dashurinë këtu?, pyeti një vdekagjallë me pak dregëza në fytyrë. Unë, u përgjigj Sami Çami. Thuaj më mirë po shkatërrojnë mëshirën, sepse vetëm mëshira mund të triumfojë mbi gjykimin, tha ai me dregëza. Pastaj u lut: Mos i fal, o Zot, se e dinë çfarë bëjnë!)

Kamera e Mark Palit, njërit prej kryepersonazheve apo syri i orakullit, shtegton duke kaluar sa në bulevardin Dëshmorët e Kombit, sa në tokë e qiell njëherësh. Në syrin e kameras regjistrohet kordoni i helmetave, murit prej çeliku që përpiqet të pengojë përplasjen e palëve të kërlëshura, të gatshme për ta asgjësuar tjetrën, duke derdhur mbi kokën e saj gjithë papajtueshmërinë e akumuluar. Dhe, në rrethana të tilla, nis të rreshë: nga lart nuk bien as pika shiu, as fjolla bore, por shkullma pështyme si një ndot për turpin e mizorinë e përgjithshme. Dhe në tërë këto refleksë të Xhehemit, pikërisht nga goja e regjisorit që regjistron me kamera, si për t'u përhapur në gjithësi, jehojnë fjalë të tilla përjetësisht: "Pse njerëzit i gënjën mendja se mund të gjejnë ndryshime në ligjet e Hyjnisë? Ç'apokalips tjetër pritet, këtu s'jemi në Tregun e Iluzioneve dhe apokalipsin po e shohim me sy. Veçse s'po arrij t'i ndaj palët, kush janë barbarët dhe kush... Kam mjegull në kokë, po më dalin trutë nga rrashta." Dhe më pas: "Unë po shkoj, ti mos pyet se ku po shkoj, unë po shkoj me qa, me qa derisa të verbohem."

Mos paskësh ndodhur përmbytja e vërtetë, mos qenka Katastrofa vetë ky tjetërsim, ky degradim moral i njerëzimit?

*

Zemra e autorit të romanit "Apokalipsi sipas Shën Tiranës", nën peshën e ankthit që përjeton bashkë me të tjerë, nuk pushon së rrezatuari dritë mirësie mbi terrin shqiptar.

Por sa do të mund të përballojë zemra, duke parë sa poshtë ka rënë njeriu? Jemi në skenën finale, në manifestimin ku të gjallët janë mbledhur për dëbimin përfundimtar të sivëllezërve, kthimin e të cilëve vetë e patën kërkuar me përgjërime. Dhe ndërsa në kor duartrokitet kërkesa: "Ndrëprite këtë ringjallje të pjesshme, Zoti ynë, dhe na bëj ne të pavdekshëm, a nuk e sheh se jemi të vetëmjaftueshëm?!", pikërisht në këtë çast vjen edhe finalja e finales:

"Mirëpo nuk zgjati dhe u dëgjua një shpërthim. Mbi kokat e turmës u formua një kube gjithë cila dhe vezullime gjaku, njëfarë shatërvani që brafulloi njëherësh dhe u shua njëherësh. Çfarë ndodhi, çfarë ndodhi?, pyesnin andej-këtej. U tha se kishte shpërthyer një zemër njeriu. Markut i shkoi mendja te zonja Lahori, pastaj te zoti Santo, pastaj u kujtua për atë zemrën e shkruar të Zamir Golemit. Në fund dyshoi për veten, ç'e kishte atë dhembje të patretshme, ç'i kishte ato halucinacione, ishte apo s'ishte më ndër të gjallët? Më vonë e mori vesh çfarë kishte ndodhur. Kishte plasur aorta e atij që ishte shkrirë me turmën amorfe, kishte qenë dëshmitar në të gjitha ngjarjet, por në të gjitha si një qenie e padukshme, sepse nuk ishte tjetër veçse fantazma e autorit të këtij libri. Fantazma. FantaZ..."

Do ta shpëtojë vallë ambientin shqiptar të kontaminuar shpërthimi i metaforës universale, zemra e plasur e autorit, shpërfaqja e asaj drite që llamburri si përftim i vetëtimtë? Është gjithçka që dikush mund të bëjë për të tjerët, para se dërrasa e kalbur ku kemi shkelur, të thyhet me gjëmë e të marrim rrokullimën e



paktheshme. E këtë dritë të zemrës së flijuar sjell "Apokalipsi" i Zija Çelës, roman që mëton të ngjall dashurinë e munguar, të sprapsë ligësinë dhe urrejtjen mes njerëzve, në një rrëfim tundues ku çdo detaj vjen si shpalim i beftë, si refleks e shkrepje estetike, ndërsa së toku vijën si tërësi e përsosur harmonie.

Zaten, tërë krijimtaria letrare e Zija Çelës është refleks i botës së tij të brendshme, është ai vetja, vizioni i tij për botën, për njeriun. I beson zemrës së vet që i ushqen njerëzit me dashuri, i bindur se njerëzit e meritojnë atë edhe kur humbin ekuilibrin e marrosen; është zemër bujare ajo e krijuesit, që qorton rreptë por edhe fal, që rrugëton sipas aspiratës në përfaqim të botës, në depërtim të thellë për t'i hapur zemrat e mbyllura. Zija Çela u beson njerëzve të formatit të madh. Ja përse zemra e plasur e autorit të "Apokalipsit" depërton në dashuri përtej limitit të së mundshmes, vë në lëvizje të gjallë dhe të vdekur, tundon tokë e qiell, flet me Zotin para se të ndeshet me Djallin, shkund nga vendi dete e male, dhe gjithnjë nëpërmjet një force lëvizëse: dashurisë për njeriun, humanes universale.

*

Borgesi i madh thotë: "Nëse autori në fund mendon se bëri atë që kishte menduar, që kishte planifikuar, vepra nuk bën." Nga bashkëbisedimi i tij me Sabaton, ky i fundit e përforcon edhe më tej mendimin e të parit: "Mbase projektet e fillimit shërbejnë si një trampolinë për t'u krehur pastaj në ujëra më të thella. Aty zënë e punojnë të tjera forca të pavetëdijshme, të fuqishme dhe më të mençura se të vetëdijshmet. Ato që më në fund zbulojnë të vërtetat e mëdha." Rrënjët e gjenit gjenden në të pavetëdijshmen, jo te mendja e vetëdijshme, thotë shkrimtarja amerikane Dorotea Brend në tekstin "Të shkruarit kreativ", qysh në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, dhe vazhdon më tej: "Vepra e madhe nuk lind nga maturia e balancimi, as nga hapësira që i kushtohet vëmendjes për vetëdijen. Forma e saj artikulohe në rrëshqitje nga domeni i intelektit të vetëdijshëm." Mbase prej këndej është nxjerrë edhe aforizmi që kush është më inteligjent se vepra e vet, le të mos merret me krijimtari.

Qysh nga ngjizja fillestare e rrëfimit romanor, deri në fjalinë përmblyëse të "Apokalipsit" shtrihet rrugë e gjatë, e shtruar dhe e thepisur njëkohësisht, me hapësira të pafundme, me tunele të ankthshme që shpesh nuk u dihet fundi. Në ç'masë funksionon gjatë këtij kalvari ndërhyrja e arsyes së shëndoshë, në ç'masë imagjinata krijuese, përkatësisht çfarë është në këtë mes përmasa e së parashikuarës qartë për tërësinë e veprës dhe ndërhyrja e së paparashikuarës, pra: si qëndron raporti i së vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes në romanin e Zija Çelës?

Që edhe e pavetëdijshmja është pjestare e sigurt gjatë formësimit të plotë të këtij romani, dëshmohej nga skenat e larmishme, kthesat e befasishme, personazhet e shumta, rrjedhat thuajse spontane të rrëfimit, pamjet e atilla që kurrë s'i ka parë syri i njeriut dhe, mbi të gjitha, nga ajo gjetje e jashtëzakonshme, diçka si përtej mendjes njerëzore, mbi të cilën bufton ngrehina e madhe e romanit.

Në intervista të ndryshme, duke folur për procesin krijues, Çela është shprehur se, kur shkruan, të gjithëve u kthen shpinën, pasi në atë proces ka vetëm një kundërshtar: pikërisht Zija Çelën. E kur beteja është e brendshme, dihet se vetëdija e nënvetëdija japin dhe marrin, duke pasuruar njëra-tjetrën.

Hapësira, ambienti, përditshmëria e njerëzve, e botës që sjell romani, përjetohej përmes një gjendjeje të çuditshme, të pakapshme, fluide. E ke, e sheh, përkatësisht bëhesh gati ta prekësh rrugën, sheshin, të afërmin, njeriun e njohur, dhe në çast të rrëshqet fatamorganë, përfton tej duke të përcjellë shenja sa konkrete aq misterioze, sa të mbështjella në kode, po aq në dritë të ditës. Dhe vazhdimisht duke të tërhequr me vete, një tërheqje e pashqitshme që t'u biesh pas personazheve, të shkosh mbas tyre sa i mahnitur, po aq i përfshirë në makth, meqë hapëron në mjegull, me ndjenjën se aty pranë, ndoshta në hapin e parë, do të gjendesh buzë humnere.

Është e thjeshtë: një magnet e magji dhuntie narrative e Zija Çelës të përthith, të rrëmben me pasionin e madh për të iluminuar hapësirat e jetës, për të mbjellë e për të sjellë mirësinë, për të mos e humbur sa nuk është vonë një shans, që për njerëzimin kushedi nëse përsëritet.

E pranëvënë ndaj shprehjeve të gjenive se krijimtaria do ta shpëtojë njerëzimin (Niçe), e bukura do ta lumturojë njerëzimin (Dostojevski), apo mbështetem në plagët e fshehta që bart me vete, shkruaj sepse nuk mund ta duroj ndryshe realitetin përveçse duke e ndryshuar (Orhan Pamuk), përgjigja e pyetjes për zemrën e plasur të shkrimtarit tonë sikur rimbushet me kuptim. Është sublimja, më e veçanta dritë, ndriçimi që buron prej kësaj lëndë, prej këtij zjarri të pasionit, prej fantazisë dhe talentit të Zija Çelës.

*

Duhet thënë se "Apokalipsi sipas Shën Tiranës" ruan karakteristikat shkrimore të njohura dhe të mirëdallueshme të Çelës: thellësinë emocionale dhe imagjinative të të përjetuarës, degëzimin reflektiv të lëndës, kthjellësinë dhe bukurinë e të rrëfyerit. Në tërë opusin krijues, Zija Çela e ngjiz frymëzimin jo vetëm në enigmat e marrëdhënieve të tij metafizike, por edhe në çfarë sheh përreth e përjeton përditë, brenda një universi dhe shtjelle që natyrshëm e përfshin me vete autorin dhe lexuesin bashkë.

Kjo reflektohet gjithashtu në kompozicionin e romanit, shtrat që i jep lirshmëri, pa e kufizuar ndaj konvencave rrëfimore e kaskadave shkallëzuese, por as nuk e çon në rrjedha që dalin dore. Mund të thuhet se bëhet fjalë për poetikë, për kompozicion model që meriton vëmendje të veçantë të shkencës sonë mbi letërsinë.

Imazhet reale dhe ëndërrore autori i pleks, duke i shtrirë bindshëm në rrjetin tregimtar, në atë mënyrë që edhe vezullimet imagjinative të mëtojnë realen. Sipas këtij universi me shtresa të shumëfishta, Zija Çela i flet gjithnjë aktualitetit, botës së sotme shqiptare edhe kur i vendos ngjarjet në Bardhgolem ("Gjaku i dallëndyshe"), në Mamac ("Gjysma e Xhokondës"), në Balbonë ("SOS, një buzëqeshje"), në Fifarë ("Goja e Botës"), në Tiranë me "Apokalipsin" apo në Lavidan ("Arkipelagu Spiritus").

Nuk nis e nuk vjen asgjë e programuar, asgjë si projekt i paracaktuar. Autorin e vë në lëvizje një shqetësim që zmadhohet vazhdimisht, që shndërrohet në dhembje e duhet qetësuar, sepse vjen si hapësirë gërryese që duhet mbushur. Diku në këto gjerësi valësh ndodh hapja e madhe, ngritja e perdes së padepërtueshme deri në këto çaste, llamburitja nga thellësitë e pavetëdijshes. Edhe parapërgatitja imagjinative e apokalipsit, katastrofës kërcënuese që autori e ngre si shpatën e Demokleut, mbruhet si lëndë që rrjedh nga vetë realiteti, dhe në fakt është vazhdim i atij realiteti, përndryshe do të refuzohej.

Pikërisht në këtë organicitet lind natyrshmëria e më fantastikes dhe më magjikes në rrëfimin romanor të Çelës, çka e bën krejt të besueshme edhe atë që e cilësuam të pangjashme, bashkëjetësën midis të gjallëve e të vdekurve. Kështu ndodh me të mëdhenjtë. Në mbështetje të dëshmisë së Zija Çelës, më vijnë ndër mend këto fjalë të Orhan Pamuk-ut në ceremoninë e çmimit Nobel: "... disa fjalë, disa faqe që më kanë bërë pafundësisht të lumtur, më janë shfaqur nga hiri i një fuqie të jashtëm."

Thelbi i asaj që troket dhe ushtron trysni absolute në paradhomën e krijuesit, është i panjohur. "Mosnjohja është thelbësore për artin,

është ajo që lejon krijimin e artit. Pa procesin e depërtimit në thellësi..., pa gjasën që mendja të vejë në drejtim të paparashikueshëm, nuk do të kishim krijim", thotë Donald Barthelme në veprën "Mosnjohja - ese dhe intervista" (1997). Që shkrimtari duhet t'i bindet kësaj alternative, kjo nuk ka dyshim. Por kapërcyelli nga ky prag deri te tjetri, vjen si një humnerë e papërbalueshme. Ai e ka fare të qartë se kthim prapa nuk ka, ndërsa kapërcimi matanë, në bregun tjetër, është torturë e frikshme. Edhe në këtë pikë të ecjes si nëpër terr e nëpër ëndërr, intuuta që jep shenjë gjallërimi sikur ruan në vete një shteg, i cili është dhe s'është, shfaqet e zhduket, pastaj sërish përftohet brenda çastit dhe kalimi përtej erësisë, përtej së panjohurës, bëhet krahehapur...

Pikërisht këto faza të procesit krijues, gati-gati të pashpjegueshme për ndërlikimet që mbartin, ndihen të gjalla tek "Apokalipsi" i Zija Çelës, ku rrëfimit ia thellojnë perspektivën ato inkandeshencat që, duke u ngjitur nga pusët e brendshme, buftojnë përmbi terr.

Por edhe mbasi është bërë i qartë shtegu fillestar me disa faqe të romanit, autori nuk i paracaktonte rigat pasuese të horizontit, prandaj mbeten të hapura dilemat se si do të degëzohen rrjedhat, nga do të shtegtojnë personazhet. Sa më serioz dhe sa më skrupuloz të jetë shkrimtari, aq më të vështira dhe më të pakapërcyeshme shfaqen pareshtur pengesat. Përgjithësisht krijimtaria e Zija Çelës është tërheqëse edhe për shqyrtime teorike, ajo ngjall mjaft pyetje të profesionit. Tek "Apokalipsi" mund të pyesësh: "Ç'bën në fakt autori me lëndën që është derdhur shkulla-shkulla, pasi i krijon iluzionin lexuesit se Shpirtat e dëbuar, ata të përtejshmit, po fluturojnë drejt botës së përkatësisë së tyre, asaj qiellore? A ka arritur që atë përftim drite ta ketë regjistruar vetëtimthi paraprakisht me sytë e mendjes? Kur fillon selektimi dhe gdhendja me daltën në dorën e sigurt të shkrimtarit, zbutja dhe fisnikërimi i veprës nëpërmjet estetizimit total të tekstit, shndërrimi në art rrëfimtari? Kur dhe si bëhet qetësimi i shumëzëshmërisë së korpusit të madh të personazheve?"

Tërë kjo prurje vërshuese, me tingëllima alarmi, sa më thellë që shtrihet në hapësirë dhe kohë përgjatë rrëfimit romanor, gradualisht fillon të kanalizohet.

Këtu do të vëreja kalimthi lëvizjen që bën autori nga romani "Goja e Botës", duke kaluar tek "Apokalipsi". Në të parin ngjyrimet dhe dallimet e personazheve janë më të skajshme, tek i dyti kanë prirjen që në "turme" të përafrohen disi, në mënyrë që shumica e tyre të mbeten siç i gjejmë në roman, as engjëj të përsosur dhe as djaj pa kurrfarë shansi. Ndërsa të parët nuk janë imunë ndaj tundimeve për rebelime brenda përmasës së njerëzores, të dytëve, edhe gjatë çasteve tunduese për ligësi, u qëllon të mendojnë mbarë. Por pikërisht kakofonia morale që personazhet krijojnë së bashku tek "Apokalipsi", përbën kërcënimin kolektiv që nderet mbi hapësirë. Që të gjithë, sa të vetëdijshëm dhe sa nën shtyssa stihike, pra qorrasi siç e kemi zakon pa përjashtim, marrin pjesë në thurjen e dramës, duke dhënë një mozaik të papërsëritshëm.

Fjala artistike e Zija Çelës edhe në këtë roman vjen e privilegjuar, meqë mëton të qëndrojë si paralajmërim përballë vërshimit të së Keqes njerëzore. Mos parandien shenja

se, në mungesë të bekimit qiellor, jo rastësisht rrezikojmë terrin?

Nuk është fjala për dhunti profetike, por për vizione të shkrimtarit. Mjafton thellësia e njohjes së realitetit, që leximi i së nesërme të vijë si përfundim i shkallës maksimale të njohjes së botës. Me plagë të trashëguara dhe të ndodhur përballë mjaft rrjedhave negative sot, pa imunitet e mekanizma të nevojshme për t'u mbrojtur, mbase çdokush përjeton kapërcyellin më të rrezikshëm për qenie dhe identitet. Dhe të gjithë ne jemi dëshmitarë të asaj që ndodh, të gjithë personazhe e karaktere, kritikues e mohues, lavdërues e mburrës, përkras të së vërtetës dhe të gënjeshtërës, të kaosit dhe të anarkisë, të Shqipërisë së refuzuar dhe të Shqipërisë së pranuar.

Të tillë, bashkërisht me personazhet dhe me shkrimtarin, jemi të përfshirë në romanin "Apokalipsi sipas Shën Tiranës", në këtë tërmet përmbajtësor dhe estetik të Zija Çelës.

Një monument epik

Ndjeshmërisë krijuese të formatit Zija Çela i mjafton një bamirës anonim, që depoziton një çek, për t'ia ndezur sensorët e imagjinatës krijuese dhe për të sjellë "Arkipelagu Spiritus" (2014). Është një vepër plot rrjedha të ndërlikuara e të pleksura, përballje e përplasje, mjedise të prekshme e zvetënim shpirtëror të jetës, një roman gjithashtu plot shenja të universale.

Duke i krahasuar gjallimet paralele të "Arkipelagut" me të vërtetat reale, romani artikulohej si monument epik i madh i kohës shqiptare, por edhe i njerëzimit. Në krahet narrativë të këtij fluturimi, Lavidani është sa qytet (a kryeqytet) shqiptar, sa qytet global. Rrugët e letërsisë gjithnjë janë të panurmëta dhe lexuesit hyjnë në komunikim, duke kërkuar çelësin e veprave. Zija Çela, në veprën e vet të madhe, përmes shumësisë së personazheve gjakan ta kuptojë botën dhe universin. Ngjarja vendoset në qytetin e Lavidanit, që kësaj here vjen nga një tjetër perspektivë dhe ofron një tjetër perceptim, sado që si valë narrative kemi sërish një portret artistik të përditshmërisë shqiptare. Ashtu si te romanet paraardhëse të shkrimtarit, edhe tek "Arkipelagu Spiritus" pulson shqetësimi dramatik për njeriun dhe njerëzimin, brengë e ankthshme e autorit. Brenda një harku kohor dhjetëvjeçar, Zija Çela lëshon ngulmueshëm alarmin në kërkim të mirësisë njerëzore, ulërimën kundër urrejtjes dhe gojës që vjell helm, klithmën për nevojën e humanitetit dhe mbrojtjen e shpirtit që përditë e më shumë thahet, mposhet nga lakmia e grykësia, nga egoizmi e zullumi, nga shkëlqimi i vlerave morale dhe etike.

E madhe është klithja romanore e këtij autori të shquar, jehona e së cilës shtrihet përtej qytetit shqiptar.

*

Le të provojmë të depërtojmë, përmes portave narrative të Zija Çelës, në qytetin imagjinar me emrin Lavidan.

Në këtë qytet kalohet përmes një kumti, i cili të step dhe ta ngrin gjakun që në faqet e para. Nga Instituti Ndërkombëtar Spiritus, i cili monitoron shpirtin e qyteteve të botës, vjen lajmi se Lavidani është futur në regjistrin e qyteteve me shpirtin në grahmat e fundit. Kujt i adresohet ky lajm? Bestar Kalarit, drejtorit të filialit lokal të Institutit. Por këtë kob të rëndë ai s'mund ta mbajë vetëm për vete. Prandaj, megjithëse e ka të ndaluar nga qendra eprore, ia jep edhe Aleksandër Markajani, kryepar i Lavidanit. Por, nga ana e tij, as kryebashkiaku s'mund t'ua fshehë qytetarëve lajmin e kobshëm, prandaj e bën publik. Veçse e bën publik bashkë me thirrjen mobilizuese për të shpëtuar Shpirtin e qytetit.

Dhe beteja nisin gjithë stimuj. Kush shtron një rrugë, e pagëzon me emrin e tij. Kush hap një shesh të ri, përveçse i jep emrin, vendos aty edhe bustin e vet. Kush gjen Kodikun që ka humbur, merr mirënjohjen e qytetit. Kush i kthen Lavidanit lavdinë që ka pasur në kohët e moçme, ia zbardh faqen dhe shpallet shpëtimtar. Dhe del se, sipas disave, këtë lavdi e paska pasur vërtet dikur, pasi Troja nuk gjendet atje ku thotë Shlimani, po diku pranë qytetit të tyre, në mos është vetë ky qytet, Lavidani i sotëm. Kështu, të lëshuar në një dalli serioziteti e kompleksiteti, lavidanët nuk lënë asgjë mangut. Për të provuar prejardhjen e lashtë, ata improvizojnë



edhe luftën e Trojës, duke arritur vetëm një përfundim të sigurt: vrasin njëri-tjetrin. Këto janë disa nga goditjet e narracionit furioz, që në afro 600 faqe do të rrokjin çdo skutë të Lavidanit, do të shtrydhin çdo qeskë vveri e ligësie, zilie e dashurie, marazi e marrëzie, të mbledhura dhe të shtresuara nëpër mote.

*

Nën kontrollin e tempos së rrëfimit nga autori, lexuesi do të shohë e do të bindet pse lavidanëve përditë e më shumë u thahet shpirti. Është narratori ai që e udhëheq në shpalosjen e shtigjeve të mbidheshme e të nëndheshme, dramave, hireve individuale dhe kolektive, psikozaive të engjëjve dhe djajve. Dhe, gojë plot, si të parët e si të dytët njësoj hiqen, hiqen sikur, për ta shpëtuar shpirtin e qytetit, jepen pas bëmave që bëjnë... Këta të dytët sidomos, edhe kur dhunojnë e vjedhin, edhe kur përdhosin e orgjinojnë, edhe kur tradhetojnë shtratin bashkëshortor, edhe kur ia hedhin njëri-tjetrit e veçmas komunitetit. Fshikullon diskretshëm dhe me elegancë autori, ndërsa në çaste të veçanta shigjeta e tij flakëron edhe haptazi.

Zija Çela krijues e vuan rëndë krizën e vlerave shpirtërore. Kur nuk u mungon hapësira për të qenë të lirë, pra pikërisht kur janë të lirë, lavidanët nuk dinë t'i japin vlerë lirisë, përkundrazi e gërryjnë nga themeli qytetin e tyre, e bëjnë model abuzimi, arenë tregu të egër, ku lufta për pushtet e pasurim, metodat mafioze, grykësia e bërriylave dhe stërkëmbësive janë brutalisht marramendëse dhe vënë çdo gjë në lëvizje. Modeli i lirisë shqiptare e trondit shkrimtarin që, sa më tepër e vuan bjerrjen e vlerave shpirtërore të qytetit të vet, po aq e acarojnë veprimet e protagonistëve. Dhe, me synimin si nëntekst që të ndryshojnë, merr penën-kamzhik për t'u mëshuar dhe për t'i mëshuar njëherësh, ashtu si në romanet e këtij cikli që siç e kemi theksuar, së bashku me "Arkipelagun", shkrimtari Mehmet Kraja i ka cilësuar si saga alegorike më e madhe e letërsisë shqipe.

*

Parakalojnë në faqet e këtij romani më shumë se njëqind personazhe. Janë të të gjitha ngjyrave e strukturave, profesioneve e prirjeve, veseve e virtyteve. Të hapura e të gërshetuara janë edhe storiet e degëzuara lagjeve të Lavidanit, vargëmat sa në rrafsh fantastik e sa në atë real, kufi që poetika narrative e Zija Çelës e kapërcen natyrshëm, me lehtësi dhe bukuri estetike.

Të mpleksura, me rrezatim të ndërsjelltë vijnë ëndrrat e gëzimet, dhimbjet e trishtimet, dashuritë e mëritë, besimet e mosbesimet, bindjet, frika dhe Zoti, vdekja dhe lindjet, familja, bashkëshortja, seksi dhe jeta e dyfishtë, varfëria, pasuria, morali. Vijnë valë të qeta por edhe vërshime kërcënuese, që paralajmërojnë, ftojnë dhe përgjërojnë krejt në frymën e mbrojtjes së Lavidanit, i cili, ashtu si shumë qytete të tjera të botës, rrezikon ta humbasë individualitetin e Shpirtit të vet.

Zija Çela ia del të menaxhojë me kompetencë tërë korpusin e personazheve, tërë atë zinxhir të pafund veprimesh e situatash. Po me kaq siguri arrin të mbajë nën kontroll "penjtë" që e vërshojnë qytetin nga të gjitha anët, duke përfshirë edhe personazhet që heshtin një kohë, por që përsëri do të shfaqen në skenë gjithnjë me hiret e karakteristikat, ngjyrat dhe individualitetin e tyre. Duket qartë se narratori e një mirë e me themel qytetin, prandaj portretin dhe rrëfimin i sjell në plotësi. Ai e njih historikun, të sotmen e të nesërmen e tij, vizion që ia parandien intuita e saktë krijuese, i një qytetarët nga nxjerr shumësinë dhe pakicën përballë tyre. Narratori, po ashtu, bën kujdes të mos ndërhyjë, të mos flasë në emrin e asnjërit; nuk i qorton drejtpërdrejt të parët, nuk i mburr as të dytët; i lë të sillen, të flasin, të veprojnë siç janë në thelb, duke i nxjerrë sheshit edhe atëherë kur mëtojnë të fshihen.

Pikërisht në këtë rrafsh, si tekst që përshfaq atë që e fsheh, është e veçanta e diskursit narrativ të Zija Çelës. Edhe personazhet që me kast sillen si kalimtarë të rastit, edhe qytetarët e ngulitur në Lavidan, grykësit që përpigën të rrembejnë çfarë u sjell dita, apo ata që të nesërmen e mendojnë të sigurt, si në psikoza parapërmbytëse, autori i mirëpret në sheshin narrativ të qytetit. Në rreth pesëdhjetë rrëfimet që përbëjnë tërësinë e "Arkipelagut Spiritus", gjejmë

po kaq këndvështrime, horizontale e vertikale, mbi qytetin dhe karakteret e lavidanëve. Në përgjithësi, magjia tërheqëse narrative e shpalimit dhe vetëshpalimit vjen shije mirësie. Autori vetëm sa nxjerr në skenë e madhe qytetarët, aktorë dhe auditor bashkë, duke e përfshirë edhe veten si dëshmitar i pakontestueshëm, i cili herë sikur e fsheh lotin, herë sikur qesh e përqesh fisnikërisht, pa helm në pendë. Rrëfimi romanor i Zija Çelës ka dy shtylla kryesore mbështetëse: në njërin krah personazhet, në tjetrin imazhin e situatave. Nervi qendror narrativ funksionon përmes sjelljes, veprimeve, zbulimit dhe shpalimit të botës së personazheve që, pavarësisht statusit të tyre, kanë objektivitetin dhe besimin e plotë të autorit. Prandaj të besueshme bëhen edhe skenat përgjatë romanit. Është besim që bartet gjithashtu te lexuesi. Sepse çdo qytet, shqiptar e global, ka personazhe të dorës së parë që i japin ngjyrimin dhe aromën kryesore ambientit, në këtë rast Lavidanit. Mund të veçohet kryepari i qytetit, Aleksandër Markajani, i cili i thotë njëherë kryepersonazhit tjetër, Bestar Kalarit, shefit të filialit Spiritus:

"A di të më thuash, o Kalar, si shpjegohet që ngado të shkosh dhe këdo të takosh në këtë qytet, të vjen të çmendesh?"

Këto veçori identitare të secilit personazh, jo vetëm që ruhen saktë gjatë tërë rrëfimit romanor, por edhe më periferikët janë plotësisht vetvetja, një mrekulli e poetikës narrative të Zija Çelës, e prozës së tij në përgjithësi.

*

Edhe në nivel të diskursit narrativ, ky autor i veçantë është i formatit të madh. Turbulencat e brendshme, të kontrolluara e të artikuluar me mjeshtëri, janë tharmi estetik i kësaj poetike. Rrëfimi i Zija Çelës të mban përherë zgjuar, meritë edhe e ritmit të gjallë dhe pasurisë së detajeve, të nxit kërshtërinë për atë që sjell fjalja, pasuri i radhës, ritmi i situatave që rrjedhin pandërprerë. Në këtë diskurs narrativ, tërë personazhet e korpusit të madh janë në lidhje e raporte të gjalla komunikimi me njëri-tjetrin dhe lexuesi bën kujdes të përqendruar për statusin e tyre, karakterin, filozofinë, veçoritë njerëzore.

Ardhja romanore e "Arkipelagut Spiritus" në prozën shqipe ka parashenjë njohëse vetëm të Zija Çelës, në frymën edhe të një perceptimi borhesian për botën e njerëzimit, për gjithësinë. Në ndërtimin e personazheve, karaktereve, kjo poetikë është e shkollës borhesiane, bulgakoviane, salmaniane dhe të shkollave të tjera të mëdha, por të ngjizura e të rritura në truallin shqiptar. Modelet teorike, si lexim, janë të papërdorshme në zbërthimin e modelit narrativ të këtij romani.

Fundja, çdo model teorik për leximin e letërsisë nuk është tjetër, pos konstrukt teorik. Asnjëherë nuk ekziston një teori, që do ta përkapte tërësisht cilëndë vepër letrare. Romani i Zija Çelës mund të thuhet se është thurje mes romanit realist, atij magjik dhe fantastik. Realist është diskursi, përqaqja paralele me botën që sillet tërthorazi, hapësira, gjeografia, koha reale e ireale, historike e mitologjike, personazhet reale, por jo rrallë me prirje fantastike, kur e kur me prirje të papritura, të pakontrolluara, fluturuese... Vetë Instituti Ndërkombëtar Spiritus me filialin në Lavidan (si të themeluara nga një qendër tokë-qiell), nga ku vijnë impulse e shenja misterioze për treguesit shpirtërorë të botës, janë një poetikë mikse, këmbë e kokë zijaçeliane. Dhe, në këtë kontekst universal, janë gjithashtu përbërës të rëndësishëm të natyrës narrative postmoderne.

Ja përse, siç kemi argumentuar edhe më parë, besojmë se Zija Çela është shkrimtar formati me qëndrim dhe vizion qartësisht të formuar ndaj njeriut dhe botës. Është përditshmëria, kërkimi dhe vetëkërkimi dramatik i saj, që e nxisin dhe e shqetësojnë këtë shkrimtar, tema që e ndjell dhe përthith ndjeshmërinë e frymëzimit të autorit; është vizioni i tij ndaj realitetit të sotëm shqiptar dhe përtej këtij realitetit, si kapërcim i hapësirës dhe kohës reale; janë fuqia dhe origjinaliteti i ekspresionit narrativ, perceptimi e filozofia origjinale mbi gjithësinë; janë rezonancat e kumteve të forta dhe fryma gjithëherë e pranishme e dashurisë përballë urretjes, e jetës përballë vdekjes, që e bëjnë shkrimtar të madh Zija Çelën.



Pas Italisë botohet në Francë romani "Metamorfoza e një kryeqyteti" i shkrimtarit Ylljet Aliçka

Këto ditë është botuar në gjuhën frënge romani "Metamorfoza e një kryeqyteti" i shkrimtarit Ylljet Aliçka, përkthyer nga Mishel Obri (Michel Obry), botuar nga shtëpia botuese L'Esprit du temps.

Romani "Metamorfoza e një kryeqyteti" është botuar në vitin 2020 nga shtëpia botuese ONUFRI.

Në prezantimin e librit në rrjetin e njohur Fnac skruhet ndër të tjera se:

Romani i fundit i shkrimtarit Ylljet Aliçka, "Metamorfoza e një kryeqyteti", mund të konsiderohet një etapë e re në letërsinë shqipe. Ky roman është novator si në shkrim ashtu edhe në rrëfim. "Metamorfoza e një kryeqyteti" vë në skenë ndryshimet e papritura dhe përfundimtare shoqërore që shoqëria shqiptare ka përjetuar vitet e fundit. Autori, i cili nuk u largua kurrë nga humori i tij i zi, e tërheq lexuesin e tij në një vorbull ngjarjesh që duket se ndodhin teksa lexojmë.

Çështjet që ai zbulon, realizmi i tij «çehovian», ironia e tij e pamëshirshme, këndvështrimi i tij për tjetërsimin dhe pretendimet e lidhura me stilin e veçantë maverik të Ylljet Aliçkës, e bëjnë këtë roman ndër më të mirët nga të gjitha botimet e letërsisë pas diktaturës, pikturën e një epokë që prodhoi kaq shumë antiheronj që u mundën nga grotesku i ekzistencës së tyre.

Eshtë një roman mbi përditshmëritë e jetës rutinë të një kryeqyteti nën diktaturë dhe postdiktaturë: një laborator i natyrës njerëzore.

Evolucioni i personazheve të këtij romani "zbulon" se deri ku shkon nënshtrimi, kuraja dhe dhunimi i njeriut, ndjekur nga çorientimi shpirtëror që pasoi rënien e komunizmit, me boshllëkun përkatës të vlerave, duke u bërë shkak i shfaqjeve të identiteteve fiktive të improvizuara te shumë njerëz.

Një parodi e drejtpërdrejtë, ku janë përmbledhur në një vend rrëfimet "popullore" për periudhën e vonë të diktaturës dhe "rëshqitjen" e saj graduale në demokracinë kaotike...



Ike!... – Huejda!...

...Ike atje ku, kurrresi, nuk e desha.

Në pamundësi për të qenë i pranishëm atje në Luksenburg, që ta kry shërbesën në rrjedhën e lotove... – me dorën time... – do të kërkoj *sesinë* të porosis dikë, që të vendoi mbi rëndesë lule të pathashme... o shpirti engjëllor! Lule, xixë të bardha do të përzgjedh – mëmësia e të gjitha ngjyrave... – të bardha, si dëlira e shpirtit të pangjashëm, me ate që mbylle ditë-netët e jetës mbi rrokullinë Tokë...

U dashka edhe zotësi për të shtyrë bëmat lotsjellëse të jetës. Seç ndjejë?!... Një rëndesë që sikur të gozhdoka frymën. Me gulçime gjoksi për të shtyrë dhimbje... Me dy lot që topëzohen dhe parësojnë për tu rrokullisur nën qepalla. Ngase, ike atje ku, kurrresi, nuk e desha. Në peshën më të rëndë që u sajua për gjallesën njeri.

Në rrekjen për ta përzënë mëtutjen... mbase, qetësohesh macahere, kur shkulet ajo fjala e paplotë NGUSHËLLIME!... Sesi?! – fjalë mashtruese më duket... – disi rrenacake, që mburrecet se rehaton shpirta... Unë do rrekem për ndryshe... Në pamundësi për të qenë i pranishëm atje në Luksenburg, që ta kry shërbesën në rrjedhën e lotove... me dorën time, do të kërkoj *sesinë* të porosis dikë... (ishalla Nushin tënd dhe Djanushkën time...), që të vendoi mbi rëndesë lule të pathashme... o shpirti engjëllor! Lule xixë të bardha do të përzgjedh – mëmësia e të gjitha ngjyrave... – të bardha si dëlirësia e shpirtit të pangjashëm... o Huejda! Me ate që i mbylle ditë-netët e jetës mbi rrokullinë Tokë...

Nuk e harroj natën e takimit me Ty. Nodhi në pjerrinën jugperëndimore të Qytetit Studenti, në tabanin e asaj "shtëpie" tip tironse, në truall dhe të ngjeshur, që i përfshinte të gjitha, përrotull qosheve dhe mureve. Me dy divanë, sajesa të "Misto Mames" – (që ende s'e di, në ka qenë djalosh i punimit të drurit, ai Misto gjynofqari...) Karshi divaneve, nja mbi pesë a gjashtë metra përtej vështrimit, dy sepete kalumode, palosur cule mbi to... Brinjë ture "magjia e bukës", me dy anësi dyrësh dhe katër xhama në ballinë, veshur në sheshinat nga brenda me qëndisma të bardha – plot mendje arti... Pa harruar edhe në koridorin e vogël para a përtej derës, furnellën e vajgurtë, ku tri femrat: mëma Hajria dhe dy motrat Nushi ene Voci, uleshin në stolin e vockël dhe i kavardisnin Cenit ndonjë të shishme për të përcjellë faqoren e rakisë... Atë natë të së martës u kavardis diçka më shumë për në pjatancat e shtuara. Edhe për dy-tre komshinjtë *robmirë*, që shtuan ngjitur përbrinjë tavolinën e tynë. Shtuan edhe karriket për vehte, njëra edhe për mua, me nja dy pëllëmbë çilte. Dhe... me ABC-në e të thjeshtës... – asaj nate jam "diplomuar"!... Në tabanin e shtëpisë dhe varfërisë tironse... hovi kulmor i gëzimit, sikur qe paqtuar vlerëshëm në ate pakësi njerëzish të mbledhur nga anësi dhe largësi e botës... – të bardhë... të zinj... mulatë... – ngjyra dukshëm... lumturi që nuk u shua as në ndritimin e mëngjezit të ardhmë. Edhe mbi pjatat e përmbysura. Edhe mbi tavolinën e dërrastë... Me lugë, pëllëmbë e gishtërinj, ngjashëm me shkathtësinë e shkopinjve të Xhekut (Rrem Dauti), i përzgjedhur namshëm për orkestrinën e hotel "Dajtit", me çimka nën tavolina...

Dhe, mbi të gjitha pa harruar hiç kujdesjen për Ty, o engjëllorja vogëlushe!...

Se Ti, atë të martë plot hënë, fillnise të shtysh hapat e para të jetës... Me të "dejurën" lëkundëse të pasigurisë foshnjore. Që shkulte nga gjokset e të pranishmëve, nur lumturie... të qeshurat e zhurmshme... "qyqa-qyqa"... UA të ankthshme... dhe sekonda përplasjeje edhe të dhimbshme... Siç e "pësuan" kokat e Nushit dhe Vocit, ku, aq përshpejtuar, anuluan kujdesjen për rrëzimin tënd o Huejda... Dhe, me dhëmbë të shtërnguara vunë dorën në lule të dhimbjes. Unë, në çast, e lëshova fotoaparatin në varjen e qafës... Të ngrita Ty me gishttrinjtë e pëllëmbëve mbi çdo kaptinë gojëhapur për anash tavolinës, dhe të lëshova

IN MEMORIAM

HUEJDA ELSAIED – dëlira e shpirtit pa hiç hile...

(16.03.1975-23.11.2021)

nga Besim Fusha



mbi pjatancat e përmbysura, në mes të duarve të zgjatura... Burrat shikonin çereqeshun... Gratë thanë: "... hajde ke shpirti i tetës!... O engjëllushi i Zotit!..."

Ka qenë përvjetori i parë i jetës tënde, o Huejda! 16.03.1976. Nata plot hënë jo vetëm e së martës. Ngase, edhe më përtej ngjashëm vazhdoi, derisa u përfaqëzueshëm me ndritimin e së mërkurës...

Dhjetë vjet më vonë negativët e asaj ceremonie u dogjën... Në sobën që përhinte dru më pak sesa xhaurra, për të ngrohur zyrat dhe shkrythur disi të mardhurit: *rob e zot...* të "Pionierit". Aty në kapërcyell të janarit 1987, u dogjën... Në vilën njëkatëshe në fillësë të rrugës "Budi", që, më në fund, shteti ia pat njohur pronësinë "Speces" (Dejes). Në vilën

– vlerë *italiane*, që dikur (1941), tregtari i miellit, Nexh Reka, e pat ndërtuar me merak për "jvegën perri"... Qe tregtari durrsak, me mall e emën macahere dhe pa hiç mall e para mbas Luftë, nëpërçud – me pësime çudivaki: deri me kocka të thyera kushedi në çgreminë a ç'garronë... më e shumta sesa në ndonjë biçim varr, aq më përçud të paditur... Kështu. A thua se vetëm Nexh Rekës së "Speces" perri? Edhe mijëra gjynofqarëve iu vra ndershmëria dhe mirësia... Qenë kohë ligësie çudi që nuk dinte t'i pillte as Zoti... Përveçse njeriu i vetësajuar: "i Ri"...

... u dogjën!... – nisi pasazhi i sipërm. Përse u dogjën?! Qenë kohë që pillnin vaki kurrë të papame. Kaq! Mos pyesni as Ju!... Së paku, jo për këtu. Lyp tjetër hapësirë kjo nodhi. Ajo kohë shqiptare ku rastisi të gjalloj, polli ngjarje varg, bëma çudi... aqsa dhe ashtusi,

edhe *përsëtë* varganë sajojnë histori rrëfimtare asisoj që të largojnë e zhyzin në jetësi të tjera superçudi... – gati deri në kushediku...

Sidosesi, 1987, qe një rënie. Jo për së pari, edhe herë të tjera jam rrëzuar... Por, rënia këtu qe më e bujshmja e viteve të gjallesës. Qe edhe e vetmja vakiçudi namtutje – tejmeje... Sidosesi, përsëri u ngrita. Ngase, besoj fort që fuqia e besimit për tu ngritur, i bën njerëzit më të mirë dhe më të mëdhej...

...Sigurisht, një përzgjedhje të pozimeve nga ceremonia e macahershme, i stampova në opake kartolinë. Dhe, ia adresova Djanushkës së mirë. Ti Huejda, duhet t'i keshë parë më vonë. Madje, mbase, si piliveskë e përkëdhelur që po rriteshe, edhe mund ta keshë grisur ndonjërin... Sidosesi, për nevoja të fotoarkivit, që përherë e kërkon e nesërmja... thash të eci në rrugëtimin e mundshëm që kishte mbetur. Thash të mund të riprodhoja ç'mund të gjeja. Ngase arkivimi i fototekës time, përherë më është dukur i mangut pa negativët e shkrehjeve të asaj ceremonie. Dhe, e ndava mendjen, këtë detyrë thash të ta porosis Ty, o Huejda! Që t'i fotografoje a skanoje pamjet dhe t'i nisje në adresën time. Takova Vocin dhe ia dhash porosinë, bashkë me e-imelin... Por, pritja mori fund në mëngjesin e gjëmës së madhe, më: 23 nëntor 2021.

Kështu, Huejda!...

...nuk e dija që Ti paske pasur aq shumë siklete. Dashje... për sado pak rehati shpirti!... Po t'i dija sikletet e tua... nuk do të dija të gjej fjalë a mundësi për ta shkukur ngërçin që ta paska grricur rehatinë... Ngase, si shpeshherë, kurthi i trysnisë, më mbërthen me pengun e padijes dhe pamundësisë për të qenë veprues në bëma bamirësie. Nodhi edhe që trishtësh deri në gulçime. Që të gozhdojnë në habi dhe dallgëzime gjoksi. Siç nuk po e dua trishtimin lotsjellës të këtij mëngjezi të së martës – 23.11.2021. Plot dhimbje për një shpirt engjëlli që po thuhet se iku... Jo!... Këtë gjëmë nuk e desha!

...edhe ngase, o Huejda, të kam pasun modelen e parë në ndërtimet fotografike. Veçanërisht kur më duhej të grupoj fëmijët e racave të botës. Për të sajuar imazhe a fotomontazhe që figuronin shtypin në ditën ndërkombëtare të fëmijëve. Ku më duheshin figurantë të bardhë... të zinj... mulatë... të verdhë... a ç'ngjyrimë e ç'bukuroshë të gjeja. Për të "aktruar" qeshjen e madhe të përbashkimit paqtor...

Dhe kjo nuk qe hiç kollaj. Duhej ditur nga ç'familjarë ishin "gatuat" ata vogëlushë. Ku punonin prindërit... Sa dashamirë ishin me ecuninë dhe jetësinë shqiptare?!... Edhe pse të huajt që punonin këtu (në ambasada... në RTV – për emisionet në gjuhët përkatëse, a gjetiu...), qenë të përzgjedhur dhe të mirëverifikuar, prapsepap, ishin në vëzhgim të pandërprerë. Ti Huejda i di këto. I mësove avash-avash, ndërsa po rriteshe... me pësimet edhe në jetësinë e prindërve... Me Babin që përndiqej e përzehej... me Mamin që u lodh duke kërkuar dhe ëndërruar lejen e përbashkimit. Madje, le ta themi sot, ate që shqiptarët dhe botërorët nuk e dinë, edhe se ç'më ke thënë Ti dhe Mami në tempullin e së vërtetës: ... ministri a zëvendësministri(?) Feçorr Shehu, e thirrte Mamin enkas në zyra (dhe, mami të merrte edhe Ty...), për t'i bërë pyetjen: "hë, a ndave mendjen?!..." Le ta kërkoj gjindja fjalën shqipe STËRVINË... dhe do ta mësoi llahtarën... se ç'ishte ai ministër... ai njeri... dhe, ajo kohë...

Ç'ka sapo thamë, ndodhte në kohën kur gjermanka (Ana) e gjermanishtes në RTV, i gjeti **morra** në kokë, evlatit Nils Guldjen, që kalonte ditën shkatis me fëmijët e çerdhes gjashtë. Gjermanka, e llahtaritur, e çakërditur... thirrte: "Kafshë të egra në kokë... Nilsi ka kafshë të egra në kokë"... "Alarmi" kapi gjindje e shoqëri, çerdhe e ministri... Shqiptarët mendjetop, qeshnin krejt pa çudi: "... asnjë risi, përtej të zakonshmes, nuk ka bo vaki..."

Kështu Huejda e mirë – vlerëforini (pa asnjë medalje zyrtare!?) E di që të lodha, por le

Huejda El Saied

roman



Onufri

Huejda El Saied

Ngjyra e lëkurës sime

BESIM FUSHES
ME SHOME RESPEKT
DHE MIRËNJOHJE
HUEJDA
ELSAIED

roman

Onufri

të them edhe diçka që është ulur dystaban dhe nuk do kurrësi të ikë nga qoshja e kujtesës... Çasti kur erdhe enkas dhe më solle librin: "Ngjyra e lëkurës sime" – roman, i botuar nga "Onufri" – 2000.

Kam firmosur ene nja dy fjalë të sinqerta... – më the.

Roman!? Ua ç'mrekulli! E dija që diçka po shkruan, por...

Dhe libri më ngriu në mes të duarve, nën kureshtinë e vështrimit. Të vura pëllëmbën mbi kaçurrela dhe të mbështeta si fëmijë në anësinë e brinjëve të djathta.

Bravo! Bravo Ti Hyejda, bravo "Onufri"! Fillo librin e dytë tani dhe vazhdo, mbushe stivën... Do të më keshë përherë lexuesin e parë, por edhe qortuesin pa mëshirë... Se dashamirësi i letërsisë do shtrydhje... Do shpirt dëliri...

Të pëlqen?
Libër i bukur! Ene kopertina – simpatike. Po më vjen një çik zili që nuk jam unë fotografi!... Sidosesi, mirë. Edhe Fabrice Toledano – mirë!

E kam menduar vetë ndërtimin e kopertinës. Dhe, u binda për kështu. E zbatova në Francë, ngase nuk desha asses të le shteg për ndonjë papëlqesë nga botuesit shqiptarë.

Sidosesi, më bëre të lumtur. – (Dhe e putha romanin, siç bëj përherë për çdo libër që nisem për në bibliotekën time.) – Besoj fort në çke "gatuat"... Dua me shpirt të jesh vetvetja...

* * *

Kokëepoka kur lindim nuk e fal dashjen e njeriut për të zgjedhur. Nuk zgjedhim asesi se në ç'rrjedhë geni duam të "gatuhe mi". As se në ç'fisi... ç'baba a mama na takon për hise... As se në ç'anësi të botës... në ç'shpellë a kështjellë... në ç'kasolle, banesë a qytet, nisim të marrim ajrinë... Mbas hapave të para të jetës, kuptojmë avash-avash, se nga ç'qenësi a gjallesë jemi gatuat... Për fat jo nga ç'ha krimbi ase fisni krimbashi... Paskemi lindur njerëz. Njerëz që gjithësi, na përket të lodhemi për t'i shtypur krimbat...(!?)

Kështu, Huejda! Disi kështu ma nxite fantazinë, kur nisa të lexoj librin tënd të parë nja mbi njëzet vjet të shkuara. Asohere kështu hamendësova. U vetbinda se rrjedhave të ecurisë do ta zotërosh veten... – do të derdhësh mirësinë e dëlirit të shpirtit, krejt pa hile... Do të dish të ecësh, brinjë akrepit të fatit edhepse tjetër kush e kurdis...

Sidosesi, mbase edhe me mund, do të sosësh në cakun e mrekullisë që ëndërron... Po Huejda! Kështu paska ndodhur. Paskë vëzhguar dhe mësuar mençurisht, paskë kapur veçantinë... Qenke plotpushtuar nga dashje për të qëndisur mrekulli njerëzore. Dashuri njerëzore!... Edhe tani së fundi, kur fati të spërkaste veçse me ca grimca mirësie, përballë dite-netëve të mbushura me malmakthe trishtimi... shpirti yt parësoka ëngjëjt... – ngase, i "dehur" lumturueshëm me madhësitinë e dashjes së jetës njerëzore... paska përzgjedhur së fundi, ditën më të lumtur të jetës tënde...

Ja mesazhi:
"Babë e bir..."

Duart më të bukura në botë për mua. Miqtë e mi, sot kam zemrën plot dashuri e krenari. Ashtu si dhe secili prej jush edhe unë kam shumë arsye që të mburrem. Ardhja e Gabrielit në jetën time dhe më pas ajo e Thierryt në jetën tonë, ishin ndër gjërat më të bukura që kisha përjetuar deri më 2017. Por 2021-shin pavarësisht gjithë problemeve që ka sjellë pandemia, do të mbetet viti më i bukur për familjen tonë. Tashmë jemi ligjërisht të tre një familje e vërtetë, se të tre kemi mbiemrin Grosjean, unë nga martesja dhe Gabrieli nga birësimi. Më në fund kam familjen që kam ëndërruar. Thierry me shaka thotë që na ka zgjedhur Gabrielin dhe mua në katalog, por Gabrieli dhe unë themi të njëjtën gjë për të, ndaj falënderojmë Zotin që bëri që Thierry të "hapte" faqen ku ishte fotografia jonë e nuk u tremb teksa pa që po lotonim. Përfundimisht jeta ka më shumë imagjinatë se ne dhe është e bukur, shumë e bukur madje".

Janar 2022

Me "Vajzat me çelës në qafë" Arapi nuk ka shkruar vetëm një roman shqiptar, por i ka shtuar mozaikut të kujtesës europiane një gur intensivisht ndriçues.

TË MËSOSH TË MARRËSH FRYMË

Nga Insa Wilke

kritike e njohur gjermane e letërsisë, publiciste, e nderuar me çmimin gjerman të kritikës, "Alfred Kerr" mbi letërsinë e Lindita Arapit



Insa Wilke, foto nga Mathias Bothor

Sistemi bunkerizues absurd i diktatorit Enver Hoxha. Apo pallatet shumëngjyrëshe të Tiranës që artisti Edi Rama i leu pas zgjedhjes si kryetar bashkie në vitin 2000 për të përmirësuar atmosferën në kryeqytet. Kuriozitetet e tilla të bien ndërmend, kur bie fjala për vendin e vogël mesdhetar Shqipëri, që në vitin 1990 arriti të shkundë nga vetja diktaturën.

Lindita Arapi, shkrimtarja shqiptare që jeton në Bonn sot dhe punon për Deutsche Wellen sheh diçka tjetër: "Vuajtja/ është asimetria në fytyrat e rregullta/ të shqiptarëve të heshtur/të cilët i dalloj së largu/ edhe pa i njohur i përhëndës" në njërin nga qytetet simetrikë të Europës."

Me romanin e saj "Vajzat me çelës në qafë", të cilin Joachim Röhm e ka përkthyer në gjuhën gjermane me një intuitë të hollë për shtresëzimet kohore dhe tonalitetet e ndryshueshme, ajo e portretizon këto asimetri në fytyrat shqiptare dhe i hyn nën lëkurë shoqërisë së saj. Arapi ka shkruar një roman dramatik, të mençur letrarisht dhe ka formuluar një vizion për një shoqëri të emancipuar shqiptare.

Në roman rrëfëhet historia e Lodja Lemanit, e rritur në vitet 70-të e 80-të në qytetin model D. në të cilin njerëzit "spiunojnë me zell të madh njëri-tjetrin". D. mëton të jetë një "qytet pa sekrete". Në të vërtetë çdo gjest, çdo fjalë, çdo hap është i koduar. Të paktën për familjen Lemani, shtëpiza e së cilës e rrethuar nga aroma e limonëve, vetëm fillimisht na shfaqet si idil.

Drama nis e shfaqet kur në rrëfim hyn nëna e Lodjas. Drita, një grua e bukur, gjithmonë në nxitim, nuk qesh kurrë, duket se ajo fsheh diçka. Drita bën pjesë tek të "toleruarit" dhe me këtë është e dënuar të bëjë një jetë në katapultë bashkë me bashkëshortin e vajzën. Më shumë nuk mësojmë në pjesën e parë të romanit, ku ajo i mbetet besnike perspektivës fëmijërore të rrëfimit, që as nuk e kupton dhe as nuk pyet më shumë për dashakeqësinë e fqinjëve dhe frikën e prindërve. - një metaforë për përgojimin e pushtetshëm ideologjik, paranoid aq edhe iracional në diktaturë.

Mendojmë se e njohim thellë historinë e viktimitave dhe autorëve të krimeve të diktaturave. Por Arapi e rrëfen atë ndryshe, fuqishëm, si pjesë të një konteksti të gërshetuar. Fantazmat e së shkuarës shqiptare nuk janë vetëm ato të socializmit. Romanin e hap një zë nga perandoria e vdekjes. Pengu. Ajo i përket me gjasë gjithë së humbur, Fates, edhe kjo një nga supozimet që e bëjnë më intrigues romanin. "Nuk ka fat më të keq se të ikësh si viktimitë nga ajo botë! Mirë që ta prsin fillin e fatit, sikur të jenë zoti, po të drejtën ti e merr me vete..."

Pikërisht për të vënë në vend të drejtën dhe për të çliruar të gjallët nga pleksjet me padrejtësinë duhet që të rrëfihen historitë e viktimitave. Në roman është Lodja, "vajza me çelës në qafë", ajo që hap derën e së shkuarës e me këtë edhe derën e së ardhmes. Është një rrugë e gjatë për të mbërritur deri aty.

Lodja jeton si studente në një qytet belg, diktatura është rrëzuar. Por fantazmat e së shkuarës faniten ende. Peshja e mistereve të pasqaruara të familjes, rëndon mbi të, derisa një natë shpërthen. Lodja vendos të kthehet në vendlindje për të kuptuar historinë e nënës dhe gjyshes së saj.

Hap pas hapi Arapi krijon panoramën komplekse të një shoqërie të traumatizuar, tek e cila humbja e gjuhës dhe nevoja për frymëmarrje të lirë nuk lidhen vetëm me krimet e diktaturës, por edhe me një padrejtësi më të vjetër, të pa vënë re: përçmimi ndaj gruas i pranuar në shoqëri dhe dhuna ndaj saj. Fatmirja rebeluese është viktima e këtij përçmimi, edhe Lodja si fëmijë e ka njohur përbuzjen. "Ma jep zogun" e ngacmojnë burrat. Duhet të kesh turp nga bukuria, ishte refreni i nënës. Një grua nuk dëfrehet, këtë ia ka transmentuar një gjeneratë tjetër. Arapi rrëfen për këto tradita arkaike me vështrimin analitik të një gruaje moderne. Zemërimi për nënat që vetëmohoheshin kthehet në katalizator. "Vajzat me çelës në qafë" është megjithatë përpjekje për të falur nënën. Autorja nuk akuzon, hap udhë: Ajo kujton për t'u bërë vetë e lirë.

Lindita Arapi ia ka dedikuar vajzave të saj historinë e Lodjas, Dritës dhe Fatmires. Ato janë në një farë mënyre mbesa të Dritës dhe historia e saj le gjurmë edhe tek ato pa e ditur. Kjo mund të thuhet edhe për Europën, në kulturën e së cilës kanë lënë gjurmët imigrantët. Me "Vajzat me çelës në qafë" Arapi nuk ka shkruar vetëm një roman shqiptar, por i ka shtuar mozaikut të kujtesës europiane një gur intensivisht ndriçues.

Insa Wilke, kritike letrare, moderatore dhe publiciste. "Të mësosh të marrësh frymë" u publikua në revistën "Kulturaustausch" dhe u prezantua në radion gjermane "Deutschlandfunk"



Romani lloj letrar i ndërliqshëm që ndryshon vijimisht

Të gjithë ata autorë që janë marrë mirëfilli me studimin e romanit kanë theksuar me të drejtë se ai, si lloj letrar poetik, paraqet njërin ndër më komplekset brenda prozës, po dhe të artit të fjalës në përgjithësi. Kjo ngjet për arsye të mundësive të shumta për shtjellime, për të mos thënë të pafund, sidomos në rrafshin e mënyrës së të shprehurit gjuhësor poetik, pastaj për shumësinë e stileve, për marrëdhënie të veçanta kushtëzuese dhe ndërvarëse të shtresave rrëfimore e të përbërësve të tjerë që përligjin tërësinë kuptimore dhe artistike të këtij lloji¹.

Ndërliqësia e romanit shprehet me të dhënë, sikur thotë Mihail Bahtini, se ai është zhanër që përherë e gjurmon dhe e studion veten, duke i rishqyrtuar trajtat e veta formale. Në të vërtetë, ndërlikueshmëria e këtij lloji letrar shfaqet nga se ai është kosmopolit për prirjen e tij (Vigari) dhe cilësohet me të shprehurit gjithëpërfshirës letrar. Me pak fjalë, është njëri ndër zhanret më të hapur dhe më të pakufishëm, ku rrënohen vijimisht modelet ekzistuese. Së këndejmi, nëse dëshirojmë ta rimarrim mendimin e Shklovskit se – atë që e quajnë zhanër, përnjëmend është njësi konfliktesh (do shtuar dhe kundër konvencionale) – atëherë romani mund të shërbejë si nga më tipikët. Vepra romaneske mund të jetë pasqyrë e realitetit jetësor dhe e përvojës së krijuesit, të ndërtohet rreth një ideje, një teme ose një objekti të caktuar, por ai mund të jetë pa objekt të mirëfilltë, larg formës dhe shtjellimit tradicional.

Romani synon të jetë thesar figurash nga jeta, ose matanë saj, të afërta ose përfytyrues e mitike, shoqërore ose poetike, që çdo herë shqiptohen ndryshe. Romancierit jo vetëm i lejohet t'i shmanget llojit, po çdo gjë në tekstin që e përfiton, i takon vetëm realitetit romanesk, strukturës gjuhësore shprehëse dhe sistemit të ideve, që e bëjnë atë, siç do të thoshte. H. Xhejmsi, trajtën *më të mrekullueshme të artit*. Pra, romani është një krijim individual, ku liria e ligjërimit është e pakufishme; në të gjakohen e shprehen dukuri të ndryshme në gjerësinë dhe në thellësinë e tyre më të skajshme. Sipas Th. Hardit, në roman shfaqet dhembja që fshihet nën gjërat më të mëdha dhe madhështia që fshihet nën gjërat më të dhembshme. Kur gjithë kësaj ia shtojmë mendimin e Floberit se "Ajo që më duket e mrekullueshme, që dua të shkruaj, është një farë libri që nuk flet për asgjë, libër që nuk ka asnjë lidhje me realitetin e jashtëm, libër që do të qëndronte vetëm me fuqinë e brendshme të stilit, sikur toka që qëndron pezull dhe nuk e mban asgjë", atëherë përforcohet dhe më tej *shumësia (polifonia)* romaneske, që kushtëzoi e kushtëzoi mendime të ndryshme, shpesh kundërvënëse, mbi veçantitë e natyrës së tij, veçmas mbi *transformimin* që ai përjetoi prej kohës së lindjes e deri më sot.

Nga rrafshi i qasjes, i shtjellimit dhe i të shprehurit poetik, romani modern del faktikisht si antiroman, përkatësisht zhanër që i kundërvihet vetes (në kuptimin e ndërrimeve që përjeton). Në të vërtetë, romani modern dëshmon më së miri për mundësi të pakufishme shtjelluese dhe për cilësinë e gjyhtëpërfshirjes dhe të gjithanësisë, që nuk e cilëson në këtë mënyrë asnjë lloj tjetër të artit të fjalës.

Për këtë veçanti të romanit modern shkrimtari i shquar argjentinas, autor i disa romaneve, Ernesto Sabato, thoshte: "Dhe, nëse klasifikimi i veprës letrare sipas zhanresh të ngurta nënkupton përherë një orvatje të përcaktuar që të dështojë, kur është fjala për romanin, kjo përpjekje është kryekëput e kotë, sepse ai përbën një zhanër karakteristika e vetme e të cilit është se i ka pasur të gjitha karakteristikat dhe i ka pësuar të gjitha shkeljet". Duke e përmtuar edhe më tej natyrën e romanit modern, Sabato shton: "Me pak fjalë, romani i shekullit XX jo vetëm paraqet një realitet më kompleks dhe më vërtetësor se ai i shekullit të kaluar, por ka fituar një dimension metafizik që ai nuk e kishte. Vetmia, absurdi dhe vdekja, shpresa dhe dëshpërimi, janë tema të përhershme të krejt letërsisë së madhe".

Qenësia e rrëfimit poetik

Vepra letrare matet dhe është e vlefshme para së gjithash për mënyrën e shqiptimit poetik dhe të shumësisë së kumteve poetike që dalin prej tekstit të saj, për format e mëvetësishme të rrëfimit që autori i zbaton dhe për forcën e ndikimit estetik që ajo krijesë letrare mund të bëjë në lexuesin. Të gjithë përbërësit e tjerë të veprës letrare renditen pas këtyre. Kjo ngjet për arsye se, siç thotë Ernesto Sabato, "Vepra e artit kurrë nuk është një soditje e thjeshtë: është një veprim që kryhet midis unit tonë dhe botës, një veprim që e ndryshon botën dhe unën".

Natyrisht, edhe romani hyn në këtë përcaktim e rrjedhë: të shprehurit poetik është përbërësi qenësor, pa marrë parasysh

1 Shih më shumë për çështjet e romanit Mihail Bahtin. *O romanu*. Prevod Aleksandar Badnjarevi. "Nolit". Beograd 1989; shih dhe punimin tim *Romani - zhanër pa kanone*. Në veprën time "Çështjet teorike të letërsisë". Faik Konica, Prishtinë 2005, f. 139 - 142.
2 Ernesto Sabato, *Shkrimtari dhe fantazmat e tij*, vep e përm., f. 99.
3 Ernesto Sabato, po aty, f. 103.
4 Ernesto Sabato, po aty, f. 33.



"Me të tilla zbulime, me fusha kaq të gjera e të mistershme për të përshkuar, me pasurimin teknik që vjen së këtejmi, me transcendencën e tij metafizike dhe me atë çka përfaqëson për njeriun e ankthshëm të kohës sonë, i cili të romani jo vetëm që sheh dramën e tij, po edhe kërkon orientim, si mund të mendohet se është një zhanër në rënie? Përkundrazi, mendoj se është veprimtaria më komplekse e frymës së sotme, më e plota dhe më premtuesja në atë përpjekje për të zhbiruar dhe shprehur dramën e tmerrshme që na ka rënë për hise ta jetojmë!"

ERNESTO SABATO

1 Ernesto Sabato, *Shkrimtari dhe fantazmat e tij*. Përkthyer nga origjinali: Edlira Hoxholli dhe Bashkim Shehu. Pika pa sipërfaqe. Tiranë 2015, f. 103.

se çfarë qasjes, shtjellimesh dhe mënyrash shprehëse ose çfarë strategjie përdor autori në hartimin e tij. Parë nga ky këndvështrim, pikërisht gjerësia dhe pakufishmëria në vëzhgimin e dukurive dhe të shumësisë së mënyrave të shqiptimit, mënyrat e shumta të zbatimit të gjuhës poetike dhe e të shprehurit poetik, jo vetëm tek romanet e ndryshëm, por dhe tek i njëjti, i jep romanit sa mëvetësinë e llojit letrar, po aq dhe vlerën e pamohueshme.


Duke iu shmangur modeleve të përcaktuara, duke synuar që t'i zgjerohet format e vrojtimit dhe të shprehurit poetik, romani mundëson një shumësi të stileve dhe të mënyrave të të shprehurit gjuhësor poetik më të parëndomtë. Si i këfillë romani modern dëshmon vlerën dhe forcën e tij, duke u ngritur në atë rrafsh që nuk e ka pasur asnjëherë më parë.

Gjithë kjo dëshmohej dhe në romanin e Visar Zhitit "Funerali i pafundmë", botuar në Tiranë më 2003⁵.

"Funerali i pafundmë" – roman modern i mirëfilltë

Romani "Oh" i Anton Pashkut, i cili u botua më 1971 nga "Rilindja" e Prishtinës⁶, i dha jetë një mënyre sa të veçantë aq

5 Botimin e dytë të romanit e bëri "Koha", Prishtinë 2021.
6 Për romanin "Oh", për tregimet dhe dramën e Anton Pashkut shih vëllimin *Në mbretërinë poetike. Kritikë letrare për veprën e Anton Pashkut*. Zgjodhi dhe përgatiti për shtyp Anton Nikë Berisha. "Shpresa" – Kuvendi Salezian, Prishtinë 2002.



SHQIPTIM POETIK I LARTËSUARI TRAGJIKES INDIVIDUALE DHE KOLEKTIVE

Nga Anton Nikë Berisha

dhe të rëndësishme të shprehurit dhe të shtjellimit poetik të tekstit letrar, që nuk ishte njohur më parë në letërsinë tonë⁷. Para këtij romani Pashku shkroi dhe botoi, duke filluar nga viti 1955 (vëllimin e parë *Tregime* e botoi më 1961), një numër tregimesh e novelash me këtë frymë⁸.

Nuk është vetëm mënyra e qasjes dhe e shqiptimit të objektit poetik, shtjellimi i tekstit të romanit, po para së gjithash është gjuha poetike që e bënte "Oh"-in roman për shumëçka të veçantë dhe të rëndësishëm në letërsinë tonë⁹. Jan Mukaržovski thoshte se pikërisht gjuha poetike është "[...] më e afta nga të tjerat që të mbajë gjallë vijimisht raportin e njeriut ndaj gjuhës dhe të gjuhës ndaj realitetit, që vijimisht dhe në mënyrë të re të zbulojë shenjë e brendshme të sistemit gjuhësor dhe të tregojë mundësitë e reja të përdorimit të saj"¹⁰.

Se romani "Funerali pafundmë" i Visar Zhitit është një krijesë e mirëfilltë moderne, bindemi nga faja e parë, ku autori ka vënë titullin: "Fletë e grisur nga fundi për t'u lexuar si fillim", pastaj nga epilogu i emërtuar "Antifunerali", po dhe nga kreu i fundit (LXVI), që s'ka fare tekst. Edhe sikur autori të mos i kishte shënuar këto të dhëna në tekstin e romanit, nga mënyra e rrëfimit, nga gërshetimi i shtresave rrëfimore, që e ndjekin njëra - tjetrën, ballafaqohen ose kundërvihen, qoftë në formën e rrathëve, qoftë në vijën vertikale, pastaj nga mënyra si është zbatuar koha subjektive, që nuk u nënshtrohet parimeve të kohës konkrete (historike), nga ndërlidhja e botës së brendshme të individit (rrëfimitarit) dhe të botës së kolektivitetit (në pamundësi që të vihet një kufi ndarës se ku zë fill njëra e ku mbaron tjetra), pastaj të simbolikës dhe figurshmërisë së gjuhës me të cilën është hartuar teksti, zbatimi dhe gërshetimi shpesh i botës së ëndrrës dhe i përfytyrimit, marrësi bindet se Visar Zhiti e ndërton romanin e vet mbi bazën e të gjithë përbërësve të prozës moderne, që në letërsinë e tjera kishin filluar shumë më parë. Ai nuk ndjek një shembull ose një autor, as ndonjë model përkatës; Zhiti e përfiton një rrëfim që në qenësi ngrihet nga të shprehurit e mëvetësishëm, që është fryt i shpirtit dhe i përvojës vetjake; është rrjedhojë e shijes së tij për artin e fjalës dhe e nevojës që kumtet të ndikojnë para së gjithash, estetikisht në marrësin. Pra, autori ka zgjedhur edhe mënyrën e mëvetësishme, edhe stilin, edhe shtjellimin, që ndërlidhen e kushtëzohen nga njëri - tjetri dhe bëjnë dhe ndikojnë si një tërësi. Në të njëjtën kohë shprehet realiteti përkatës, po edhe përtohet, përmes një teksti poetikisht të pasur e të lartësuar, një realitet tjetër, ku asgjë nuk është dominuese, po asgjë nuk është e parëndësishme. Përmes rrëfimit shumë shtresor, jo vetëm rrënohet koncepti i mbështetjes së pandërmjetme të realitetit konkret (të përditshëm), vijimësia e ngjarjes, po në qenësi i kundërvihet atij realiteti. Gjithë kjo nuk shprehet përmes pohimit e retorikës, po përmes simbolikës dhe figurativitetit të tekstit të përfutur. Zhiti nuk i zhvesh, as dukuritë, as mendimet; nuk i vë ato në një rrafsh të thjeshtësuar (cilësi e teksteve që s'kanë natyrë poetike), po synon t'i vëzhgojë e t'i shprehë ato në rrafsh të ndryshme dhe shumëësore. Edhe vetë rrëfimtari shpesh dëshmohej subjekt që ka pikëpamje të ndryshme rreth të njëjtës dukuri ose për synimet dhe fatin e tij; herë i takon

7 Shih për romanin "Oh" punimet e mia: *Konstantet stilistike ose mbi stilematikën e një proze*. Në "Fjala", 15 qershor 1977, f. 6-7 dhe *Metaforika e tragjikes, e absurdit, e protestës*. Në "Fjala" nr. 13, 1980, f. 8 dhe 13.

8 Shih punimin tim për tregimin "Kulla" të Anton Pashkut: *Vetëdija mitike e qenësisë dhe e qëndrësës*. Në "Rilindja", 29.07, Prishtinë 1989, f. 11.

9 Më 2002 botova në Prishtinë romanin *Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar*. Faik Konica, Prishtinë 2002. Për këtë roman u shkruan dhe u botuan 52 punime nga autorë shqiptarë dhe italianë (meqenëse romani u përkthye edhe në italisht me titullin *La sete pietrificata*. Romanzo. Traduzione di Albana Alia. "Luigi Pellegrini" Editore. Cosenza (Itali) 2013. Shih Vëllimin - *Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike*. 52 punime të autorëve shqiptarë dhe të huaj për romanin "Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar" të Anton Nikë Berishës. Zgjodhën dhe përgatitën për botim Albana Alia & Labinot Berisha. Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë 2019; *Romanzo di estremabellëza*. Ventiduescrittori e studiosi italian e arbëreshë sul romanzo "La sete pietrificata" di Anton Nikë Berisha. A cura di Albana Alia & Labinot Berisha, "Faik Konica", Prishtinë 2016.

10 Jan Mukaržovski, *Struktura pesni koga jezika*. Teze Praškog lingvističog kružoka. Zavod za udžbenike i nastavna sredstva. Beograd, 1986, f. 52.

vetvetes, herë është vetëm hija e tij; herë është bindës në atë që rrëfen, herë përligj se gjithë ajo është vetëm një vegim, një ëndërr e beftë ose vetëm këmbim i asaj që përjetohet ose gjakohet – si cak jete ose si mohim. Ngjet kështu nga se “[...] tema e madhe e letërsisë nuk është më aventura e njeriut që vërsulet për të pushtuar botën e jashtme, po aventura e njeriut që eksploron humnerat dhe guvat e shpirtit të vet¹¹”.

Sistemi që e zhveshi shpirtërisht individin

Në romanin “Funerali i pafundmë”, brenda rrëfimit të menduar e poetikisht të ngritur, shqiptohen rrafshe e aspekte të jetës së shqiptarit në sistemin komunist, të shtrirë në një vertikale dhe horizontale sa të gjerë, aq dhe të thellë; ligësitë dhe pasojat që përjetuan njerëzit në jetën e përditshme; absurdi i veprimeve, ku individi e pësoi në format nga më të ndryshme, sidomos në rrafshin shpirtëror. Në marrëdhëniet shoqërore të tilla individi nuk është më i vetvetes; nuk duhet të ketë mendim të vetin, po të mendojë si shumica; duhet ta përligjë mendimin e njëjtësuar; bëhet *trup i përbashkët i turmës, masë tallazuese* që i nënshtrohet logjikës kolektive të përcaktuar nga politika; e braktis vetveten dhe shndërrohet më tepër në objekt që përdoret nga udhëheqësit e sistemit dhe shndërrohen në shërbyes, koncept ideologjik i shndërruar në epidemi të rrezikshme. Individin nuk e cilësojnë vlerat morale dhe ndjeshmëria e natyrshme e subjektit të natyrshëm. Pra, në roman bota e brendshme e individit shprehet e njësuar me atë kolektive. Kjo mënyrë e qasjes dhe e të shprehurit ka mundësuar ndërliqësinë e shqiptimit të dukurive e të botës së vështruar; njohja e botës së brendshme të një individi nënkupton njëherit dhe njohjen e botës së brendshme të tjetrit.

Në romanin “Funerali i pafundmë” s’ka personazh kryesor në kuptimin e romanit tradicional, siç s’ka vijimësi të ngjarjes. I vdekuri i madh, i vdekuri i gjithëkundshëm, njeriu i rëndësishmi, që është në arkemort, në krye të funeralit, nuk rrëfen, nuk është i pranishëm në rrjedhën e veprimit konkret të romanit. Edhe pse autori e ka lënë në prapavijë shkaktarin kryesor të funeralit, jo vetëm i atij konkret (kur është në arkemort dhe të tjerët i shkojnë mbrapa), ai është i pranishëm me atë që ka ngjarë, me pësimet dhe tragjikat paraprake, që janë rrjedhojë e veprimeve dhe e udhëheqjes së tij.

I vdekuri i madh jo vetëm ishte nxitësi dhe përmbushësi i pësimeve dhe i vdekjeve edhe kur ishte gjallë, kur udhëhiqte funeralin e jetës së njerëzve, po ai edhe në funeralin e fundit në arkemort vazhdon të jetë shkaktar i vdekjeve të tjera.

Simbolika shumë e funeralit

Një nga veçantitë dhe qenësitë e romanit “Funerali i pafundmë” është shumësia e simbolikës që autori i ka dhënë në tekstin e përfutur. Pra, s’kemi të bëjmë me një funeral të rëndomtë, me një akt konkret që lidhet me përcjelljen e një të vdekuri, siç thuhet figurativisht, në banesën e përhershme, po për një funeral që ka ndodhur edhe më parë, ka filluar më herët, po që edhe në çastet kur i vdekuri është në arkivol, vazhdon për arsye se vazhdon pësimi dhe tragjika; është një funeral që ngjet edhe brenda rrëfimitarit, po dhe brenda atyre që marrin pjesë në funeral, të cilët shkojnë pas njeriut të madh si funeralistë.

Nisur nga rrënimin shpirtëror, moral dhe material, nga pasojat e shumta e të vijueshme, që njeriu ynë i përjetoi gjatë sistemit komunist, ku në qenësi jeta ishte shndërruar në një varr të madh të gjallë, secili në mënyrën e vet e përjetoi funeralin, për të marrë një përmasë edhe kolektive.

Me pak fjalë, funerali është një vazhdimësi, një shtrirje e pa fund; njerëzit që e bëjnë atë janë të shumtë (vargan rreshtash të çrregullt); janë të kohëve e të brezave të ndryshëm; shkohet drejt varrit pa marrë parasysh se ka vdekur dikush ose duhet të vdesë; nuk dilet dot nga radhët e funeralit edhe kur ndodhin gjëra të papritura e të rënda; është funerali më i gjatë që mund të jetë parë; degëzohet e shtrihet në të kaluarën, në të tashmen, po janë të gjitha shenjat që do të vazhdojë dhe në të ardhshmen.

Romansieri ynë e shqipton funeralin si një përshumim i ankhëm dhe i vijueshëm; është rrjedhojë e tundimit të vetëdijes për një periudhë kohe të gjatë, e vetëdijes së fjetur, e dukurisë që njëri për tjetrin bëhet ujë; është një marshin, më mirë një ortek (ose si i thonë arbëreshët e Italisë: një rrungajë), që përplasët mbi secilin dhe mbi të gjithë; ata e bartin vdekjen në shpinën e tyre dhe shkojnë drejt vdekjes, njësohen me vdekjen e njeriut të madh, që është në arkivol në krye të funeralit. Pikërisht, arka me të vdekurin në të, është arka lavdishëse dhe ajo i ka tërhequr (“*Njërin krah e ka ma të ulët nga pesha e dikurshme*”) dhe i tërheq njerëzit drejt varrezave dhe frymësisë së vdekjes. Me një fjalë, funerali me të vdekurin në arkivol e përligj majën e rrënimin shpirtëror dhe të pësimeve të ndryshme e të shumta (“*Po na shkon jeta dëm pas një arkivoli*”).

I vdekuri në arkivol është i shumëkohshëm, siç ndodh me 11 Ernesto Sabato, *Shkrimtari dhe fantazmat e tij*, vep. e përm., f. 120.

vdekjen; kur vdesin diktatorët (sipas tyre) sikur vdes i gjithë vendi, sikur vdesin të gjithë njerëzit!

Funerali, siç u tha, është nisur para se i vdekuri të vihej në arkivol; secili shtegton brenda vetes dhe drejt funeralit të vet, drejt vdekjes; vdekja është vendosur brenda secilit; në arkivol nuk ishte vetëm i vdekuri; aty brenda është edhe vetë rrëfimtari (“[...] brenda të cilit një i gjallë, i shtrirë përmbys, shkruan dhe shkruan...”) po dhe të gjithë: “*Ne, kush tjetër!*” nga se “*Gjithë jetën ecën pas tij*”. Kjo dëshmon se realiteti është shndërruar në vegim dhe vegimi në përditshmëri; njerëzit janë katandisur aq shumë brenda tyre, sa gjallimi më shumë i përngjet realitetit të ëndrës: gjërat ndodhin në bazë të parimeve krejt të tjera përballë asaj që duhet të ndodhin në jetën reale të njeriut, në veprimin e përditshëm të tij: “*Ne jemi tashmë në ëndërr*” dhe “*Pashë ëndërr sikur jemi në ëndërr*”.

Natyrisht një gjallim i tillë, jeta është shndërruar në një funeral, të cilit nuk i dihet as fillimi as mbarimi; koha ka mbetur pezull; as e shkuar, as e tashme, as e ardhshme. Në ndonjë çast njeriu vetëdijësohet dhe e pyet veten: “*Mos ecim mbrapshtë ne*” ose “*Si u bëra befas korb!*” ose “*Nëse gjysma ime është bërë kafshë, ndamëni me shpatël!*”, jo për ta shmangur pjesën kafshore të tij, po atë të njeriut: “*S’e dua më pjesën e njeriut!*”

Një jetë e tillë brenda tundimeve të ferrta që dhe është me pasojat të rënda e të pashmangshme: njerëzit jetuan dhe jetojnë në dyshime dhe nuk janë të vetvetes; kur nuk je i vetvetes nuk je as i tjetrit, as i shoqërisë: “*S’di cila është kufoma jote e cila e tjetrit?*” nga se është “*Varreza që lëviz bashkë me ne*”.

Shqiptimi poetik si ballafaqim dhe kundërvënie

Një cilësi tjetër e romanit “Funerali i pafundmë”, që i jep atij një vlerë të lartësuar dhe të përhershme është të shprehurit poetik¹², ku dukuritë dhe mendimet ballafaqohen dhe kundërvihen ose kur përftohen pamje poetike të pasura dhe të parëndomta.

Kur thellohesh në qenësitë e tekstit poetik të romanit të Visar Zhitit “Funerali i pafundmë” vëren dy çështje kryesore: ajo që thuhet në roman shprehet përmes tekstit poetik të ngritur, përmes pamjeve poetike, përmes të shprehurit figurativ, që shënjon një periudhë kohe në botën shqiptare, që më shumë përafrohej me funeralin dhe me vdekjen sesa me jetën që njeriu duhet ta jetonte.

Për të dëshmuar këtë mënyrë të shqiptimit, po sjell dy shembuj:

“ti që sheh herë pas here atë shprishje të yjeve lart, ato flakëza qirinsh të një morti të përjetshëm, ç’zbulove aty? Ç’të thonë galaktikat e largëta, planetët që enden, kometat e kobshme? Pse dridhen sikur të jenë ngrica sipërane e ndjenjave tona, mornica të bëmave që u ngjiten qiejve dhe digjen, digjen me flakëza të ftohta, që largohen vazhdimisht sikur të mos e duronin dot dëshpërimin tonë?” (f. 99)

¹² Shin për veçantitë dhe rëndësinë e tekstit poetik të veprës letrare librin *Ligjërime rreth tekstit letrar poetik* (me Labinot Berishën). “Faik Konica”, Prishtinë 2017.



“nga retë, që qenë ulur aq shumë, sikur të kishin pesha të tjera për sipër dhe nuk i mbanin dot, nisën të rrokulliseshin copëza të bardha mermeri. Mos po shembeshin lart varre perëndish? Dhe binin gurë të bluar, plumba do të qe më mirë, vritnani sa më parë, por jo, ishte borë pikëllimtare me flokë të mëdhenj” (f. 139).

Teksti me cilësi të këtilla mundëson një shqiptim më të ndërliqshëm e më të thellë të dukurive e të botës së brendshme të njeriut, po dhe të rrethanave dhe kundërthënieve shoqërore e politike, në krahasim me rrëfimin e të shprehurit e rëndomtë.

Zhiti nuk zbaton ndonjë model të caktuar të ballafaqimit dhe të kundërvënies së dukurive dhe të mendimeve; ato i shpreh ashtu si i vinë, natyrshëm, pa sforcim, sipas rastit dhe mënyrës kur ato zënë vend në tekstin e romanit. Përdoren sidomos kur autori përfton pamje tronditëse, gjendje rrëqethëse, tragjika të mëdha e të pafund, që shtrihen në kohë dhe në hapësira të ndryshme. Shprehja se funerali është pa fillim dhe pa mbarim, se është edhe nuk është në lëvizje, që mbërrin në *asgjëkund*, pra është diçka që sillet në rreth, është dëshmi e vijimësisë së pësimeve, po njëherit edhe një lloj shpëtimi: i çon drejt vdekjes dhe shpëtimin! (“*Jo të shpëtosh, por të mbarosh sa më parë!*”).

Të shprehurit mbi parimin e ballafaqimit dhe të kundërvënies në këtë roman përligjet sidomos me atë që ndodh në botën e brendshme të individit dhe të kundërthënieve që shfaqen në mendimet dhe në logjikën e tij; të merresh me botën e brendshme të njeriut, me pësimet dhe tragjikat që shprehen aty, domethënë vetvetiu të ballafaqohesh me kundërthëniet e shoqërisë, të ndriçosh një botë të ndërliqshme të dyfishtë: individuale dhe kolektive. Në sistemin e tillë individi nuk duhet të ketë e të shprehë mendimin e vet të lirë; duhet të jetë vetëm një miratues i asaj që thonë të mëdhenjtë; të flijojë çdo gjë të veten, edhe jetën, për të mirën e drejtuesve. Kjo ngjet edhe gjatë kohës së përcjelljes së funeralit me të vdekurin në arkivol; ata frymojnë brenda një marramendje të përgjithshme; peshën e arkivolit e ndiejnë më shumë ata që nuk e bartin: “*Do t’i dukej gjithçka e mugët nëse s’do t’i vinte supin e vet arkemortit*”. Gjithë kjo ndodh nga fakti se “*U përziej ferri me jetën tonë të përditshme*”. Edhe në funeralin me të vdekurin në arkivol zbatohen rregullat e sistemit; për hir të udhëheqësit, të tjerët duhet t’i bashkohet vdekjes së tij, ta bëjnë atë më të denjë, më madhështore! Pra, edhe në funeralin me arkivol në krye (“*varrim më i rëndësishëm se jeta*”), gjithçka i nënshtrohet hierarkisë dhe pësimeve; as aty nuk merren vesh dot me njëri – tjetrin; ndodh që të ndërrohen edhe kryesuesit (drejtuesit) e funeralit (“*U interesonte dëshpërimi i popullit*”), po pësimi dhe tragjika nuk ndryshojnë, vijnë në të njëjtën mënyrë. Pjesëmarrësit e funeralit bartin mbi supet e tyre vdekjen dhe mosvdekjen, *asgjënë e vdekur dhe asgjënë e gjallë*; secili bëhet një funeral; udhëtohet nëpër atë që nuk është! Kjo përligj botën e vegimit dhe të ëndrës, ku gjërat funksionojnë dhe marrin kuptime të tjera e të ndryshme. Ndonjëherë fitohet përshtypja se rrefehet nga gropa e zjarrit; janë vetëm copa mendimesh e fjali të papërfunduara, të paplota. Këtë e dëshmon dhe kreu 54, që si tekst ka vetëm klithjen *Ah!* (që të kujton romanin e Anton Pashkut “Oh”), ndërsa kapitujt më të “gjatë” janë ata pa tekst si ata numër 49 dhe 66; lexuesi i mësuar dhe i përshtatur me sistemin e të shprehurit të zbatuar në roman (duke lexuar tekstin), do ta vazhdojë në mendje këtë mënyrë shqiptimi, duke i dhënë ngjyrën dhe frymësinë e shpirtit dhe të botës së vet.

Edhe në funeral përligjet lufta e klasave, po dhe në varreza! Për t’i pikëzuar gjendjet dhe veprimet e njerëzve autori përdor shprehje tepër të veçanta: “*Hëna gropë varri në qiell!*”, “*Toka mrekullisht e mallkuar!*”, “*S’duhej të ishte një kufomë brenda arkës, por shumë!*”, “*ngrita kokën i shushatur dhe pashë të drunjëzuar qiellin e arkivoltë, të brejtur nga krimbat e yjeve!*”, “*një hum(b)nerë... jo poshtë nesh, por sipër... si prej resh!*”. Edhe vetë rrëfimtari e pyet veten: “*Po kush jam unë? Kjo gjysmë apo tjetra? Të dyja mbas asnjëra?*”. Pra, edhe realiteti, edhe përfytyrimi në tekstin e romanit shprehen përmes kontrastit: “*Ndoshta ne ishim pasqyrimi i funeralit të reve, pra gjendja irreal e një vuajtje të madhe, që s’mbaron*”.

Në fund them se rrëfimi i Visar Zhitit për funeralin e botës sonë e të njeriut tonë, brenda një sistemi politik rrënues dhe vrasës, pësimet dhe vuajtjet e shumta të njerëzve, shkaktojnë, shndërrohen në dhembje të pafund dhe vështirë që nuk duhet të mësohet nga ato. Njëmend autori nisat nga dukuritë konkrete të njeriut e të botës sonë, po ato shtrihen vetvetiu edhe te njerëzit e vendeve e të kulturave të tjera, të cilët kanë përjetuar funeralet të ngjashme me atë të njeriut tonë; konkretja vetvetiu shtrihet dhe shenjëzon të përgjithshmen; ato janë të ndërlidhura dhe kur shprehen përmes tekstit poetik, dalin më të vlefshme dhe bëhen më të qenësishme dhe si të tilla ia dalin të përmbushin më lehtë edhe atë që thotë rrëfimtari në roman: “[...] do të vijë dita e do të zgjohemi e s’do të jemi më funeral” (f. 72).

Ftohtësi ere

Dera e dimrit
mbyllet akullsisht,

dhe si trupat e
gjatë të kafshëve të zhdukura,
makinat

qëndrojnë të braktisura kudo
ku i ka çuar rruga e ftohtë.

Sa e ceremonishme është bora,
me ashpërsi të qetë

edhe vdekjen e kthen në një
marrëveshje
formale.

E vetme në dritare, mbaj vesh
erën,

gjethet e vockla që tingëlljnë
në arkëmortet e tyre prej akulli.

Ajo që dëshirojmë

Ajo që dëshirojmë
s'është kurrë e thjeshtë.

Lëvizim mes sendeve
që mendojmë se i dëshironim:
një fytyrë, një dhomë, një libër i
hapur

dhe këto sende mbajnë emrat tanë --
tani na dëshirojnë ata ne.

Por ajo që dëshirojmë na shfaqet
në ëndrra, nën petka maskimi.

Prëzohemi,
me krahët zgjatur para
dhe në mëngjes
krahët na dhembin.

Nuk e mbajmë mend ëndrrën,
por ëndrra na mban mend ne.

Është aty gjithë ditën
si një kafshë

poshtë tavolinës,
si yjet që janë aty

edhe në pikun e diellit.

Po mësoj të braktis botën

Po mësoj të braktis botën
para se të më braktisë ajo mua.

Kam hequr dorë tashmë nga hëna
e bora, nësa i ul grilat
kundruall lutjeve të së bardhës.

Dhe bota ma ka marrë
babanë, miqtë.

Kam hequr dorë nga vijat melodike
të kodrave,

kur u zhvendosa në një peizazh të
rrafshët, të pamuzikë.

Dhe çdo natë heq dorë nga trupi im
gjymtyrë pas gjymtyre, duke u
ngjitur sipër,

gjatë shtyllës kurrizore, drejt zemrës.

Por mëngjesi vjen me pushime
të vogla kafeje e cicërime zogjsh.

Një pemë jashtë dritares
që ishte thjesht hije një grimëkohë

më parë

i merr mbrapsht degët e veta
degërmi

pas degërmie gjethesh.

Pas një mungese

poezi nga

LINDA PASTAN

përktheu Elvana Zaimi

Linda Pastan, lindur në 1932, është rritur në Nju Jork, por ka jetuar më të shumtën e jetës në Potomac, Maryland, rrethinë e Washington, DC. Në vitin e fundit në Radcliffe College, Pastan fitoi çmimin e poezisë *Mademoiselle* (Sylvia Plath zuri vendin e dytë). Menjëherë pas diplomimit, ajo vendosi të heqë dorë nga poezia, që t'i përkushtohej familjes dhe mbarëvajtjes së saj. Pas dhjetë vjetësh si shtëpiake, i shoqi e nxiti t'i kthehej poezisë. Qysh në fillim të viteve '70, Pastan ka shkruar lirika të qeta që u kushtohen temave të tilla, si: martesë, prindërimi dhe pikëllimi. Ajo është e interesuar në ankthet që gjallojnë nën siprinën e jetës së përditshme. Rron akoma.

Mes shumë çmimeve që ka marrë, janë Dylan Thomas Prize, Pushcart Prize, Bess Hokin Prize për poezi, Ruth Lily Poetry Prize, në 2003. Pastan ka qenë Poete Laureate e Maryland nga viti 1991-1995 dhe ka qenë pjesë e stafit të Bread Loaf Writers' Conference për 20 vjet. Është autore e më shumë se 15 librave me poezi dhe ese, mes të cilëve: Parajsja e papërsosur (The Imperfect Paradise, 1988), finalist për Los Angeles Times Book Prize; Ungji i mbramë (The Last Uncle, 2001), Mbretëreshë e një vendi me shi (Queen of a Rainy Country, 2006), Udhëtim pa shumë bagazhe (Traveling Light, 2011), Insomnia (2015).

Dhe, ndërsa e marr trupin mbrapsht,
dielli lëshon turriçkën e vet të ngrohtë
në prehërin tim
si të dojë të ndreqë gabimet.

Autoportret

Sipas Adam Zagajevskit

Jam bijë e askujt, nënë e disave,
grua për distanca të gjata.
Në ditë vjeshte jam e lumtur
me motrat që po më vdesin - gjethet,
por në pranverë më dhemb koka
nga aromat e luleve.

Im shoq mbush dhomën me Mozart
të cilin e fik, nësa përqafoj
heshtjen si të qe një fletë e bardhë,
që po më pret veç mua ta mbush.

Ai rrëmon në tokën e nxirë
me duar të zhveshura. Ia shkund
dheun

nga palat e lëkurës, malluar
për atë lloj përsosmërie
që ndodh nëpër libra.
Shtëpia ime është parajsja ime e
vetme.

Një qen i kuq më fle te këmbët, duke
ëndërruar

flatra të çmendura zogjsh të
vrullshëm.

Ndërsa rruga shkurtohet para meje,
hedh vështrimin pas,
aty ku kthesa merr prapë

nga fëmijëria, vija e saj e bardhë
që ndan më dysh atë të vërtetën me
të përfytyruarën,

bash në atë mënyrë që shtylla
kurrizore

ndan dy pjesët e trupit, duke e lënë
barkun e butë në qendër

të pambrojtur ndaj gjithçkaje.

Sa për vendin tim, ai vazhdon të bëjë
gabime
qëllimmira, po aq sa Eva që zgjedh
sidër dhe fruta të rrëzuara,
harrimtare
për zinë e bukës që po afron.
Vë tenxheret në zjarr, varros fytyrën
në libra ose mbaj
një telefon në vesh, sikur teli i tij
të ishte kordoni kërthizor i botës,
zërat e të cilës ende më pëshpërisin,
edhe pasi i kanë braktisur trupat e
tyre.

**Duke dëgjuar dëshminë e të
kthyerve në jetë pas arrestit
kardiak**

Kthyer me zor në jetë,
dera e vdekjes u përplasat vrazhdë
në fytyrë,
çdocili përmend dritën
përtej atij pragu
dhe dikujt ia kishte ënda
pritjen.

Mendoj për Këngën e Pafajnisë
së Blejkut; për Zotin
dhe qingjat e tij në një ballinë resh;
për harpat dhe temjanin.
Ata qirinj të shuar
nga gishti i ftohtë i arsyes
tash rindizen:

ndezin
kullotat aq valëvitëse
sa këto kodra të Merilendit;
im atë që bën operim
flatrën e një engjëlli;
monedha e metaforës që rrotullohet,
dhe bie Fakt.

Por kohë më parë zgjodha
të bëj një gjumë më të qashtë: as
qingj
as tigër.

Shëtitje

Jam turist e
jetës sime,
ua ngjit vështrimin trajtave ekzotike
të luleve
si t'i ketë mbjellë
dikush tjetër;
penguar
prej dhomave në gjysmë errësirë
të fëmijëve
nga një litar i padukshëm
i kadifenjtë.
Fustanet në dollap
janë kostume
për një grua tjetër,
edhe pse fshihem
në cohërat e tyre të mëndafshita.
Burri që fle
në shtratin tim
më njeh më mirë
në errësirë.

Zogjtë

po i drejtohen jugut, shtyrë
nga një busull në gjene.
Ata nuk gënjehen
nga kjo verë e pagjasë nëntori,
edhe pse qëndrojmë në pragje
veshur me fustanë pambuku.
I shohim ndërsa

hidhen e mblidhen—
hija e flatrave
tek bie mbi zemër.
Kur shushurijnë mes
degëve të zbrazëta, pemët
duhet të mendojnë mos ndoshta
gjethet e humbura
u kthyen sërish.

Zogjtë po i drejtohen jugut,
instinkti është rrëfimi më i lashtë.
Ata fluturojnë mbi kipcat e vet,
erëtraguesit e pazëshëm,
duke na mësuar ne të gjithëve,
me bishtat e tyre,
veriun e vërtetë.

Vdekja e vetes

Si fletë të grisura
nga libri
i vjeshtës, gjethet
drithëruese bien në tokë

të kuqe e bojëdheu,
çdocila një poezi
apo tregim,
një letër e pashkruar.

Mendo për zjarret
në Aleksandrinë e lashtë,
tymin e dendur
të pergamenëve që digjen.

Hapua krahët
ngjyrave që po vdesin,
bukurive
të brishta

të nëntorit.
Thellë në zemër
të lendeve të varrosura
asgjë nuk humbet.

Vezë

Në këtë mbretëri
dielli kurrë nuk perëndon;
nën ovalen e mehur
të qiellit
nuk duket se ka hyrje
apo dalje
dhe, edhe pse këtu ka det,
nuk ka baticë.

Sepse vetë veza
është një hënë
që shkëlqen zbehtë
në galaktikën e hambarit,
e mbrojtur veç nga gjëmimi
ogurzi i lugës,
e para krisje e brishtë
e vetëtimës.

Vdekja e bletës

Biografia e bletës
po shkruhet në mjaltë
dhe po i afrohet
fundit.

Së shpejti, befasia
zukatëse e verës
do të heshtojë
një herë e mirë;

lulet, të fikura
do të flakërojnë
një herë të fundit
dhe do të shuhen.

Dhe djali që po kujdeset
për këmbën e pickuar këtij mëngjesi
do t'i kthehet dhe një herë
lotimit të tij të shkurtër

me diç të ngjashme
si keqardhje,
duke ndërmendur shijen
e qelibartë të mjaltit.

Engjëj

Të janë mërzitur engjëjt?
Myra Sklarew

Më janë mërzitur engjëjt,
se si flatrat e tyre madhështore
hapen me shushurimë siç ngrihet
perdja
në një dramë që nuk kam dëshirë ta
shoh.
Më janë mërzitur mantelët e tyre
qumështorë,
me brezat e tyre yje-pushtuar,
thonjtë e përkryer

shkëlqyes si guaska,
prej të cilave shpirtrat
e krijesave të vockla janë arratisur.

E mbani mend Luciferin, dua t'u
them,
flatrat e rrudhosura prej lakuriqi,
kur turret pingulthi prej hirësisë.
Por ata thjesht do të qeshnin
me po atë tingull të ujtë që do të
bënte një harpë
kur ujëvaret përmes vijave muzikore.
Ose do të më këndonin me
zërin e bjerrur të nënës sime,
duke shtrydhur gjithë premtimet
që i bëra, por që s'i mbajta dot.

Gjithë sa dua të them

*Një piktor mund të thotë gjithçka që
do
me frutin ose lulen ose madje dhe retë*
Édouard Manet

Kur të jap këtë tas
me mollë, mos dua të të them:
merr ca sfera të trëndafilta
dashurie, ose epshi – emblema
të gjithë atyre çasteve pas Edenit,
kur një pulqer i të ndaluarës
ishte si beharnat sipër asaj molle të
parë?
Apo thjesht dua të them: më fal,
sot isha shumë e zënë; veç fruta
kemi për ëmbëlsirë.

Dhe kur këpute
një gonxhe të vetme nga shkurrja në
vyskje
jashtë dritares sonë,
mos po thoshe se unë jam diqysh
si lule, ose e denjë për lule?
Mos po thoshe
çfarëdo gjëje që lidhet me lule?
Apo thjesht: ja trëndafil i mbramë
i nëntorit, të lutem
vëre në ujë.

Por, sa për retë,
për ata grumbuj të bardhë
epshorë që na pluskojnë mbi kokë,
ato nuk janë as gamile e as nënkresa
madje as maja të përborura
malesh gjysmë të përfytyruar.
Ato janë trajtat e qashtra të heshtjes,
veç tani për tani, po.
Retë po thonë
gjithë sa dua të them.

Vetëm sytë

I dashur bashkëndarës i bjerrun
i heshtjeve,
do të dërgoja një letër
ashtu si pema dërgon mesazhe
me gjethet,
apo qielli me pasthirrma
resh të qashtra.

Ndaj, të shkruaj
me këtë bojë
blu, ngjyrë
e damarëve dhe arterieve
të fshehta.
Këtu është mëngjes.
Dhe postieri ecën

rrugëve të pafajshme,
i rrezikshëm si Eoli
me çantën e vet të ernave,
apo Hermes, lajmësi,
hyu i gjumit dhe ëndrrave
që gjurmon shembëllimin tim
mbi këtë pullë poste.

Në ndërtesat publike
letrat peshohen
dhe ndahen si mishi;
në stacione treni
thasë të stërmëdhenj poste
fshihen si plaçkë grabitjeje
pas dyerve të vagonëve të mallrave.

Dhe në një tjetër qytet
magjistari
mban një erashkë letrash

drejt dorës tënde zgjatur para—
“Merr një letër çfarëdo...”
Duhet ta grisësh zarfin
siç do të shqyeje bukën.

Vetëm atëherë lumenjtë e terrtë
të bojës do të shkrijnë
e rrjedhin
nën gjithë urat
që nuk ia dolëm
të ndërtonim
mes nesh.

Pas një mungese

Pas një mungese ku s'që fajtor askush
jemi të turpshëm me njëri-tjetrin,
dhe fjalët tona na duken më të reja se
ne vetë,
si të na duhej t'i ktheheshim kohës
kur u njohëm
dhe të vinim me mund sërish te e
tashmja,
ngjashëm kur s'e lexon kurrë një
histori
nga rreshti ku e ke ndalur,
por gjithëherë ia nis çdo libri për së
pari.

Ndoshta ishte dashur të rrinim
të lidhur si alpinistët,
me teyzën e sigurt të telefonit,
me numeratorin e tij si cilindër të
vogël lutjesh,
zërat tanë më pak shajni përtej
kilometrave,
më pak të sikletshëm nga sa janë
tani.

T'i kisha harruar thinjat në
kaçurrela,
atë suvalë dimri në fytyrë,
nësa mbaja mend burrin më të ri
që kishe pasë qenë.

Dhe e ndjej veten të plakur e të
rëndomtë,
kur më duhet të mendoj sërish
ushqimin për drekë,
kafshët për t'u kujdesur, gjithë
dromcat
e përditshmërisë, të fshehura por të
rrezikshme,
që na zhysin poshtë të dyve kaq
shpejt.
E kisha ëndërruar shtratin tonë
si një bregdet ku do të laheshim të dy,
jo si ky dyshek me vija
që duhet ta mbulojmë me çarçafë. I
kisha harruar
krejt çështjet e vjetra mes nesh,
si letrat aq gjatë pa përgjigje, sa
heshtja
bëhet gojëbilbil, lajm më vete.
Kisha harruar madje që dashuria në
martesë
është një tokë përherë më e
mistershme
sa më shumë ta zbulosh, si një nga
ato tokat
për të cilat lexon, një kopsht në
shkretëtirë
ku përkulesh për të pirë, pa e ditur
asnjëherë
nëse goja do të të mbushet me ujë
apo me rërë.



Qe pasdarke vonë kur u dëgjuan trokitje në portë.

Ajo bëri të ngrihej, të shkonte dhe ta hapte, por ai nuk e la.

- Mos e hap, Nina! - i tha.

- Kush duhet të jetë?

- Kushdo qoftë, mos e hap, - ngulmoi ai.

Qe shtrirë në shpinë sipër krevatit që ndodhej pranë dritares; kurse ajo qe ulur ndenjor pranë tij.

Një ditë të tërbuar me vetëtima e bubullima ai kish humbur të gjitha gjërat e dukshme në dritë të diellit - njerëzit, objektet, ngjyrat, - gjithçka. Asgjë prej gjëje nuk mund të shihte. Po kur pllakoste errësira, mund të dallonte edhe fijen e flokut të saj, edhe rrënqethjen e gjetheve prej erës në degën e qershisë që prekte pezulin e dritares, edhe yllin më të largët në kupë të qiellit.

Në krye të herës, pas asaj ndodhie, ai vuri re se si dalëngadalë gjërat nisën të merrnin kuptime të ndryshme. Qe mu si t'i lexonte në faqe librash. Po ishin libra pa autorë ata, pa kohë, pa tituj, pa fletë - qenë vetëm shkronja që atij i përvijoheshin para syve, vështrimi i të cilëve buronte nga thellësia e qenies. Ai i tha vetes se, gjithçka u shfaqta në dritë të diellit marrka kuptim të gënjeshtërt. Dhe se format, trajtat dhe ngjyrat nuk qenkan tjetër veçse rrengje që na punon natyra për të fshehur brendinë e gjërave.

Trokitjet u dëgjuan për herë të dytë, tashmë më të forta, a thua se njeriu që ndodhej prapa derës e që nuk dihej kush ishte, e kishte me ngut.

Pasoi një heshtje bajagi e gjatë. Tek e mbramja, atyre u kapi veshi një baptime që dëgjohej gjithnjë e më pak, hapa që largoheshin.

- Iku! - tha ajo.

Ai nuk u përgjigj në çast. Por pastaj çeli gojë e tha:

- Mund të jetë një rreng i tij për të na krijuar përshtypjen se u largua. Është larguar me zhurmë dhe është kthyer sërish duke ecur në majë të gishtave. Ndoshta përgjon prapa derës!

- Jo, ka ikur, - tha plot siguri ajo. Dhe ndjeu një si peng ta gërryente nga brenda pse nuk vajti të paktën deri tek dera që të shikonte nga vrima e çelësit, sa për të shuar kureshtjen.

- Ditën unë fle, - tha ai, - Ngase nuk shoh, nuk mund të bëj asgjë. Ndoshta prandaj vijmë dhe më trokasim në derë natën.

- Përse vijmë?! - pyeti ajo.

Ai nuk foli. E la në shmang pyetjen e saj, si të mos qe e nevojshme t'i përgjigjej ato çaste.

- Je më e bukur në errësirë, - i tha teksa e vështronte përmallshëm. Dhe iu lut të mos vinte aty ditën, por të vinte vetëm natën, kur të binte terri.

- Nuk ka gjë edhe nëse vij nganjëherë ditën, - ia ktheu ajo, - Edhe pse nuk më sheh, ti më prek... Dhe sapo më prek, më merr me vete. Kështu më ke thënë.

- Po, ta kam thënë, - pranoi ai, - Por më parë më duhet të të shoh. Prandaj hajde gjithmonë kur katundin ta ketë mbuluar terri. Ti e di që unë vetëm në errësirë të shoh. Aty ku ka dritë ti njësosh me të dhe zhbëhesh. Në terr ti llamburin. Llamburin me gjithçka, por më shumë me buzëqeshjen.

Ajo e dinte këtë. E kish mësuar qysh në herë të parë, kur e pati pështetur kokën në gjoksin e tij dhe i dëgjoj rrahjet e zemrës; rrahjet që i vinin në vesh të deshifruara, - një gjuhë dashurie që s'kishte si të ishte e kësaj bote. "Zemra e njeriut që di të dashurojë mund të ndalojë së rrahuri, - i pati thënë asokohe ai, - Po rrahjet e saj janë si fjalët që thuhet. Ato nuk harrohen kurrë. Vazhdojnë të sillen qiellit në eter dhe të dëgjoen në jetë të jetëve, mjafton të dish të mbash vesh".

Ia vendosi dorën në faqen e parruar dhe

TROKITJET

tregim nga Ramiz Gjini

u përpoq t'i gjente me mollëzat e gishtave vragën e plagës së mbyllur, të plagës që i pat hapur rrufeja.

- Edhe unë jam një e verbër, Progan, - tha pas pak ajo, - Një e verbër në errësirë. Kurse ti je i verbër në dritë. A nuk jemi njësoj?!

- Ndoshta, - ia pat mendueshëm ai.

- Ti je i fortë, Progan! i fortë si një lis. Nuk thyesh kollaj. Po ajo ditë ka qenë gazep, ta dish! Edhe dhe u shkumbua nga flaka e vetëtimave!

- Aq shumë vetëtima shkrepëtinë, sa edhe ajri digjej aty ku binin, kthehej në tym e përhapej gjithkrah një erë shkumbi! - tha ai teksa kollitej mendueshëm, - Ndiqnin qiellit njëra-tjetrën lakadredhas si gjarpërinj të zjarrtë dhe bënin që t'i dilte tymi gjithçkaje. Edhe gjësimet patën qenë një llahtar më vete! Athua se Zoti e kish mbërthyer rruzullin me duar dhe kish nisur ta tundte e shkundte egërsisht për ta thyer njëqind copash. Të kujtohet, Nina?

- Po, - tha ajo, - Më kujtohet.

- Gjithçka e humbi kuptimin. Mbeti vetëm një sens i rëndomtë kotësie...

- Me sa mbaj mend unë, atë natë qenë njëzetë e nëntë të vdekur nga rrufetë, - tha ajo.

- Unë pata frikë për ty, Nina. Dola në ballkon e të thirra që të vije. Të thirra, edhe pse nuk e dija ku ishte; edhe pse qeshë i bindur që në gjithë atë kiamet, nuk mund të më dëgjoje. Po ti erdhe në çast; erdhe si një nuse e ditës së parë.

- Si një nuse?! - pyeti e mikluar ajo teksa buzëqeshte e ngrinte vetullat.

- Po, - tha ai, - Erdhe bashkë me vetëtimën! Me atë vetëtimë që zoti e kish taksur për mua e që ma ktheu natën në ditë. Kurse ditën ma bëri natë.

Ajo u përku mbi të dhe e puthi lehtë në ballë.

Një feks rrezesh hëne të vverosur përshkoi dritaren dhe u avit pahetueshëm aty brenda. Atëherë ajo mundi të shquante vragën e plagës së mbyllur që pati hapur rrufeja përgjatë faqes së tij.

- Zoti di çfarë bën, Progan, - mermëriti ajo pasi kishte nxjerrë një ofshamë të thellë, - Le të shpresojmë që me këtë vragë që të la, të ka shenjuar për mirë.

Dhoma tashmë qe ndriçuar disi për gruan; por ai pa se si një pluhurizë e hirtë nisi të derdhej gjithkrah. Miset e fytyrës së saj dalëngadalë u zbehën dhe u përnjësuan me atë dritëz të pakët hëne mistike. Dhe në atë gjysmerrësirë, ajo u bë disi e tejdukshme.

Atëherë sytë e tij u hapën. Sy të mëdhenj, të habitur, të trishtë e të frikësuar njëherësh, sepse Nina kish filluar të zhbëhej.

- Çfarë ndodhi? - pyeti.

- Hëna, - tha ajo me një zë që i rezonoi thellë kraharorit, - Sapo doli nga prapa reve të zeza.

- Tani e kuptova, - tha ai, - Prandaj nuk po të shoh mirë!

- Të shoh unë, - ia pat ajo teksa i merrte dorën. Dorën e tij të madhe e të rëndë, - Ti do më shohësh mirë sapo hëna të fshihet sërish prapa reve.

Ato çaste u dëgjuan apet trokitje në portë! Kësaj here trokitjet qenë të lehta, të ndrojtura, si prej gishtash delikatë, por që Ninës iu bë se mbartnin në vetvete diçka të ngucakeqshme. Fill pas trokitjeve pasoi një heshtje e rëndë si plumbi.

- Huuu...!Huuu...! - çau errësirën klithma e një hutini.

Të dy palët, brenda dhe jashtë, mbanin vesh.

Ata që gjendeshin jashtë nisën të flisnin.

- Edhe pse nuk ka numër të vendosur në portë, duhet të jetë katërqind e njëzet e pesa, - tha zëri i parë.

- Po! - u dëgjua të thoshte zëri i dytë, - Sipas radhës, kështu i bie.

- Trokit edhe një herë ti, shef...

Sërish trokitje...! Kësaj here ndryshe; të guximshme, të forta e plot vendosmëri.

Heshtje.

- Çfarë duan?! - pyeti pas pak ajo me pëshpërimë, - Kush janë dhe prej nga vijnë?!

Ai u mendua një çast, pastaj tha:

- Lëri të trokasim deri sa të lodhen.

- Përse na kërkoni, xhanëm?!

Në vend që të fliste, ai ngriti supet dhe buzëqeshi. Zgjati dorën dhe i preku me gisht majën e hundës. Bëri siç bën rëndom një i rritur me një vajzë piciruke, të vogël, marroke e naive.

Gjithçka ra për pak kohë në fashë. Pastaj u dëgjua zhurma e mbytur e hapave që largoheshin; njëherë përmes rruginës së ngushtë të shtruar me zhavorr; pastaj në rrugën e kalldrëmtë që zbriste drejt lagjes së Bosinëve.

Huuu...!Huuu...! çante errësirën klithma e hutinit.

Ajo fërgëlloi dhe u ngjesh pas tij.

Ai e mbështolli përfllaktas me krahe rreth vetes. Pastaj ia mori kokën me pëllëmbët e duarve dhe nisi ta puthte ngadalë, si të druhej se mos e lëndonte dhe i shkërmoqej në duar.

- Ti më jep jetë, Nina, - i tha, - Më jep jetë, në mos qofsh jeta vetë.

- Më duhet të iki, - tha disi me ndrojtje ajo.

- Prit edhe pak, - iu lut ai, - Sa të jenë larguar mjaftueshëm ata. Nuk dua të të shohin.

Hëna tashmë qe fshehur sërish prapa reve. Errësira në dhomë u bë më e dendur.

Ajo u shtri pranë tij me kokën e pështetur në kraharor dhe nisi t'i dëgjonte rrahjet e zemrës.

- Zemra jote troket në zemrën time, - i tha, - I njoh këto rrahje! Janë si fjalët e ngrohta që më thua, si premtimet, si përqafimet e puthjet. Ato nuk harrohen kurrë. Do vazhdoj t'i dëgjoj në jetë të jetëve. Vetë ma ke thënë këtë.

Ai qeshi, sepse u kujtua që vërtet ia kish thënë ato fjalë. Ia kish thënë vite të shkuara, atë natën e parë të dashurisë. Atë natë të paharrueshme.

Qëndruan kësaj për një kohë bukur të gjatë të përqafuar; të ndërallur shpirt e korp brenda njëri-tjetrit. Dëgjohej vetëm një frymëmarrje, - një e vetme për të dy. Dhe vetëm një rrahje zemre, - zemra e tyre.

Tashmë ajo kish harruar se i duhej të ngrihej e të dilte. Dhe kushedi sa do të kishin qëndruar kësaj sikur të mos qenë dëgjuar apet lehjet e qenit në oborrin e shtëpisë kundruall. Lehje të rralla, monotone, jo dhe aq të sigurta.

Ata panë njëri-tjetrin dhe mbajtën vesh.

U dëgjuan zëra njerëzish. Po nuk mund të kuptohej sa ishin. Të sapoardhurit trokitën në portë dhe pritën. Trokitje të tjera u dëgjuan, tashmë më të forta. Atëherë të lehurat e kafshës erdhën e u bënë nervoze, alarmante. Pastaj u dëgjua të hapej me kërkëllimë porta e shtëpisë kundruall dhe një burrë shpalli me zë të lartë:

- Nuk ka njeri aty, jo! Ajo shtëpi është ngallmuar e braktisur prej kohësh.

- Ashtu?! Atëherë po e fshijmë nga lista...

Dhe sërish hapa që largoheshin e dëgjoeshin gjithnjë e më pak, njëherë përmes rruginës së ngushtë të shtruar me zhavorr; pastaj në rrugën e kalldrëmtë që zbriste drejt lagjes së Bosinëve.

Huuu...!Huuu...! çante errësirën klithma e hutinit.

New York, nëntor 2019



- Avioni juaj ka ikur, – tha nëpunësja.
- Kur niset tjetri?
- Nesër në drekë
- A mund të dal jashtë aeroportit?
- Jo zonjë. Mund të rrini vetëm në një nga dhomat brenda aeroportit.
Me pasaportën tuaj nuk mund të dilni pa vizë.

- A mund të bëni një përjashtim? – ajo vuri përsëri duart mbi barkun e rumbullakosur duke u munduar të ndejë ndonjë lëvizje.

- Jo zonjë.
- Po kam leje qëndrimi dhe emigrimi në Kanada, - ajo i zgjati punonjëses së aeroportit një tufë letrash po tjetra u hodhi një vështrim mospërfillës

- Zonjë, sapo ju thashë. Me pasaportën tuaj nuk ju lejohet të dilni jashtëaerportit.

- Jam shtatzënë, – tha ajo me zë të ulët megjithëse kjo ishte fare e dukshme - Jam vërtet e lodhur. Dua vetëm të shkoj të fle në hotel. Tek Hilton matanë rrugës. Fjeta atje në vajtje. E kam vizën transit në pasaportë. Po të kisha dashur të qëndroja, - ajo zgjati pasaportën e saj shqiptare plot vula.

- Zonjë. Ju lutem u lironi radhën njerëzve pas jush. Ju e dinit që ishit shtatzënë kur u nisët. Uluni dhe prisni derisa të lirohet një dhomë brenda aeroportit.

Ajo bëri të shtojë diçka, po anglishtja e la papritur në baltë. Në gojë i erdhi një shkumë e hidhur fjalësh po qenë të gjitha shqip. U tërhoq mënjanë ngadalë nën vështrimet e bezdisura të njerëzve që prisnin në radhë dhe u ul në një stol aty afër. Tërhoqi valixhen e dorës pranë vetes, e ktheu horizontalisht dhe mbështeti këmbët. U ndje pak si më rehat. Vuri prapë duart mbi bark dhe mbajti frymën. Ndjeu një lëvizje të befte dhe u qetësua. Me fal Bebush tha me vete. Nuk duhet ta kisha marrë këtë rrugë. Mama jote duhet ta kishte ditur që pasaporta e saj është një libërth me ngjyrën e gabuar që nuk i kalon dot kufijtë. Ta dinte që këtu, ajo është një me ngjyrën e libërthit, që për të, këta shirita janë mure të verdhë dhe këtu ajo nuk është një qenie, më fal, Bebush, dy qenie. Këtu ne të dy jemi veç një ngjyrë, një e kuqe që ngre mure të verdhë përballë vetes.

Nuk e kishte pasur kurrë të fortë dëshirën për të ikur si shumë nga moshatarët e saj. Gjithnjë i ishte dukur se nëse do ta niste atë rrugë, do të ngecej si baresha e porcelanit majë oxhakut dhe bota do t'i dukej e huaj.

Kishin vendosur ta provonin megjithatë. Në vajtje kishin marrë një vizë tranzit dhe kishin qëndruar një natë në Vienë. Kishin fjetur pikërisht në atë hotelin ku tani nuk po e linin të shkonte, pastaj kishin marrë trenin dhe kishin zbritur në qendër.

Kishin shëtitur dorë për dorë në Stephansplatz mes turistëve, rrotull Kishës që dukej si një kështjellë rëre, më pas kishin darkuar në një nga restorantet e këndshme në një rrugicë aty pranë.

Ishte fillim nëntori po i ftohti akoma nuk ndjehej dhe ajo ishte ndjerë e qetë dhe e lumtur, duke e harruar më në fund ankthin që sa s'po e mbyste kur u nisën.

Foshnja lëvizi përsëri në bark dhe ajo u ngrit në këmbë. Mbështeti të dy duart mbi gjysmë sferën e fortë brenda së cilës ndodhet tani gjithë bota e saj. Mori një bluzë nga valixhja e dorës, e palosi e vuri mbi njërin nga karriget, u shtri në një anë dhe, duke u kujdesur ta mbështeste barkun me kujdes, u mbulua me xhakëtën e saj.

Kështu mbase do jesh çik më rehat, Bebush, mendoi.

Kishte qenë e lodhur kur kishin zbritur në aeroportin e Torontos. Salla i ishte dukur e huaj dhe e zhveshur.

Kishte menduar gjithsesi se ajo ndjenjë zymtësie që e kishte kapluar papritur duke prit radhën e gjatë në zyrën e emigracionit, ishte pasojë e lodhjes.

Por në apartamentin e vogël që vinte akoma erë bojë të pa tharë, ishte ndjerë

MURE TË VERDHA

tregim nga Ajkuna Dakli

njëlloj. Një zymtësi dhe mos përkitje që i fuste dridhmat.

Pse dreqin nuk e kanë lyer në ndonjë ngjyrë tjetër më të gëzueshme, kishte menduar sapo kishte hapur sytë të nesërmen duke parë muret e lyera në gri. Nuk paska në këtë vend një ngjyrë limoni a pjepr të çelur, diçka më të gëzueshme që ta thyente sadopak zymtësinë gri që derdhte qielli i nëntorit nga dritarja?

Ajo hapi sytë. Duhet ta kishte kapitur gjumi ndonjë gjysmë ore. U përpoq të rrotullohej në karrige po vendi ishte shumë i ngushtë. U ngrit prapë ndenjtur dhe u mbështet mbi shpinore. Gjithë natën në avion nuk kishte mbyllur sy, ca nga lodhja dhe ca nga mendimi që e gjithë kjo arratisje e saj mbrapsht ishte vetëm një budallallëk, një impuls hormonal i momentit. Ja ku je tashti i tha vetes. Zënë rob mes muresh të verdha. Ushtar betejëhumbur që valëvit me dëshpërim flamurin e gabuar. Duhet ta kishte djegur anijen e kthimit ushtar. Duhet të shtrëngoje dhëmbët, të...

Më fal, Bebush, tha me pëshpërimë.

U ngrit, tërhoqi valixhen e dorës, dhe duke parë se në radhë nuk ishte askush, iu afrua me ndrojtje sportelit të informacionit.

- Kanë kaluar 4 orë, - tha. - A mund të shikoni nëse është liruar ndonjë dhomë?

- Jo zonjë, - gruaja përballë iu përgjigj me të njëjtin ton. - Ju thashë që duhet të prisni deri në 6 pasdite

- Janë edhe 6 orë të tjera, – zëri i doli si pëshpërimë.

- *Yes please*, – iu drejtua tjetra dikujt pas saj.

Ajo tërhoqi valixhen e dorës dhe nisi të ecte. U hodhi një sy dyqaneve duke u munduar të rrinte larg parfumeve. Hyri diku

dhe filloi tu hidhte një sy librave pastaj u kthye në një kënd me lodra fëmijësh. Duro edhe pak Bebush, pëshpëriti duke vënë dorën mbi bark. Gjashtë orë nuk janë edhe aq shumë.

Ditët a para në Toronto kishin kaluar në radhë nëpër zyra dhe orë në autobusë në rrugë që dukej se zgjatëshin pa fund. I dukej se ishte gjithnjë në një kufi midis gjumit dhe zgjimit pa qenë asnjëherë e sigurt se nga anonte më shumë.

Më duket se zonja po fle në këmbë, kishte qeshur njëra nga nëpunëset duke i zgjatur një nga formularët e panumërt që iu duhet të mbushnin dhe ajo kishte buzëqeshur.

Nëpër zyra atmosfera ishte e ngrohtë, po sapo dilte jashtë e pllakoste e njëjta zymtësi e padepërueshme. Nëntorit po i vinte fundi. Ishte ftohtë dhe rrugët kishin filluar të ngrinin.

- Unë dua të kthehem, - kishte thënë ajo papritur ndërsa ecnin në rrugë duke u mbajtur pas krahut të tij nga frika se mos rrëshqiste.

Kishin ndaluar papritur.

- Është vetëm fillimi, – kishte thënë ai. – Këtu nuk duket keq. Ka rregull dhe gjërat duken në vendin e vet.

- Më duket sikur jam në fund të botës. Ky i ftohtë sikur më merr frymën.

Ai kishte heshtur një hop.

- Erdhëm deri këtu. Unë them rrimë të paktën derisa... Megjithatë, – kishte shtuar - Nëse ti ndihesh kaq keq nuk ka kuptim.

- Po sikur të kthehem unë, – kishte thënë ajo me një çlirim të papritur a thua se e kishte gjetur daljen nga ai labirint. - Një shkëputje. Nja dy muaj. Derisa ti të gjesh diçka të mirë dhe ky i ftohtë mbase do ketë kaluar, dhe mbase, mbase....

- Është gjithë ajo rrugë...

Është gjithë ajo rrugë vërtet. Gjithë ajo rrugë me pasaportën e gabuar, mendoi ajo duke u përpjekur të lëvizte mbi karrige. Vertebrat i dhembnin, mesi dukej sikur po i këputej më dysh dhe shpatullat i ndjente si të vrara.

Nga brenda trupit ndjeu një goditje të vogël dhe i hodhi një sy orës. Ishte afër gjashtës. U çua dhe iu afrua sportelit të informacionit.

Për fat ajo figura e gjatë bionde me sy kafe e pamje të rreptë që larguar.

- *Yes please?*

- Po pres për një dhomë lart, – tha ajo. – Më thanë në 6 pasdite.

Tjetra i hodhi një sy ekranit

- Akoma nuk është liruar, – tha. – Edhe ndonjë orë.

- Më thanë në gjashtë, – u përgjigj ajo. – U bënë 10 orë që pres.

- Më vjen keq – tha nëpunësja – e marr me mend që....

- *Do you really?!*

- Do t'ju njoftoj, – u përgjigj nëpunësja-sapo të lirohet.

Ishte 7 e gjysmë pasdite kur, me një kartë në dorë ajo u ngjit më në fund në katin e tretë të aeroportit, përshkoi korridorin e gjatë ku gumëzhinin zëra fëmijësh të udhëtarëve nga vende si vendi i saj, dhe hyri në dhomën e vogël.

Bëri një dush të shpëlante lodhjen dhe u shtri në shtrat, po tani gjithë qelizat e muskujve i ndjente të ngurtësuar.

Iu deshën orë të flinte. Bebushi nuk po lëvizte më. U lodhe dhe ti zemra ime, tha me vete dhe me këtë mendim, e zuri gjumi.

Dera duhet të kishte trokitur disa herë, kur hapi sytë dhe u çua dhe e hapi. Përballë u shfaq figura e rreptë e një punonjëseje të aeroportit në hijen e së cilës shquhej gruaja e shërbimit.

- Zonjë, - tha punonjësjë. – Duhet të lironi dhomën. - Ishte vetëm për 12 orë.

- Shët! – ajo vuri gishtin mbi buzë dhe mbështeti duart mbi bark

- Zonjë!

- Shët! Shët! - zëri i tingëlloi me zemërim si urdhër.

Dy gratë heshtën. Ajo priti disa sekonda dhe pastaj ndjeu nën duar një regëtim të brishtë. Mori frymë thellë.

- Më jepni pesë minuta kohë, – tha.

Dy gratë u zmbarsën dhe tërhoqën derën.

- Paske bërë rrugë të gjatë. Duhet të jesh e lodhur - tha gruaja në ndenjësën ngjitur pasi e pyeti nga vinte.

Ajo buzëqeshi

- E ke ndjerë bebin? – pyeti prapë gruaja.

- Po, - buzëqeshi ajo.

- Djalë a vajzë?

- Nuk e di, – tha ajo

- Po shkon në Shqipëri për vizitë apo po kthehesh?

- Për një vizitë të shkurtër.

Ajo iu afrua dritares vezake dhe vështrroi jashtë. Adriatiku shtrihej aty poshtë i qetë dhe mikpritës. Vështrroi më tutje në horizont, aty ku Adriatiku kthehej në Jon, aty ku bluja thellohej, në atë shirit ujor pothuaj të padukshëm që ngjante aq i qetë dhe i kthjellët.

Dukej pothuaj e pamundur që pikërisht aty, natën, barkat klandestine që çonin emigrantë në Itali përballeshin me dëshpërim me dallgët.

Nën duart e mbështetura mbi bark foshnja befaz lëvizi. Si ta kishte ndjerë sakaq trandjen e tyre diku thellë në detin e saj të vogël amniotik.

Nga kjo ngjarje qyteti ynë të pakën mësoi shumë për të verbërit, sidomos për ata që ecin pas shkopit të tyre të hollë dhe të gjatë e që kurrë nuk iu kërkojnë ndihmë kalimtarëve të rastit. Të verbërit e rinj, të paktën deri tani, edhe pse nuk mbyllen më në shtëpi, kur dalin, nuk janë kërcënim, por kërkojnë dritare të vogla, që të lidhin atë pak dritë të brendshme me dritën e madhe të jashtme.



Poezi me engjëjt në kuti

“Ti je plot ëndrra”, më tha sikur të isha plot me zgjebe.
 “jam,” iu përgjigja, “prandaj notoj ashtu, si një lopë e fryrë si ato nga reklama”.
 “dhe paradokse perfekte”
 “dhe plot zbrazëti,” shtoi unë duke buzëqeshur,
 kisha të drejtë, megjithëse asaj nuk i pëlqente fare: “Epo...”
 Kështu fillonte gjithmonë shërrin ynë
 një lloj lufte njëqindvjeçare,
 më qortonte se i vendos fjalët aty ku nuk i prisje
 dhe kërkoi me javë derisa të më thotë diçka,
 se shpesh largohem pa prituri
 duke lënë një karton nga një kuti këpucësh të mbështetur
 në dritare mes barbarozave rozë
 duke përshkruar një figurë të pasigurt ku lexohej “Unë”
 se e ledhatoj macen, Montaigne, më shpesh sesa atë,
 acarohet shumë kur gjen të fiksuar me magnet në formë
 mollëkuqe në derën e frigoriferit
 një shënim letre të verdhë të shkruar artistikisht: “Jam me
 Servantes për një pije,”
 “një ditë do ta nxjerr këtë frigorifer të mallkuar në rrugë
 në të cilin i mban të vdekurit e tu nga ato romane që nuk i
 bën më”
 meqë ra fjala, unë jam autori më pjellor i librave të pash-
 kuar
 dhe ajo ka një mijë arsye të tjera pse më qorton
 se jam më shumë një vonesë se çdo gjë tjetër
 “po të kërkoj marrëzisht nëpër pyjet e tua me pemë të infek-
 tuar me parazitë nga likenet gënjeshtarë
 sikur kërkoj tartufin, nga qentë e gjakut tim vetëm lëkurat
 kanë mbetur.”
 “mendoj se duhen regjur”, bëj shaka.
 “kur ndodh që të jesh në shtëpi dhe kjo ndodh shumë rrallë
 e tëra çfarë bën është të shikosh me orë të tëra atë engjëll të
 mallkuar nga kutia”
 (një lloj insektari, por me engjëj)
 “ripagëzon dhe rishpik gjithçka vetëm për të më bërë inat
 të rrëfeve se jam e lumtur kur,
 aq rrallë
 dëshiron të shtypësh pasiguritë e mia,
 dhe ti më the se lumturia është vetëm iluzioni i përm-
 bushjes
 dhe se e vetmja përmushjeje e rëndësishme është vdekja
 të gjitha shoqet e mia kanë një të dashur,
 vetëm unë jam e dashuruar me një mori mendimesh me
 emra rrugësh.”
 Nuk gabonte shumë, kam aq shumë të meta sa ndonjëherë
 dukem si një botë e tërë...

Doja të isha dimër

Ai do të jetë poeti i vetë oborrit të tij
 parashikonte profeti nga barku i peshkut të ngopur
 një i vogël, i ushqyer me kokrra të mbetura nga joshja e
 fundit
 para përmbytjes
 dhe kështu ka qenë
 fillova të shkruaj himne lavdërimi për veten time
 lëshonin një aromë të bukur që të bënte të mendoje se
 kishin lulëzuar fjalët e mia
 dhe se jeta lind nga një tufë fluturash lozonjare
 (por nëse kanë krahë dylli, po ankothesha)
 pastaj zbriste ngrica, e butë si një figurinë plumbi

isha i pushtuar nga dëbora e të gjitha epokave
 dhe kisha aq ftohtë sa mungonin vetëm ujërit për të qenë
 një dimër i përshtatshëm

sepse nuk doja të më merrnin si një copë mish dreri të
 ngrirë
 kam shpikur dashurinë
 kam gjetur edhe dhëmbë, mendova me vete atëherë
 dhe pjesa tjetër do të vinte natyrshëm
 më duhej të zgjidhja një të dashur nga një varg i gjatë
 femrash që do të grumbulloheshin
 gjoja,
 në portat e palyera të vetes

lehtë të imagjinohet:
 me sytë në pëllëmbë duke prituri si një lypësë shkëlqimin e
 fjalëve të mia të mallit
 dhe duke mbajtur një engjëll lakuriq në vend të një karfice
 zbukurimi
 më fal që deri dje isha dashnori i vetmisë, i kërkova
 dhe ti se i kam velat e grisura, i dashuri im
 ajo mendonte se kisha një oqean dhe vërtet kisha

MIHAIL SOARE

DASHURIA SI NJË TEL ME GJEMBA

Mihail Soare është një autor rumun me mbi 17 libra me prozë dhe poezi, për të cilët kanë shkruar kritikët më të rëndësishëm rumunë. Është një poet bashkëkohor që ka qarkulluar shumë zëra të ndryshëm, që adopton qarkulluar shumë formula në kompozimin e poezive të tij, që lëviz me të njëjtën lehtësi mbi ritmet klasike dhe post-moderne pa asnjë hezitim. Mihail Soare ka edhe poezi meditative në të cilën të jep përshtypjen se po përpriqet të sqarojë një problem ekzistencial ose nëse jo, sepse mund të mos jetë detyra e poetëve të sqarojnë diçka, të paktën ta përshkruajë, ta vënë seriozisht përpara mendjeve tona. Bëhet fjalë kryesisht për çështje fati, domethënë “kush jam unë”, marrëdhëniet mes meje dhe të tjerëve.



por nuk ishte i tërë vetëm me një breg
 atë përtej
 ku njerëzit e tjerë rriteshin pa turp si pisha

ajo ishte e vetmja grua, përndryshe nuk do të rrëshqiste
 lakuriq nëpër ujërat e mia të ftohta
 edhe unë duhej të dashurohesha me dikë
 ngushëllova veten

me një fjale, një lloj rulete ruse
 të dua si plumbi i fundit, i rrëfeve atëherë

për shkak të saj, kisha humbur fatin për t'u bërë dimër dhe
 ujërit kishin mbetur pa dhëmbë
 dhe kujtimet nuk më përgjonin më nëpër qoshe

Dashuria si një tel me gjemba

Të dua - kjo shprehje e thënë nga të gjithë nga mëngjesi
 deri në darkë
 nuk më thotë asgjë - tingëllon si një fuçi e prishur, bosh
 prej mijëra vjetësh njerëzit i thonë këto fjalë budallaqe
 me buzë të ngjeshura si një bori bronzi e rëndomtë
 siç thonë mirëmëngjesi dhe mirëmbërë dhe mirupaf-
 shim
 për të mos u tallur dhe për të qenë njësoj si të gjithë, e
 kisha shkruar edhe unë në një karton
 një kapak i një kutie këpucësh për të vdekurit
 sapo u shfaqeshin të dashurat e mia në dritare
 ato të pamishëruara si xhinde që mundojnë ëndrrat të
 cilat s'bëjnë dy para
 u tregoj kartonin
 dhe u bëja shenjë se nuk mund të dilja duke u treguar
 njollat e vogla të bëra me laps të kuq

i shkreti, ky ka skarlatinë, mendonin ato dhe iknin të kërrusura nga inati duke mërmëritur çuditërisht: sëmundje e mallkuar, kush ta dashurojë këtë nga mbrapa grilave të verdha si hëna po qeshja me djallëzi por me të dashurën e fundit nuk më doli, mori formën e një flete letre në të cilën ishte shkruar një kondak kishtar dhe hyri nën derë ma rrëmbeu lapsin e kuq nga dora dhe bëri dhe ajo njolla të kuqe si skarlatina tha diçka për kundërshtimin për gjakun tim të butë në venat e saj për pakuptimin e botës tjetër që u bë befasi e padukshme në sytë e saj të qelqtë rreth nuk e di se çfarë mrekullie nuk kam idenë se nga erdhi, ndaj mos më pyesni edhe më tha se i kishte lënë gjellët në zjarr drejt t'i marrë, patëllxhanë do të gjej unë në jetën tjetër, por një laps të kuq si ky askund ngatërrohem në këmbët e saj kur shkoj tek frigoriferi dhe dukem si një gaforre e lezetshme dashuria e saj m'u ngjit këmbësi si tela me gjemba dhe kush e ka pësuar me ndonjë tel me gjemba e di se nuk mund të shpëtosh është një lloj dashurie absolute dhe këtu nuk e thua më atë të dua të ngushtë që ngjan me mirëmbërë dhe mirëmëngjesi dhe mirupafshim nuk thua asgjë thjesht mban në krah ato pika të bëra nga lapsi i kuq dhe mrekullohesh sikur të jetë skarlatinë e vërtetë

Poemë për një dashuri si nuk është parë më

U kisha kushtuar poema të gjitha grave të botës por ato vraponin të trembura kur u thosha që duke u dashuruar me mua do të bëhemi një qenie me katër sy vetëm njëra s'donte të dinte për këtë pamje të çuditshme ajo kishte humbur të gjitha trenat në botë drejt t'ju marrin me makinat tuaj të zhurmshme stacionet e trenit ku arrinte nuk i shkonin, këmbët e saj gjithnjë dilnin jashtë kështu kam ngecur mbi to (unë nuk e di se ku po shkoja, siç nuk e kam ditur kurrë, duke menduar se njerëzit mund të nxitojnë vetëm në dyqanin e qivureve ca budallenj, është i hapur gjithmonë) dhe e mbusha platformën me të gjitha fjalët që kisha aq sa ajo teta që fshinte aty bëri kryq udhëtarët e tjerë të gjithë u larguan të frikësuar për në stacionet e tjera ajo qeshi dhe më tha se që e vogël kishte vizatuar një të dashur që më ngjante mua me duart aq të gjata sa mund ta përqafoje nga kudo dhe nga bregun e kundërt të një oqeani për të më dërguar letra në shishe nuk kishte asnjë kuptim shikova duart e mia - ajo kishte të drejtë, ishin disa vjet më prapa derisa të arrinin tek ajo do të kalonin ca net të Vitit të Ri dhe do të ishte tashmë e plakur pastaj më tha se ishte bërë prej kohe dhe jo prej mishi që tkurret me kalimin e kohës unë kurrë nuk kisha ledhatuar gjinj të bërë prej kohe dhe isha kurioz për të ndjerë butësinë prej anijeve ajrore që gjithashtu mund të kishin një nacelë si një shportë peshkimi, si një rrjetë me erë thellësie e shihja veten e ngjitur atje lart në atë shportë, duke vëstruar përreth saj nga ku bota do ishte parë vetëm ashtu siç është me horizontin e shtrembër si një rreth fuçie të pa fiksuar mire dhe me burra e gra të vegjël që nuk kishin as çmendurinë time, as gjinjtë e saj vetëm pak dëshira me shijen e hirit të ferrës së sapo shuar pas një dashurie si nuk është parë më

Gabimet e mia

Gabimet e mia janë të shumta, disa quhen pasiguri, të tjerët komplete, grumbuj dhimbjesh kanë lanë, pak të gjakosura, të durueshme si i ftohti i humbur në mars, por, i ngarkuar kështu, apo i gatuar, nëse dëshiron,

nuk mund t'ia fal vetes naivitetin për të menduar se më takon vjeshta, njësoj siç më takon vuajtja.

Qeverisja e shpirtit tim

Dielli kishte harruar të lindte prej disa muajsh (ishte dhe nëntori mes tyre, prandaj thashë muajsh) kështu që kolltuku ngjyrë mustardë i ujitur nga lotët e lumturisë së fundit që erdhi papritur (ti hape çadrën duke menduar se po binte shi) ende nuk ishte tharë gjithsesi, lotët e lumturisë thahen, mësova nga shenjtorët, me vështirësi era e mykut ishte përhapur mbi të gjithë jetën aq sa kishte mbetur, jo kush e di çfarë gështenjat përgjatë rrugicës kishin baltë mbi lëvore, por edhe mbi gjethet si pëllëmbë me gishta të shpërndara, akacia gjithashtu, postieri me trastë lëkure prej nuk e di çfarë fantazmë, gazetatat dhe letrat që e mbushnin atë dhe të gjitha historitë në to, gjithashtu bashkë me kalldrëmin e rrugëve, arsye për të cilën te gjithë ishin të lodhur sikur kërkonin një gjë të vogël askush nuk mund të qëndronte në këmbë të gjitha këto duke u bërë gjëra pa kuptim fakt për të cilin marangozi (çfarë këmbësh që premtinin qiejt bënte i çmenduri!) vrau veten, si ndryshe varur nga një thupër e bardhë si një agim dhe qyteti u harrua në një cep melankolie, ende të lagësht dhe që atëherë e ndje gjithmonë erën e keqe të arkivit dimri erdhi menjëherë me heshtjen e tij kumbuese dhe pemët u thyen nga zhurma disa dashuri ishin internuar në qeverisjen e shpirtit tim një tufë me madhësi të mesme, të sjellë nga një tren nate ngrica zotëronte gjithandej dhe gjithçka ishte ngjirë

I huaj

Mund të thuhet që jam një i huaj për veten time sepse mishrat që më zbukurojnë janë shumë të panjohura për mua si t'i dija mishra si të gjithë mishrat si ato nga kasapi, si ato të fqinjës nga kati i tretë mishra si ato të mbretit, si ato të armëtarit, si ato të nallbanit, si ato të pianistit është e vërtetë që i kam parë shpesh kur i laja kur i lyeja me pomada të bëra nga barëra të panjohura kur i braktisja në ledhatimet e një gruaje që nuk kishte mace se nuk ke asgjë për të përkëdhelur, i thoja, duke i lënë në kujdesin e saj



Përktheu Oana Glasu

dhe pastaj nxitaja në tavernë me tufën e kockave që kërcësinin të mbetura pa zot atje, të tjerë si unë pa e ditur nëse mishi i tyre ishte lënë për t'u përkëdhelur dhe me kocka që kërcësinin njësoj jam vërtet një i huaj për veten time sepse të gjitha ëndrrat me të cilat zura miqësi për aq dimra më shikojnë shtrembër tani duke mos më njohur kështu që përqafoj foshnjën e fundit që do të isha sikur të mos isha më dhe tregoj histori të vjetra por zëri im tingëllon si një gramafon me një pipëz të thyer dhe ajrin në të cilin janë shpërndarë tingujt duke pasur pamjen e ndarjeve të të dashuruarve të mallkuar është i rëndë nga kaq flutura të vrara padrejtësisht aty-këtu rruaza drite prishin rendin e kësaj ngrice ndoshta i huaji që është i huaj për mua është gjithashtu i huaj për të tjerët është fazani i vrarë e plumb nga natyra statike të një burri flamand me emër lumi është konserva e zbrazët e rrokullisur nga era është gjithmonë vdekja e dikujt tjetër për të cilin po flasim gazetatat është kofsha e harruar e të dashurës së parë është treni i natës që bredh pagjumësitë e mia është pema e shtrirë për tokë nga stuhia

Poemë për fundin e botës

Të gjithë më njihnin shumë mirë dhe jo nga veshët prej llamarine të kullës së kambanores ishin si hinka dhe nganjëherë zgjohesha me gjithë qiellin në kokë dhe e gjithë toka mbetej në errësirë njerëzit ishin të hutuar si të verbër, qentë po ashtu, macet e zeza, derrat, të gjitha insektet kuptohet që lotët e mi ishin shi një lloj foleje për shpendët e ujit me gjuhë bronzi që bënin një ndalesë aq sa të dëgjohej zilja e këmborës më vizitonin shpesh gjatë rrugës së tyre për në askund edhe as nga sytë si llamba rruge të vjetra nuk me njihnin (disa mendonin se një fanar si ky do të ishte im atë) ndoshta unë po dridhesha si ata në djegien time dhe mëngjeset më vëzhgonin me dhembë të dalë nga mbrapa mureve të heshtjes për të gëlltitur nostalgjitë e mia thithur njëkohësisht me qumështin dhe as nga rënie të rënda dhe të shpeshta të ushtruara vazhdimisht të gjitha çatitë duke pasur një vrimë në formën e trupit tim përndryshe do të kishe thënë: shiko atë çfarë veshë ka, sa qesharak ose çfarë sysh mos është meteorit, gur, dhe jo njeri, na ka prishur tullat por ata më njohën nga fatkeqësia e fundit nga lartësia e së cilës shikoja shtrembër shpirtrat krejt të rinj të njerëzve borxhli kësaj heshtjeje e mbaja me krenari të bie në sy si një dekoratë lufte siç kishte dhe gjyshi edhe pse gjyshja dyshonte se mund ta kishte fituar në poker dhe jo me bajonetë përndryshe çdo njeri normal e mban të fshehur pakënaqësinë e tij si një mëz i pjell me të meta, mbrapa buzëqeshjes sarkastike të jetës e cila është një sënduk për hipokrizitë e konsideruara të detyrueshme ku bën pjesë përkëdhelja e trupave të ngrëna nga drita madje edhe dashuria ishte pakënaqësia e të kuptuarit se vdekja është hakmarrja e kujtimeve mishi i tyre rritet fuqishëm si një brumë e çmendur dhe mban erë temjani mua personalisht më ndodh ashtu çdo mëngjes dhe asnjë rrënim nuk më njeh më i dashuruar me sirenën e anijes së fundit mësova gjuhën e saj vetëm për të tjetërsuar largimin e doganierit të fundit të mbetur rojë në portën e parajsës vetëm atëherë më rrethon një luzmë famulltarësh me gjinjtë në erë kanë thitha të lagura për të ditur se nga vjen stuhia kush s'do të donte foto me fundin e botës thonë ato kur janë marrë në pyetje

KUR ORA RA NJËMBËDHJETË E NATËS, Kdikush erdhi dhe i ra ziles në dhomën e mjekut. Zilja e parë nuk pati asnjë rezultat, por kur e dyta dhe e treta ranë më me vendosshmëri, Karina, ndihmësja e mjekut, doli nga dera e kuzhinës për të parë se çfarë po ndodhte. Karina u hamendua një për pak kohë, por pastaj e bindi veten se duhet zgjuar mjekun. Erdhi dhe trokiti në derën e dhomës së tij të gjumit.

- Ke një mesazh nga e fejuara. Mjeku duhet të shkojë atje.

- Është e sëmurë? - u dëgjua zëri i tij nga brenda.

- Ato nuk e dinë se çfarë ka. Mendojnë se ka parë diçka.

- Po, thuaju që po vij.

Mjeku nuk pyeti më. Nuk i pëlqente të dëgjonte thashetheme të kota për të fejuarën. Gjë e çuditshme me këto bestytini, mendonte ai ndërsa po vishej. Shtëpia shtrihet në mes të qytetit dhe kjo s'ishte ndonjë gjë idilike. Një shtëpi e vjetër, krejtësisht e zakonshme, pothuajse e shëmtuar, me orendi si gjithë shtëpitë tjera në atë lagje. Por fantazma rrinte andej. Aty ishte vetëm një rrugicë e errët në të dalë të qytetit, me një kopsht të stërmadh dhe me pemët e tmerrshme e të vjetra që fshikullonin dritaret në një natë kaq të stuhishme dimri! Rruga ishte e gjërë dhe zbriste deri në portin detar, me kishën dhe bankën e kursimeve, kazermën dhe fabrikën e sheqerit aty pranë! A s' ishte afër mendësh se fabrika e sheqerit me gjithë ato zhurma dhe kaldaja të mëdha e të ndezura, do ta kishin bërë fantazmën të mos ndjehej rehat aty, të pakënaqur. Por jo - aspak. Në mënyrën e vet, fantazma mund të meritonte admirim. Kishte energji në të, energji të jashtëzakonshme dhe aftësinë për të qëndruar në vetëdijen e njerëzve. Thuhej se nuk ishte shfaqur tani në njëzet vjet, qëkur plakati Burmanë ishin vendosur me banim në atë dhomë e fantazmës. Por a e kishin harruar njerëzit? Dukej tani: vetëm për faktin se Ellena ishte sëmurë papritmas, kjo menjëherë ishte cilësuar si një përfytyrim i saj. E frikësuar nga diçka, po, nuk ishte e pamundur. Me siguri ajo ishte bërë si e predistenuar për të parë fantazmën duke qenë se kishte jetuar tërë jetën me dy plaka nervoze. Ajo e kishte ditur gjithmonë dhe kishte besuar se në atë shtëpi kishte një fantazmë.

Dukej sikur e kishte ushqyer imagjinatën e saj me këtë që nga fëmijëria. Ajo me siguri nuk e kishte harruar, ndonëse ishte e rritur. Herën e parë që mjeku kishte në vizitë tek plakati e sëmura, ajo i kishte thënë me një zë triumfues:

- Këtu është dhoma e fantazmës.

Pikërisht me këtë ton, sikur të tregonte për një thesar familjar.

- Kurrë nuk mund të luash me letra në këtë dhomë, e sheh doktor.

- Oh, pse jo?

- Po ja, nëse njëri nga bixhozhinjtë bënë gabimin më të vogël, hilen më të vogël, befasi i shfaqet një dorë dhe lëshohet në tryezë pranë tij.

- Çfarë dore?

- Një dorë e moshuar, e verdhë, me unaza diamanti të rëndë në gishtat, e shtrembër dhe me gjemba të vërtetë rreth kyçit të dorës

- Ashtu ë, dhe pastaj?

- Nuk mund të shohësh asgjë më shumë se dora.

- Por si shfaqet fillimisht?

- Askush nuk e di, është shfaqur gjithmonë këtu.

Ajo e kishte treguar këtë me shumë zgjuars, por si mund ta dinte, si e dinte? Ajo me siguri besonte në fantazmat.

- Kështu vjen, doktor, shfaqet fshehurazi te cepi i tryezës, pranë atij që luan letra. Hu, dhe drejton gishtin e madh e të shtrembër kah një kartë bixhozi! Ka thonjtë si kthetra, të dredhur dhe të mprehtë.

Megjithkëtë ajo nuk mund ta besonte këtë. Sapo e kishte zgjedhur dhomën e fantazmës për dhomën e saj. Mjeku kalonte andej përgjatë ndërtesës së madhe të fabrikës së sheqerit, ku punohej gjatë gjithë natës. Një ditë banorët aty do të kishin qenë të kënaqur me fabrikën e madhe që lëshonte tym! Ishte e arsyeshme të mendohej se nëse ajo do të ishte rritur në fshat në vetmi ëndërrimtare, atëherë ndoshta, bestytinia do ishte rrënjësor thellë në shpirtin e saj. Por meqë ajo kishte jetuar gjithmonë këtu mu në mes të këtij realiteti, të zhurmshtëm ...

Ai u kthye aty te qoshi i fabrikës së sheqerit, ku era fërshëllente, po aq reale si zakonisht, u ngjiti shkallëve të larta prej guri dhe hyri në shtëpi.

Zoti i madh, edhe ai kishte filluar të frikësohej.

SELMA LAGERLÖF

DORA FANTAZMË

Përktheu nga suedishtja Qerim Raqi

Në korridor qëndronte një figurë e gjatë, mbështjellur plotësisht me një shall të zi. Vetë plaka Malina kishte zbritur poshtë për të mbajtur fenerin ndezur tek shkallët.

- Si është Ellena? pyeti doktori.

"Faleminderit juve që erdhët kaq shpejt", tha plaka Malina. Nuk e di as vetë se çfarë ka. Ju duhet të vini dhe ta shihni vetë.

Ajo pothuajse vrapoi shkallëve lartë, ndonëse ishte aq e moshuar. Imagjino, plaka Malina ishte ulur në të ftohtë në korridor për ta pritur. Kishte qenë shumë e shqetësuar, natyrisht, ndoshta kishte menduar se ai do të vinte më shpejt nëse do të dilte aty e ta takonte. Mjeku fillimisht pati një përshtypje të gjallë se aty vërtetë mund të kishte një rrezik. Do të ishte shqetësuese nëse diçka do ta pengonte atë vajzë të re atje lart, të cilën ai e kishte zgjedhur për grua. Ai s' kishte takuar asnjë vajzë më të mirë gjatë gjithë jetës së tij. Relativisht e bukur dhe pa të afërm të tjerë, përveç këtyre dy grave të moshuara, dhe natyrisht me një edukatë të mirë, shtëpiake, e urtë.

Kur hynë në sallë, plaka Malina iu drejtua përsëri mjekut.

- Ne u zgjuam në mes të natës nga britma e saj e tmerrshme, dhe nuk kemi mundur ta qetësojmë më. Ne nuk dinim si të vepronim ndryshe, prandaj të kërkuam. Ajo hapi derën e dhomës së Ellenës, futi kokën dhe i tha se mjeku kishte mbërritur. Menjëherë, ai hyri brenda. Kishte aq shumë ndriçim aty brenda saqë, në fillim, ai pothuaj nuk mund të shihte asgjë. Ato me siguri kishin mbledhur të gjitha llojet e llambave dhe qirinje që ishin në atë shtëpi.

Në fakt, nuk dukej keq me ato pasqyrat e larta, të montuara në mur midis dritareve dhe me mobiljet e bardha, të stilit të vjetër që Ellena kishte renditur. Në këtë ndriçim bëhej e qartë se kjo sallë, në kohërat e mëhershme, kishte qenë vendi i festave, gjatë ditëve të lavdisë së asaj shtëpie. Pra ishte këtu vendi ku banorët e dikurshëm ishin ulur pranë tryezave duke lozur - një vend me shkëlqim të madh, sepse njerëz të shkëlqyeshëm kishin jetuar këtu - dhe kur gëzimi kishte arritur kulmin, kur oborrtarë të rinj kishin qëndruar pas karrigeve të grave, kishin folur marrëzira, kur shërbëtorët kishin kaluar dhe ofruar qumësht bajameje me tabakatë prej argjendi, pikërisht atëherë ishte shfaqur dora fantazmë. Duhet të ketë pasur spektakle dhe rrëmujë aty. Zonjat duhet të kenë bërë titur, kapele të vjetra dhe dinjitoze të burrave duhet të jenë hedhur nga tavolinat dhe ata të mos kenë thënë asnjë fjalë. Tabakatë e argjendta duhet t' u kenë rrëshqitur nga duart shërbëtorëve dhe t' u kenë rënë në dysheme. Frika nga e mbinatyrshmja do të jetë vizatuar nëpër fytyrat e të pranishmëve. Do të jenë dukur si demonizuese, gjysmë të çmendura. Mjaftonte të shikonte tani të fejuarën e tij për ta kuptuar se si do të jenë dukur ato fytyra.

Ajo ishte ulur tani në mes të dhomës, në një kolltuk të madh, me trupin krejt të drejt, duke shikuar përreth me sy të çuditshëm, endacakë, e zbehtë në fytyrë, si të kishte marrë ngjyrën e një të vdekuri, duke kërcëllitur dhëmbët e duke u dridhur e tëra. Kolltuku ishte zhvendosur në mes të dyshemesë. Ishte një kolltuk me këmbë të lira. Asnjë mobilje tjetër nuk qëndronte pranë,

asgjë nuk mund të fshihej nën të që të mund të zvarritej përpara.

Ajo nuk i kushtoi shumë vëmendje atyre që hynë brenda. Tani i mbante sytë të fiksuar, shikimin e ngulitur në një pikë, mbi hijen e dollapit që shtrihet në cep të sobës me pllaka. Ajo ndoshta dyshonte në hijen që mbase dëshironte të bënte një tallje të shëmtuar. E tërhoqi fundin e fustanit, për të qenë gati të ikte kur hija të rritej dhe të shfaqej diçka, ndoshta një dorë e madhe me gishtat si kthetra. Befas, doktori lëvizti me nxitim një llambë në mënyrë që drita të binte tutje. Ajo u ul përsëri në karrige. Tani erdhi hallë Berta dhe bëri të njëjtin raport si hallë Malina.

- Ne u zgjuam nga britma e saj sikur të ishte çmendur, dhe në këtë gjendje është që nga ai çast. Ajo thjesht dëshiron dritë, gjithnjë e më shumë dritë. - Çfarë ka, sipas jush? "E frikësuar, asgjë tjetër përveç frikësimit," pëshpëriti doktori. Tani shikimi i saj ngulitej pas një perdeje rrotulluese. Ai bëri ca hapa nëpër dhomë. A është e mundur që ai të kishte zbuluar atë që e kishte frikësuar të fejuarën e tij. Në tavolinë ishte një letër dhe pak bojë. Ajo kishte filluar të shkruante diçka, por pena i kishte rënë nga dora duke u rrotulluar mbi letër. Një biletë, të cilën mjeku ia kishte dërguar asaj vonë në mbremje për të mësuar nëse ajo bashkë me dy hallat donin të shkonin në një ekskursion të nesërmen, qëndronte aty fare pranë. Ishte e qartë se ajo ishte ulur pranë tavolinës për t'ia kthyer letrën atij. Ajo kishte arritur të shkruante vetëm "I dash...". Pastaj ishte frikësuar dhe pena i kishte rënë nga dora.

Mjeku ndjeu se si e ndoqin sytë e dy plakave. Ato me siguri pyesnin veten pse ai akoma s' i kishte thënë asgjë Ellenës. Sigurisht, nuk e kuptonin që gjëja më e rëndësishme ishte se ai kishte kuptuar se çfarë e kishte shkaktuar frikën e saj. Ai nuk mund ta besonte dorën fantazmë, kjo nuk vinte në shprehje.

E gjora vajzë, ashtu siç ishte e frikësuar vetë, ashtu kishte qenë edhe gjithë atmosfera përreth saj, plot tmerr. Askush, thellë në mendjen e tyre, nuk ishte bindur se ajo nuk kishte parë diçka. Gjëja e parë që duhej bërë ishte, në fakt, që t'i nxirrte ato nga dhoma, si Malinën ashtu edhe Bertën, në mënyrë që mos t'ia mbanin të gjallë frikën asaj.

- Unë mendoj se ajo do të flasë për gjithçka me mua, nëse mund të flas vetëm me të, tha ai dhe shpejt e liroi dhomën. Mori një karrige dhe u ul pranë saj. E çuditshme se sa fytyra mund të ketë një person! Vëshitirë se mund ta njihje Ellenën në atë gjendje. Ajo përherë ishte e qetë, me një qetësi shpirtërore, dhe kjo ishte cilësia kryesore e saj. Ai ishte magjepsur gjithmonë nga qetësia e saj, ajo vërtetë zotëronte mjeshtërinë për t' u ulur gjakrat e atyre dy grave të moshuara.

Ajo pothuaj nuk kishte ngritur kokën nga qëndisja, pavarësisht sesa ishin grindur ato. Një mbrëmje kur ishte kthyer në shtëpi, ai kishte përjetuar një lloj epifanie, sikur kishte gjetur aty një siluetë të bukur, nën dritën e llambës, përkulur mbi tryezën e punës. Ai e kishte parë qartë qafën e hollë dhe duart e vogla të një femre. Që ishin zmadhuar, sa gjithë dhoma. Menjëherë pas këtij përfytyrimi ai i kishte propozuar fejesën.

Po tani. Thjeshtë, një genie tmerrësisht e zbehtë dhe e vrazhdë. Krejtësisht ndryshe nga ajo që ai donte. Një grua hysterike! Oh, Zot i madh, na ruaj Zot! Sidoqoftë, tani ai duhej të bënte diçka për të. Nuk i interesonte që ajo ishte bërë pothuajse e neveritshme për të. Më duhet ta shoh si një paciente dhe jo si gruan time të ardhshme. - Më thuaj, Ellenë, çfarë ke? Ajo nuk u përgjigj. "Duhet të ma thuash, e kupton," tha ai me një zë pak më të rreptë. Ajo e vëshitroi, një shkëlqim shprese u shfaq në sytë e saj. - Do të qetësohesh, kur ta thuash. Sytë e saj të bukur dhe të ndritshëm ishin të trishtuar. Ata gjithmonë kishin pushuar tek ai që e vështronin, si rreze dielli. Tani mbase ishin më shkëlqyesh. Por me një shkëlqim pas të cilit ai, në të vërtetë, nuk ishte i dhënë. Ajo luftonte ashpër me veten e saj. Nuk mund ta mbante nollën e poshtme të palëvizshme. Futi një shami mes dhëmbëve që të mos dëgjohej kërcëllima e tyre. Më në fund i tha ca fjalë. U ul, vuri një dorë mbi tjetërën dhe mendoj me zë të lartë. - Më duhet t' i them. Duhet, duhet. Përndryshe hija do të shfaqet përsëri. Po, po, do të vie përsëri.

Pastaj filloi të flasë. Kishte rënë në një trishtim të çuditshëm. I ngjante në të shumtën atij që del nga një procesion, të

veshur me një frak dhe të lagur nga shiu. Kur ndjen njeriu sikur po humb gjithë madhësinë dhe dinjitetin. Madje ajo ia tha menjëherë se nuk e donte. Kishte dashur të martohej me të, por vetëm e vetëm për t'u larguar nga shtëpia. Sikur



të mos ishte me veten e tij, ai tani do të qeshte me mënyrën se si kjo vajzë, që nga fëmijëria, e kishte menduar si duhej të ishte një burrë. I pari, më i miri. Ajo kishte qenë shumë e vendosur për t' u larguar. Për shkak të hallave. Ato kishin qenë shumë dashamirëse me të, por kurrë aq të vetëdijshme sa shumë e kishin munduar. Ajo i hodhi mjekut një shikim të rreptë dhe sikur po i lutej ta kuptonte, të ndjente diçka për të. Ai e dinte si ishin hallat, ai, i cili ishte kujdesur për to për shumë vite. Ato ishin aq të vështira, tepër të vështira, me plot ide fikse dhe fobira të ndryshme. Halla Malinë gjithmonë kishte një frikë se mos po e përfshinte ndonjë valë zjarri, kurse halla Berta gjithmonë kishte idenë se do të rrëzohej në rrugë. Ai e dinte se si ishin ato. Nëse ajo, Ellena, do të kishte qëndruar me to, do të ishte bërë po aq e çuditshme. Ajo e kishte ditur këtë. Por kishte dashur të ishte vërtetë njerëzore me to. U kishte kërkuar leje për të gjetur dikund një punë. Ato, sigurisht, nuk e kishin lejuar. Atëherë ai e kishte kuptuar se asaj nuk i kishte mbetur gjë tjetër veçse të martohej. Mjeku nuk ishte duruar pa e pyetur nëse ajo frikohej se jeta e saj si e martuar do të mund të bëhej më e keqe, më e vështirë se me ato dy hallat.

Oh jo, më keq nuk mund të bëhej kurrë. Të paktën burri mund të dilte dikund ndonjëherë, ai. Ndërkaq hallat ishin gjithë ditën në shtëpi. Pra, ajo kishte qenë e sinqertë. - Asnjëherë nuk të ka shkuar ndër mend të më doje? - Ajo tundi kokën, ishte diçka që nuk e kishte shoshitur. - Po pse? Ishte shumë i shëmtuar? - Jo, ajo hapi sytë me adhurim. - Ishte i mërzhitshëm? Ajo bëri një lëvizje të çuditshme me dorë. - Çfarë të keqe kishte atëherë? - Ai ishte shumë i ftohtë. - Ashtu, ë, ai ishte shumë i ftohtë. Mjeku bëri ca hapa nëpër dhomë. Ishte, pa dyshim, e tmerrshme, që në fëmijëri ajo kishte ngulitur në mendje diçka të tillë. Ishte puthur me të, pa pasur asnjë fije pëlqimi për të. Dhe nuk e kishte luajtur aspak rolin e saj keq. Me siguri ai ndjehej i mashtruar. Ishte një ndjenjë e pakëndshme që një vajzë e re as që e kishte menduar ta donte. Por, natyrisht, ajo kishte bërë një jetë të mjerueshme me ato dy plakat. Mund ta merrte me mend sa e rëndësishme kishte qenë për të martesën. Sa vetë jeta e saj. Ajo rrëfeu pa treguar asnjë lloj dhembshurie. Asnjëherë nuk i shkonte në mendje se po e lëndonte atë. Ajo duhet ta ketë menduar atë si njeri zemërgurë, vërtet të fortë hekur. Zëri i saj papritmas u bë ulërimë. "E di," tha ajo, "se kushdo që luan me hile në këtë dhomë mund ta shohë dorën fantazmë." Unë e pashë. Isha ulur atje. Ajo u kthye shpejt kah tavolina. - Aty e pashë - Nuk beson se e pashë? vazhdoi ajo dhe ia nguli sytë atij, sikur donte ta detyronte të vërtetën të dilte jashtë. "Po të dëgjoj, pra, si ishte," tha ai. - Po, ti e di që më ke shkruar sonete, dhe unë doja të shkruaja një përgjigje para se të shkoja në shtrat. Por kur u ula në tavolinë, u shqetësova, qëndrova për një kohë duke menduar, sepse nuk dija si të shkruaja titullin. Duhet të shkruaja i dashur, por mendova se kjo nuk ishte e drejtë. Ishte hera e parë që ju shkruaja. Mendova se ishte e tmerrshme të shkruaja atë që nuk ishte e vërtetë, që nuk qëndronte - por në fund mendova se nuk ishte e thënë të të shkruaja më pak. - A ka ndonjë ndryshim kaq të madh midis asaj që shkruan dhe asaj që thua? - Ti nuk më kishe pyetur kurrë nëse të doja, vetëm nëse doja të isha gruaja jote -

- Ah, ashtu, ë! - Por pastaj, në atë çast, mu kur kisha filluar të shkruaja atë fjalë, aty ishte shfaqur dora. Erdhi duke rrëshqitur nga këndi i tryezës, unë qëndrova ulur dhe e vështrova për disa sekonda, para se të kuptoja se çfarë ishte. Nuk bërtita menjëherë. S' mund ta kuptoja që ishte diçka e mbinatyrshme. Por pastaj ajo u shtri në letër dhe bëri me gishtin e shtrembër në drejtim të asaj fjale. Unë mendoj se ishte e lumtur, dridhej nga gëzimi. Sikur donte të gërvishte shkronjat. - Ishte një lojë e rreme, donte të ishte pjesë e saj. Erdhi duke u zvarritur në gishtat e verdhë si një merimangë e madhe. Ashtu me nxitim. Kishte shumë kohë që s' kishte pasur arsye për t' u shfaqur. Tani vërtetë donte të nxitonte. E kapi penën me gishtat e njomë dhe të gërryer. Unë bërtita si të ishte një gjarpër, dhe pastaj ajo zhduk, por nuk e di nëse akoma është këtu. Sikur e ndje se është akoma në këtë dhomë. Dhe nëse vjen përsëri, unë do të vdes. Po, do të vdes. "Jo, nuk do të vijë përsëri," tha ai me një zë ngushëllues. "Unë e di se më duhet të bëjë diçka," tha ajo. Më duhet ta bëjë, në mënyrë që ajo mos të shfaqet më. Por është jashtëzakonisht e vështirë. Ajo hoqi unazën e fejesës nga gishtin, e futi dorën e ftohtë tek mjeku dhe ia lëshoi unazën në dorë. Pastaj sytë iu mbushën me lot nga pikëllimi që kishte hequr nga gishtin unazën.

Mjeku nuk tha asgjë, me majat e gishtërinjve tërhoqi unazën mes gishtërinjve të saj. Mendoj se dora fantazmë nuk ishte aq e vështirë sa kjo tjetra, e saja. Dora, si të thuash, kishte marrë anën e tij, i kishte dhënë një hakmarrje të vogël. Ai ndjeu simpati për të. Me siguri disave u ndodh, mendoi ai, që ndërgjegjja t' u shkoj zvarrë në një mënyrë ose në një tjetër, pavarësisht se sa shumë përpiqen ta mashtrjnë. Ajo ka shtigjet e veta të heshtura. Aty tani e fejuara e tij e vogël kishte planifikuar gjithçka për vete, për të marrë një shtëpi të mirë. I nevojitej vetëm një hipokrizi e vogël, dhe lumturia e të gjithë botës ishte e saj. Por ngjan që ndërgjegjja krejt në heshtje të gërmojë në minierën e saj të thellë shpirtërore dhe më në fund të rrënojë për një çast çdo llogari dhe planifikim të bërë. Posi! Ajo ndoshta kishte menduar se mund të gënjente për këtë pjesën e mbetur të jetës së saj. Kishte parë se si funksiononte për të tjerët. Por ja që u zbulua se ajo ishte nga një soj më i mirë, që kishte diç frenuese për të qenë e një race të rafinuar të kundërshtuesve të ndërgjegjes. Kur më së paku e presin, u shfaqet halucinacioni i ndërgjegjes. Gjithsesi, atëherë merr formën më të afërt që ka në dispozicion. Ishte e qartë se ndërgjegjja do të shfaqej si një dorë fantazme në këtë dhomë. Ai ende qëndronte dhe lëvizte me unazën nga gishtin në gisht. Ndjente vetëm pakënaqësi që nuk mund ta fitonte atë vajzë. Ishte pothuajse i trishtuar. Ajo me siguri kishte filluar që t' ia bënte tani me dije atij, të mendonte se ajo ia kishte bërë atij një padrejtësi, sepse u përkuul dhe i puthi dorën.

"Më fal", i tha. Ishte e çuditshme, sa e butë ishte. Kur e kuptoi se kishte bërë gabim, ajo nuk e dinte se çfarë të bënte për t' u pajtuar. - Atëherë nuk kishte asnjë arsye për ta torturuar më. Ai thjeshtë duhej të fliste, të thoshte se as ai nuk ishte shumë më i mirë se ajo. Si një lloj arsytimi nga të dy palët. Njëri kishte kërkuar një shtëpi, tjetri një shtëpiake. Do të qetësohej po ta dëgjonte këtë. Ai do t'i thoshte asaj se nuk mund të bëhej një përllogaritje të tillë të hidhur e të gabuar për të. As ai nuk kishte qenë aq tmerrsisht i dashuruar në të. Po, natyrisht, ai nuk kishte arsye ta ushqente më dhimbjen. Më së miri ishte që t' i jepte fund lidhjes. Për të mirën e të gjithëve, që të qetësoheshin dhe të zgjoheshin të nesërmen si të pamartuar. Ndërsa u ngrit të largohej, sytë iu mbushën lot. Ndjente akoma dhembje për ta humbur. Këtë kishte ardhur për t' ia thënë. Ai filloi duke i thënë ca gjëra jokohërente, se ajo ishte një njeri me ndërgjegje, se i përkiste racës më të mirë të njerëzve nervozë, të cilët sapo kishin filluar të shfaqeshin aty-këtu. Ajo ishte e çmuar për të mu për këtë arsye. Vetëm për shkak të asaj që i kishte ndodhur mbrëmë ai e kishte të vështirë ta linte. Ajo ishte e lirë, po në rast se..., nëse ndonjëherë ajo donte... E shikoi me habi. E mundonte kjo atë? Jo, por tani ngurtësia u largua nga tiparet e saj dhe sytë iu qetësuan. Qëndronte me gojën gjysmë të hapur për të dëgjuar më shumë. Ai foli për mënyrën se si ai kishte dashur ta organizonte jetën me të, edhe për mallin që kishte pasur për të. Foli krejt ndryshe në krahasim me atë që kishte folur gjysmë ore më parë. Mirëpo tani e shihnte atë krejtësisht ndryshe, tani kur po e humbiste. Foli shumë më bukur, përtej zotësive të tij. Bashkëjetesa me një femër të butë dhe të dashur, po, vetëm jeta me të, iu duk në të njëjtën kohë, shumë e ëmbël, në përfytyrimin e tij, dhe këtë ai tha asaj. Në çastin kur deshi të largohej duke ia zgjatur dorën në shenjë lamtumire, sytë iu mbushën përsëri me lot. Ato çaste ajo dukej shumë e bukur, përsëri i ndriste fytyra, ishte bërë si një lule e sapoçelur. Ajo dukej aq e lumtur si t' i kishte shpëtuar një kërcënimi me vdekje. Mjeku akoma ia mbante dorën dhe nxori përfundimet e tij më shpejt se kurrë më parë. Natyrisht, ajo nuk e kuptonte as vetën e saj, as për së afërmi. Por, ah, në atë çast! Mori frymë thellë. I gjithë trishtimi ishte zhdukur. E përshkoi një ndjenjë triumfi e gëzmimi. Vetëm me një përpjekje të vogël ai ia kishte rrëfyer asaj dashurinë. Ajo kishte nevojë vetëm për këtë, që ai t' i tregonte se e donte. Ai mori unazën e fejesës dhe ia vuri asaj në gisht. - Asnjë marrëzi tani, tha ai, kur ajo deshi ta tërhoqte dorën. "Por," tha ajo. - Nuk e di, nuk guxoj -- guxoj, unë, tha doktori. Unë kurrë nuk kam dashur të ikën nga lumturia. Doli në korridor, kërkoi diçka nëpër xhepat e palltos dhe u kthye përsëri për të ndezur cigaren. "E gjora," tha ai, duke thithur cigaren. - tani je e lidhur dhe e prangosur për të më dashur, do të thoj. Përndryshe, ajo dorë fantazmë mbase do të të shfaqet përsëri dhe do të të mbërthejë gjithë jetën.

ARRATIA E NJË SHPIRTI ENDACAK

Nga Xheni Shehaj

Agu i mëngjesit më gjeti në morgun e qytetit. Gjeti trupin tim në fakt pasi shpirti im i lirë e endacak endej në një diskotekë, më saktë në vendin ku më vranë. Shiriti i verdhë që policia kishte vënë nuk di përse ma tërhoqte aq shumë vëmendjen. Ndoshta ngaqë të gjallët duhet të respektonin rregullin për të mos kaluar vijën e verdhë ndërsa unë si shpirt që isha mund ta kaloja sa herë të doja, madje dhe të rrija në mes e askush nuk më shihte.

Kisha vdekur prej disa orësh por nuk ia pranoja dot vetes. Trupi im i drobitur dergjej nën një çarçaf të bardhë. Shpirti, pra unë, duke mos pranuar vdekjen endesha mes njerëzve në atë disko në të dalë të qytetit. Diskotekën e lashë në mëngjes dhe ndalesën e radhës e bëra në një kafene. Ndërkohë që u ndala për të cimbisur një briosh e për të kthyer një gllënjë kafe të zezë dëgjoja se lajmi i vdekjes sime po transmetohej në TV.

Dreji e marrtë! - mërmërita nën zë.

Mbarova mëngjesin (mëngjes i thënçin) dhe pa asnjë dëshirë u nisa drejt morgut. Morgu ndodhej afër spitalit dhe spitali afër qendrës. Sapo u afrova pashë së largu makinën e tim eti. Prej andej doli ai dhe nëna. Ajo e veshur me peliçe të zezë, ndërsa babai me kostum blu. Brofa përpjetë. S'di as vetë si por shpirti m'u rrëmbush. Ishte një çast shumë i dhimbshëm. Prindërit duhet të identifikonin kufomën time. Rrëshkita pas tyre dhe i ndoqa përgjatë korridorit të heshtur. Roja u printe gojëkryçur. Ndalëm para një dere. Roja e hapi ngadalë dhe bëri para. Prindërit e ndoqën pa fjalë. Unë pas tyre.

Kufoma me numrin 42 nuk ndryshonte aspak në pamje të parë, pra mbuluar me çarçaf, nga kufomat e tjera. Vetëm numri e dallonte. 42.

Me mendje po kujtoja diçka lidhur me numrin.

Mosha e pedagoges sime të preferuar.

Numri i këmbës së babait.

Shifrat e fundit të numrit të celularit të mikes sime.

Numri i ...

"Afrohuni ju lutem!"

Zëri i rojes që u drejtohej prindërve të mi e ndërpreu lojën me numrin 42. Babai u afrova dhe dorën e djathtë e vuri përpara trupit të nënës për ta ndaluar atë ti qasej kufomës. Me të majtën ngriti ngadalë çarçafin. Fytyra pas mbulesës ishte e imja. Mend më zuri ngashërimi aty teksa shihja fytyrën time pa jetë. Pa asnjë kujdes dhe vrulltas im atë e mbuloi fytyrën time. U kthye nga roja dhe qetësisht mohoi se më njihje. Roja puliti sytë, nëna seç mërmëriti ndërsa unë i kisha shqyer sytë nga habia. Nuk më besohej që im atë nuk më kishte njohur. Fytyra ime ishte e paprekur dhe e bente lehtësisht të mundur identifikimin.

Fillin e mendimeve të mia mjerane e preu zëri i nënës. Ajo po i kërkonte babait që ta shihte edhe vetë kufomën. Roja dha konfirmimin e tij, babai dukej i nervozuar dhe pasi dha edhe ai miratimin u kthye e doli nga dhoma. Ndoshta nuk donte të ishte dëshmitar i ulërimës dhe ngashërimeve të nënës kur të shihte fëmijën e saj.

Nëna, me një gjest teatral dhe pa ndonjë dhimbje të dukshme zbuloi edhe një herë fytyrën time. Heshtje. Prisja nga çasti në çast shtrëngatën që do shpërthente nga gjoksi i gruas që më kishte mëkuar. Roja ishte zbehur e bërë meit. Sekondat në atë dhomë u bënë të padurueshme. Pikërisht kur mendoja se shpërthimi në vaj i sime mëje

ishte pas dere ajo deklaroi thatë e shkoqur:

- Nuk e njoh. Më vjen keq. Është hera e parë që e shoh.

Britma që doli nga shpirti im do kish qenë në gjendje të thyente xhamat e dritareve por duke qenë se nuk doli kurrë jashtë, në dhomë mbizotëroi heshtja. Roja nuk e zgjati më tej, këmbëu një falenderim më nënën dhe u nis me të drejt daljes. Dera u mbyll pas tyre. Në dhomë mbeta unë, trup e shpirt.

Një mendje më këshillonte ta mbysja shpirtin tim. Por si do thoni ju? Duke e helmuar me fjalë për shembull. Duke i përsëritur pa ndalim se asnjë nuk e do, se as prindërit nuk e duan, ata ishin të parët që e mohuan. Se ka mbetur vetëm dhe tani askush dhe asgjë nuk i bën dot derman. Është një shpirt i dënuar të vuajë përjetësisht. Nga gjithë këto fjalë me siguri që shpirti im do të thyhej, do tkurrej e dosmosdo me helmin e mbledhur do helmonte veten.

Kalova disa minuta të gjata ku shpirti mendonte si të vriste shpirtin. Trupi im nuk më zgjonte asnjë lloj kureshtjeje por përpara se të dilja përgjithmonë nga morgu më duhej të përhëndetësja me atë që kish qenë për shumë vite banesa ime. U afrova pa u ndjerë, ashtu siç vetëm një shpirt mund ta bëjë dhe tërhoqa çarçafin. Trupi im i ndjerë pushonte në paqe tashmë. Plaga ishte pastruar dhe nuk ngjallte neveri. Fytyra kish marrë një nur të bukur aq sa po të mos ishte fytyra ime do isha dashuruar me të. Munda vetëm të pëshpërisja:

- Lamtumirë!

E mbulova trupin dhe ndërkohë e kisha vendosur se çfarë do të bëja tanimë si shpirt. U largova nga dhoma me shpejtësi dhe dola në ajrin e pastër. Nuk do të kthehesha në ferr, as në purgator. Në parajsë jo e jo. Edhe pse fleta e thirrjes për t' u paraqitur në botën e përtejme më kishte ardhur, (pasi tanimë isha banor i asaj bote) zgjodha me vetëdije të plotë të arratisesha. Do ti bija botës kryq e tërthor. Askush nuk mund të më ndalte. Dhe ashtu bëra. E nisa rrugëtimin tim nëpër botën e gjerë, larg miqve, prindërve që më harruan, dhe gjithë atyre që kurrë nuk më kuptuan.

Epilog

Kam shumë vite që jam në arrati. Gjatë gjithë këtyre viteve, kudo ku kam qenë, më kanë ndjekur pas tre engjejt. Në çdo hap timin, në çdo ndalesë, në çdo vend, kam më ndaheshin.

Engjelli i Ferrit më thërret ta ndjek, sipas tij shpirti im i përket Djallit.

Engjelli i Purgatorit më fton ta ndjek e thotë se kam për t'ja kaluar mirë aty.

Engjelli i Parajsës as më flet, as më fton me gojë. Ai ka të shkruar në gjoks:

"Kthehu tek unë, tek Krijuesi yt. Shpirti yt është krijimi im".



Imagjino sikur je ulur në sallën e operas *Musikverein*, dhe po dëgjon Orkestrën e Filarmonisë së Vjenës e cila po luan mrekullueshëm një simfoni të Beethoven, Mozart, Vivaldi, apo të ndonjë mjeshtri tjetër, por ja, menjëherë kupton se ka diçka që nuk shkon: dy a tre pjesëtarë të orkestrës luajnë jashtë ritmi, stonojnë apo nuk zotërojnë talentin e kolegëve të tjerë, duke e bërë të gjithë orkestrën të padurueshme dhe të padëgjueshme. Dhe gjëja e parë që ti mendon me vete është se do kishte qenë më mirë që ata të ishin spektatorë e jo mbi skenë, e që duhet të kishin zgjedhur ndonjë zanat tjetër në vend të muzikantit. Çfarëdo zanati, vetëm jo atë të muzikës. E madje le të ishte orkestra pa ato instrumente sepse gjithsesi do tingëllonte më bukur e paplotë se sa me ata plangprishës të patalentuar të cilët vrasin muzikën dhe artin.

Kjo është ajo çfarë i ndodh kulturës sonë kur në gjirin e saj ndodhen artistët, muzikantë dhe shkrimtarë të këqij. Pa dashje, por thjesht nga paaftësia e tyre e shndërrojnë harmoninë artistike në një zhangëllimë e disonancë, duke penguar kështu jo vetëm rrjedhën progresive të natyrshme të artit por duke i privuar audiencave artin dhe letërsinë e kulluar.

Artistët dhe shkrimtarët e patalentuar të cilët zënë ofiqe të pamerituara dhe hapësirat publike janë barinj të këqij të shoqërisë. Ata e drejtojnë shoqërinë në vendet shterpë, atje ku nuk ka frute, e as oazë.

Shoqëria është e vetëdijshme për të mos lejuar në shërbim e profesion një mjek të keq, një mësues të keq, inxhinier të keq, arkitekt të keq, e madje shofer apo pilot të keq, pasi janë rrezik real mbi njerëzit e zakonshëm. Por edhe artistët dhe shkrimtarët e këqij shkatërrojnë finesën e pa përkufizueshme dhe të tejboshme të artit, prishin vizionin dhe çudinë e artit dhe fjalës së shkruar, bëhen pengues të progresit dhe vrasës talentesh, e mbi të gjitha zënë hapësirat shoqërore, duke shërbyer si kasta kolonash të cilat nuk e mbajnë dot mbi vete peshën e kohës, emancipimin e shoqërisë, dhe rrugëtimin drejt njohjeve të reja.

“Nuk ka të majtë apo të djathtë në letërsi,” tha Ernest Hemingway, “Ka vetëm shkrime të mira e të këqija.” Ndaj dallimin midis tyre e bën lexuesi e jo vetë autori, e bën ndikimi që kanë në shoqëri e jo emërimi në hapësira publike nga cilado parti në pushtet, e bën britma universale e veprës dhe jo qarqet e ngushta të pseudo kritikëve provincialë.

Misioni i shkrimtarit dhe artistit të vërtetë është të përshkojë dimensionet dhe universet të tjera të cilat shtrihen përtej kohës, gjeografisë, madje edhe vetë realitetit.

Çdo krijues duhet të ketë si vendmbërritje njeriun universal, të pakufizuar prej kombësisë, gjinisë apo rrethanave. Fatkeqësisht sot po përjetojmë një holokaust mendimi dhe një abort intelektual. Nevojitet letërsi dhe art *exclusif* që ta çlirojë botën nga fenomeni i *homo stupidus*.

Vetëm nga talentet vjen çlirimi dhe emancipimi. Letërsia dhe arti shpalosin peizazhe paralele që shihen me mendje dhe perceptohen nga ekstaza, ajo vdekje e vogël e përjetshme e cila bëhet edhe më e përjetshme nga fjala, piktura, skulptura, apo muzika.

Arti i kulluar dhe i vërtetë është *exclusivité*, një urë lidhëse e realitetit me mbretërinë e qiejve, ndaj edhe ajo

MBI ARTISTËT DHE SHKRIMTARËT E KËQIJ

Dr. Bledar Kurti



ishte që nga fillimi dhe do të jetë deri në fund. Kush e kupton është *exclusif*, kush e transmeton është profet dhe i parazgjedhur, kush e kërkon është i ndriçuar. Të tjerët, ata që jetojnë jashtë kompasit të krijimtarisë, apo artistët dhe shkrimtarët e këqij, lindin e ngordhin në shurdhi e shkretinë e drejtojnë edhe shoqërinë drejt skëterrës.

Bota është një vend i ferrtë, dhe shkrimtarët e artistët e këqij po e shkatërrojnë cilësinë e vuajtjes sonë. Amatorizmi është gënjeshtër dhe mashtrim. Është thjesht një përkëdhelje e gjyshes për nipin a mbesën, parë nën optikën e dashurisë së gjakut. Arti dhe letërsia e kanë zburuar përherë produktin e keq që nuk ka arritur të përfaqësojë dinjitetin e madhështisë dhe forcës së talentit krijues. Arti i vërtetë lind në një qoshe gjeografike e dëgjohet si ushëtimë në të gjitha skajet e botës. Ky është dallimi.

Arti dhe letërsia nuk janë terapi e rëndomtë për gjendjen tënde emocionale apo mjete për zhvillimin personal si të ngjitesh hapat e jetës. Arti dhe letërsia janë thirrje, janë vajosje, shukurim dhe përzgjedhje, një barrë që rëndon mbi jetën e krijuesit edhe pa e dashur ata.

Artistët dhe shkrimtarët janë levitë. Një fis i zgjedhur.

Të gjithë mund të hynin në tempullin e Izraelit, të gjithë mund të adhuronin në të, por ishte vetëm një fis i caktuar që mund të hynte në tebernakull, në shenjtoreshën e tempullit. Këta ishin levitët. Dhe çfarë gjendej në vendin më të shenjtë të të shenjtëve? Arka e Besëlidhjes. Dhe çfarë kishte brenda arkës? Dy rrasa guri me dhjetë urdhëresa. Pra, fjalë të gdhendura në gurë. Art. Prandaj edhe arti është *exclusivité* dhe jo rëndomësi, e as amatorizëm.

Misioni i çdo shkrimtari dhe artisti të vërtetë është të krijojë një art apo letërsi

të re që përmbush të vjetrin. Kurrsesi ta zhbëjë atë, por ta plotësojë atë.

Nëse një krijim i sotëm, i çfarëdo zhanri, nuk përmban dijen gjashtëmijë vjeçare të historisë së njerëzimit, atëherë është thjesht një mosgjë. Nëse nuk përmban dhimbjen, shpresën, forcën, humbjen dhe ëndrrat njerëzore të mijëvjeçareve është pa asnjë vlerë. Shekulli i njëzetë e një i ka gjetur fushat krijuese në një krizë të thellë pasi njeriu modern fokusohet te njeriu dhe jo njerëzimi. Unë. Si ndihem unë? Si e shoh unë? Si e mendoj unë? E jo të fokusohet te njerëzimi, si një vëllazëri bashkudhëtarësh e bashkëvuajtës, një kolorit i pafund emocionesh të shndritshme e torturorese që shërben njëkohësisht si frymëzim por edhe si audiencë. Kriza e tanishme ka ardhur për shkak të mësimëve të pa marra nga shekulli që lamë pas. Artistët dhe shkrimtarët e shekullit të kaluar ishin më prodhimtarë dhe më të vërtetë pasi e kuptuan më së miri përvojën njerëzore, ndërsa sot kjo nuk ndodh.

U deshën dy luftëra botërore dhe disa regjime të tmerrshme, si Nazizmi, Fashizmi dhe Komunizmi, që i bënë artistët dhe shkrimtarët e shekullit të kaluar të kuptojnë se ata i përkasin një universi tjetër dhe misioni i tyre ishte të shpagojnë kombet që u përkasin me akte rebelimi përmes artit të mirëfilltë dhe novativ.

Pasi shkrimtarët kuptuan që shekulli i njëzetë vrau trefish më shumë njerëz sesa të gjitha viktimat në mbarë botën në të gjithë historinë e njerëzimit, atëherë, ashtu si *hamartia* (faji) e grekëve të lashtë, si një katarsis epokal në emër të gjithë njerëzimit, ata u zotuan në heshtje, që në zanafillën e qenies së tyre, aq sa arti e letërsia do t'i lejonte, ata nuk do të viheshin kurrë në shërbim të vdekjes. Dhe nën këtë premtim, pasi

i shtrydhën përmes krijimtarisë të gjitha degëzimet dhe rrymat e artit e letërsisë, e përmbyllën veprën e tyre me post-modernizmin. Tani, pas post-modernizmit, ka pllakosur heshtja, dhe kanë mbirë krijuesit blogerë, kritikët e portaleve, publicistët “interesantë” (fjala më e urryer për shkrimtarët dhe artistët), amatorët që nuk kanë dëgjuar kurrë për shkrimtarët dhe mendjet më të ndritura të botës e as për artistët më gjenialë të epokave, e kështu njerëzimi, nga *homo sapiens* (latinisht për *qenie inteligjente*) rrezikon të shndërrohet në *homo stupidus* (latinisht për *qenie idiote*). Një gjendje e privimit emancipues të cilën mund ta çlirojë vetëm arti dhe letërsia e kulluar.

Arti është xheloz. Ai nuk lejon t'i cenosh as edhe një grimcë të natyrës dhe esencës së vet. Ndaj edhe është i përsosur. Ndaj edhe gjen gjithnjë përsosmëri të re. Thirrja e çdo krijuesi është të bëhet mjet i kësaj përsosmërie. Nëse je krijues, atëherë e kupton fare mirë misionin dhe thirrjen. Atë çekan që të zgjon në orët e para të mëngjesit, ai zë që të persekuton edhe kur je duke bërë dashuri, ai rrugëtim pa të cilin të duket sikur nuk mbushesh dot me frymë. Por duhet kuptuar prej çdokujt që ka një motiv që e ka shtyrë njerëzimin prej mijëra vitesh të krijojë. Ky motiv është faji. Faji i rënies së njeriut. Ai faj që na bën të jemi qeniet e vetme në univers që kemi turp nga lakuriqësia. Qeniet e vetme në univers që vishemi e mbulojmë natyrën tonë të vërtetë.

Ndër mijëra vjet, emocioni më i fortë që e ka shtyrë njerëzimin të ecë përpara apo të spastrojë veten është faji. Meshkujt mbizotërojnë në numër si artistë, shkrimtarë dhe krijues, pasi shtyrë nga faji i të moslindurit fëmijë, mundohen të justifikojnë ekzistencën e tyre në univers duke lindur vepra, portrete apo personazhe. Shtyrë nga faji i djegies së Trojës grekët shpikën tragjedinë. Prej fajit të kryqëzimit të Krishtit, qendra e Krishterimit u ngrit në Romë. Prej fajit, perandoritë e mëdha, dikur më vandalet e njerëzimit, tashmë janë pionieret më të flakta të të drejtave të njeriut. Vendet që shkaktuan pushtimet më vrastare historike tashmë janë më të përkushtuarat për përkrahjen e së drejtës së jetës.

Ndaj edhe individit shkrimtar apo artist duhet të bëhet pjesë e këtij katarsis global dhe epokal e të paraqesë natyrën e vërtetë, të thellë, biologjike, emocionale, mendore dhe universale të njerëzimit.

Fatkeqësisht, shumica e njerëzve sot mendojnë se njeriu ka vetëm pesë ndjesi, e në raste të veçanta gjashtë (ajo që i atribuohet të mbinatyrshmes) por kjo është e gabuar. Njeriu ka shumë e më shumë ndjesi se sa thjesht prekja, nuhatja, shikimi, shijimi dhe dëgjimi. Ka gjithashtu edhe ndjesinë e dhimbjes, ekuilibrit, lumturisë, rrezatimit, gravitetit, etj, si edhe ndjesinë e hapësirës së vet në raport me të tjerët. Ndaj çdo artist apo shkrimtar që synon t'i përkasë grupimit të krijuesve të mirë duhet të çojë përpara stafetën e hershme të artit dhe letërsisë, e të mësojë të jetë instrument i akorduar në orkestrën e madhe të talenteve botërore, përndryshe, cilido që luan solo e mendon se fajin e ka njerëzimi që nuk arrin të dallojë gjenialitetin e tij apo të saj, më mirë të ulet në karrigen e spektatorëve e të duartrokasë sipas pëlqimit ata që performojnë mrekullueshëm mbi skenën e jetës.

Vincent Van Gogh adhuronte shkrimtarët po aq sa edhe piktorët.

Përfshirja në letërsi e Van Gogh ndikoi në një farë mase që të krijonte një zë unik dhe elegant, i cili i bën shkrimet e tij një arritje kaq të rëndësishme në letërsi. Kjo përfshirje e ndihmoi gjithashtu të përshkruante me kaq bindje vlerësimin e tij për veprat e artistëve të tjerë dhe qëllimet e tij për artin e vet, duke e bërë jashtëzakonisht të mundshme – ndoshta në mënyrë unike – që ne ta shohim artin përmes syve të një artisti të nivelit të tij.

Trajektorja e dashurisë së Van Gogh-ut për leximin – ashtu si për shumë gjëra të tjera në jetën e tij – filloi në fëmijërinë e hershme. Çdo mbrëmje te famullitari i prindërve në fshatin e vogël të Zundert-it, në jug të Holandës, përfundonte në të njëjtën mënyrë: me një libër. Edhe pse nuk ishte aspak një ushtrim që bëhej në vetmi, leximi me zë e bashkonte familjen dhe e distancoonte nga përhapja e analfabetizmit rural që i rrethonte. Prindërit e tij i lexonin njëri-tjetrit dhe fëmijëve të tyre; fëmijët e mëdhenj u lexonin të vegjëlve; dhe më vonë gjatë jetës, fëmijët u lexonin prindërve. Leximi me zë përdorej për të ngushëlluar të sëmurët dhe për të shpërqendruar të merakosurit. Qoftë nën hijen e tendës së kopshtit ose pranë një lllame vaji, leximi ishte (dhe do të mbetej gjithmonë) zëri ngushëllues i unitetit familjar. Shumë kohë pasi fëmijët ishin larguar, ata vazhdonin të shkëmbejnë libra dhe rekomandime librash, që dukej sikur një libër nuk quhej i lexuar vërtet nëse nuk e lexonin të gjithë.

Ndërkohë që Bibla konsiderohej gjithmonë “libri më i mirë”, raftet e librave të famullitarit ishin të mbushur përplot me klasikët iluministë: romantikët gjermanë si Friedrich Schiller; Shakespeare (i përkthyer në holandisht); dhe disa vepra franceze nga shkrimtarë si Molière dhe Alexandre Dumas. Të përjashtuar ishin librat që konsideroheshin si të tepruar apo shqetësues, si “Fausti” i Gëtes, si dhe vepra më moderne, sidomos nga autorë francezë si Honoré de Balzac dhe, më vonë, Émile Zola, të cilin mamaja e Van Gogh-ut, Anna, e quajti “produkte të mendjeve të mëdha, por të shpirttrave të papastër”.

Të papranueshme në shtëpi ishin edhe romanet e Victor Hugo-së. Përgjatë pjesës më të madhe të një shekulli konsumizmi dhe kënaqësisë borgjeze, Hugo-ja e kishte mbajtur pishtarin e idealizmit – flakën e revolucionit – të ndezur dhe lart. Ai kishte luftuar kundër qeverive të mbrapshta dhe feve të ringjallura, duke inatosur të gjithë që nga Louis Napoleon e deri te familja e Van Gogh-ut me nderimin e tij për mungesën e besimit në zot dhe kriminalitetin. “Hugo është në anën e kriminelëve,” deklaroi njëherë e tmerruar mamaja e Vincent-it. “Ç’do të bëhej me botën nëse gjërat e këqija do të konsideroheshin të mira? Për atë Zot, s’mund të jetë e drejtë”.

Më herët, shija e Van Gogh-ut për letërsinë franceze, sidomos për romanet më revolucionarë, u bë fushëbeteja kryesore në përshkallëzimin e konfliktit mes djalit dhe babait. Kur Vincent-i u dërgoi prindërve të tij një kopje të *The Last Day of a Condemned Man* të Hugo-së, ndezi atë shkëndijën që ai duhet të kishte synuar. Ai ktheu krah njëqind e tetëdhjetë gradë për të shkakuar zemërim maksimal dhe rrjedhimisht hodhi poshtë edhe autoritetin e veçantë të Biblës. “Me raste e lexoj edhe unë Biblën”, tha ai, “po ashtu siç lexoj ndonjëherë Michelet, Balzac ose Eliot”.

Ishte një betejë që nuk mbaroi me vdekjen e Dorus van Gogh në 1885 – nga një atak në zemër të cilin motra e Vincent-it, Anna, ia ngarkoi vëllait të madh e të vështirë. Kur babai i tij ndërroi jetë, Vincent-i vendosi t’i dedikonte një

SI VEPRAT E PREFERUARA TË LETËRSISË FRANCEZE FRYMËZUAN ARTIN DHE IDENTITETIN E VINCENT VAN GOGH

Steven Naifeh mbi marrëdhënien
e piktorit me librat

pikturë dhe ta përfshinte në një grup me *memento mori*, ose kujtesa të vdekjes. Duke parë rrotull studios së tij, fillimisht ai zgjodhi natyrshëm një Bibël të madhe që i përkiste babait. Për shkak se kisha mbante Biblën e ambonit dhe e veja e tij mbante Biblën e familjes, ky vëllim i mahnitshëm, me cepa të përforcuar me bakër, dhe dy kapëse bronzi, ishte e vetmja Bibël që u trashëguar kur Dorus van Gogh vdiq. Duke pastruar një vend në rrëmujën e studios së tij, Vincent-i hapi një robë mbi tavolinë, vuri Biblën mbi të, dhe hoqi karficat. Ai e afrooi aq shumë kavaletin sa që libri i hapur mbushte thujtë të gjithë kornizën e tij të perspektivës.

Në një moment, ai vendosi ta gjallërojë kompozimin me një objekt tjetër. Duke rrëmjuar përmes pigrjeve me libra, zgjodhi njërin me kopertinë të butë të verdhë të botimeve franceze Charpentier që ai e adhuronte dhe e vendosi në cep të tavolinës, nën këmbën e Biblës gjigante, një roman francez që shërbente si një provokim final edhe në një kohë zie. Ai e dizajnoi librin si *La joie de vivre* të Zola-s, dhe me kujdes provokues shkroi titullin, autorin, dhe vendin e botimit – Paris. Me pak furça, ai kapi kopertinën e palosur dhe faqet e përdorura – një sfidë kundrejt Biblës së patëmetë e formale të babait të tij.

Leximi mbeti shtylla kryesore e jetës së vetmuar të Van Gogh-ut. Më pak miq të vërtetë, ai i mbushte me lexime orët kur nuk pikturonte. Ai lexonte si maniak në katër gjuhë – holandisht, gjermanisht, frëngjisht dhe anglisht – shpesh duke

lexuar disa herë të njëjtin libër. Lexonte një libër të vetëm nga një autor – Balzac-un për shembull – dhe më pas shkante te komplet vepra. Më kohë, ai do të merrte përsipër të rilexonte veprat e plota të autorëve të parapëlqyer, me Balzac-un “e madh e të fuqishëm” kryesor mes tyre.

Edhe pse Van Gogh-u kishte një dashuri të veçantë për Hugo, Balzac, Dumas dhe Zola, ai lexonte me kënaqësi të madhe të gjithë romancierët e mëdhenj francezë të kohës së tij: vëllezërit Daudet, Alphonse dhe Ernest; vëllezërit Gouncourt, Edmond dhe Jules; shkrimtarin pelegrin Pierre Loti; dhe sidomos Guy de Maupassant, autorin e një prej romaneve të tij të parapëlqyer, *Bel-Ami*. Van Gogh mendonte se vende të caktuar prodhonin artistë të mëdhenj të formave specifike të artit: grekët në skulpturë, gjermanët në muzikë dhe francezët në letërsi.

Por shkrimtari francez që pati ndikimin më të madh te Van Gogh-u ishte Zola. “Ky Émile Zola është një artist i lavdishëm,” i shkroi Theo-s në Korrik 1882 teksa përpinte romanet njëri pas tjetrit. “Lexo sa më shumë të mundesh prej tij.” Një nga të preferuarat e tij ishte *Le ventre de Paris* (Barku i Parisit), celebrimi i Zola-s për triumfin e humanitetit bohemian kundrejt ortodoksisë borgjeze. Gjithmonë i etur të identifikohet me personazhe individualë në librat që lexonte, Van Gogh e imagjinonte veten e tij jo si Claude Lantier, artistin e shqetësuar të librit, por si Madame François, një grua e sjellshme e cila shpëton heroin e dëshpëruar të librit, Florent-in. Ky ishte një imazh shpëtimi i cili



Pirgje romanësh francezë, Van Gogh, 1887

jehonte përtej ndryshimeve të klasës apo gjinisë deri në thelbin e marrëdhënies së Van Gogh-ut me prostitutën Sien Hoornik – edhe si i shpëtuari edhe si shpëtuesi. “Çfarë mendon për znj. François, e cila mori Florent-in e shkretë në karrocën e saj dhe e çoi në shtëpi kur ai ishte i shtrirë pa ndjenja në mes të rrugës?” pyeti Theo-n qartazi. “Mendoj se znj. François është vërtet e njerëzishme dhe kam bërë e do të bëj për Sien-ën atë që mendoj se dikush si znj. François do të kishte bërë për Florent-in”.

Van Gogh-u ishte gjithashtu i dashuruar pas Victor Hugo-së, për rrëfimin e fuqishëm, retorikën qiellore dhe vizionin e tij të madh. Dhe me Hugo-n, po ashtu si me Zola-n, ai mbërthehej pas linjave të tregimeve dhe tematikave që i kujtonin jetën e tij dhe e ndihmonin ta përballonte. Më 30 mars, 1883, Van Gogh e kaloi ditëlindjen e tij të tridhjetë vetëm, duke rilexuar rrëfimin e mërgimit të përhumur të Hugo-së, *Les misérables*. “Ndonjëherë nuk më besohet se jam vetëm tridhjetë vjeç,” shkroi ai. “Ndiem shumë më i madh kur mendoj se shumica e njerëzve që më njohin më konsiderojnë dështak, dhe se si mund të jetë vërtet ashtu”. Kur iu rikthye Notre Dame de Paris, Van Gogh e caktoi veten si Quasimodo, kurrijo i urryer i Hugosë. Nga thellësitë e vetëneverisë, ai mblodhi veten me britmën e dhimbshme të kurrizos: “Noble lame, vil fourreau / Dans mon âme je suis beau” (Teh fisnik, mill i poshtër / Brenda shpirtit tim unë jam i bukur).

Por nëse Van Gogh-u pa frymëzim personal dhe ngushëllim te romanet që lexonte, ai pa dhe frymëzim artistik në to. Përgjatë izolimit të tij te azili i Saint-Rémy, duke imagjinuar pikturën e një nate me yje, ai ëndërronte për netet me yje në librat e Zola-së, Daudet-it, Lot-it, dhe sidomos Maupassant-it që e mbante anës kreativitet. “E dashuroj natën me pasion”, shkroi Maupassant në *Bel-Ami*. “E dashuroj siç dashurohet atdheu, ose dashnorja, me dashuri të thellë, instinktive, të pamposhtur... Dhe yjet! Yjet aty sipër, yjet e panjohur të hedhur rastësisht në pafundësinë ku përvijojnë ato figura të çuditshme, që e bëjnë njeriun të ëndërrorë kaq shumë, që e bëjnë njeriun të mendojë kaq thellë”.

Zola, në *Une page d’amor* e përshkruan qiellin e një nate vere si “të pluhurosur me rërën e shndritshme të yjeve thujtë të padukshëm... Pas atyre mijëra yjeve, mijëra të tjerë ishin duke u shfaqur, dhe kështu e gjitha shkante në një vazhdimësi të thellësisë së pafundme të qiellit. Ishte një lulëzim i vazhdueshëm, një dush i shkëndijave të prishta, botë të panumërta që ndriçonin me zjarrin e qetë të xhevahirëve. Rruga e qumështit po zbardhëllente ndërkohë, duke flakëruar gjerësisht yjet e vet të vegjël, kaq të pafundtë dhe kaq të largët sa që dukeshin si një brezni dritash të braktisura mbi rrathët e qiellit.

Përmes një gërshetimi të lëmuar dhe spontan të preokupimit dhe kalkulimeve artistike, djajve personal dhe pasioneve krijuese, pikturave dhe romaneve të preferuar, Van Gogh kishte arritur një lloj krejtësisht të ri të artit. Letrat e tij janë të mbushura me pasigurinë e një njeriu që e gjen veten qoftë në skajin e një bote të re, qoftë në fundin e një dege të gjatë. Ai nuk do të mund të thërriste Zola-në mjaftueshëm shpesh sa t’i largonte dyshimet e veta. “Zola krijon, por nuk i vendos para një pasqyre gjërat, ai krijon mrekullisht, por krijon, poetizon,” i shkroi Vincenti Tios në 1885. “Prandaj është kaq e bukur”.



THOMAS
KENEALLY

LISTA
E
SHINDLERIT

ROMAN

OMBRA GVG

